



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 7.03. 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
7.03. 2011. GODINE**

**MARS – MART
2011**

E hënë, më 7. 03. 2011,

Seancën drejton: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ju njoftoj se seanca fillon në orën 10:00.

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar, Konstatoj se janë prezentë 107 deputetë, andaj ia fillojmë punës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit, i ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotshme plenare.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim, procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar sipas kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me dialogun në mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë

Qeveria e Republikës së Kosovës ka parashtruar në Kuvend kërkesën që në mbledhjen plenare të radhës të diskutohet çështja e dialogut në mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Ftoj kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë arsyetimin e kërkesës për debat.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Krasniqi,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Përfaqësues ndërkombëtarë,

Zonja dhe zotërinj, qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Sot ndodhemi para fillimit të një procesi të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për të ardhmen evropiane të Republikës së Kosovës.

Ky është hapi aktiv dhe dinamik i Republikës së Kosovës, është hapi i Kosovës evropiane.

Për herë të parë, prej përfundimit të luftës dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës, do t'i fillojmë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, si me të gjitha vendet tjera fqinje.

Për herë të parë, përfaqësuesit e Republikës së Kosovës, apo përfaqësuesit e Kosovës, në historinë e vet politike, do të mund të ulen, të barabartë me përfaqësuesit e Serbisë, si dy shtete të pavarura dhe sovrane.

Pas dekadave të konflikteve dhe shkatërrimeve, erdhi koha që mospajtimet dhe dallimet në çështje të caktuara, t'i diskutojmë në mënyrë të barabartë dhe t'i zgjidhim bashkërisht në përputhje me vlerat evro-atlantike.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet në dialogun teknik që është para nesh e

përkushtuar për ta avancuar jetën e qytetarëve dhe për t'i kontribuar edhe më tepër stabilitetit në rajon, bashkëpunimit dhe frymës evro-atlantike.

Gjetja e zgjidhjes për problemet e trashëguara është çështje e nevojshme, urgjente dhe e pashmangshme, duke filluar prej plagës së rëndë të të zhdukurve, e deri te pengesat administrative dhe dokumentacioni i konfiskuar, dialogu teknik me Republikën e Serbisë, do ta ketë një synim të vetëm, normalizimin dhe zhvillimin e raporteve tona ndërshtetërore.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, është njohur nga 75 shtete më të fuqishme të botës, liria dhe statusi i saj janë të padiskutueshme dhe të panegociueshme.

Megjithatë, zhvillimi ekonomik dhe integrimet evropiane janë të domosdoshme për mirëqenien e të gjithë neve.

Në këtë aspekt, dialogu teknik i Republikës së Kosovës me Serbinë, paraqet fazën kryesore në rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian dhe integriteteve evro-atlantike. Ky dialog përshpejton liberalizimin e vizave dhe integrimin e Kosovës në NATO dhe në Bashkim Evropian.

Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në Kushtetutë dhe legjitimitetin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka përgjegjësinë e udhëheqjes së këtij procesi.

Mirëpo, unë e ftoj Kuvendin e Republikës së Kosovës, që ta përkrahë këtë proces, të vëzhgojë dhe kyçet nga afër në rrjedhën e tij.

Për më tepër, Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të informohet rregullisht për ecurinë e këtij procesi, i cili natyrisht pritet të jetë i gjatë, por kam besim se ky proces, me bindje të plotë, do të përfundojë me njohjen reciproke në mes Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete të pavarura, si dy shtete sovranë dhe me anëtarësimin në NATO dhe Bashkim Evropian edhe të Republikës së Kosovës edhe të Serbisë.

Procesi i dialogut para nesh tejkalon suazat partiake dhe ideologjike, të nderuar deputetë. Ky dialog duhet të na bashkojë si spektër politik, shoqëri civile, por dhe si qytetarë.

Nuk jemi vendi i parë, shteti i parë që dialogojmë me një shtet tjetër që kemi qenë në konflikt. Historia është e mbushur plot me raste të tilla që kanë qenë në konflikt, kanë luftuar, kanë përfunduar luftën, kanë dialoguar dhe kanë ndërtuar fqinjësi të mirë e ne, rrugën tonë evropiane mund ta ndërtojmë vetëm duke u bazuar në vlerat tona euroatlantike, në bashkëpunimin rajonal dhe perspektivën integruese.

Sfida që përmbahet në këtë dialog, mendoj se duhet të jetë ajo sfida e cila duhet të na afrojë të gjithëve, pa dallime partiake, pa dallime ideologjike, pa dallime etnike për të ndërtuar Kosovës demokratike, shumetnike dhe evropiane.

Sot e gjithë bota i ka sytë të drejtuar në Kosovë, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe Bashkimi Evropian, në pyetjen se a është e përcaktuar Kosova për rrugëtimin e saj euroatlantik apo ka dilema të mentalitetit të së kaluarës?

Prandaj, ky proces është një proces i interesit gjithëkombëtar dhe agjendë euroatlantike.

Ky proces nuk po fillon sot, por ka filluar edhe më herët në diskutimet tona të vazhdueshme të Qeverisë së kaluar, të Kuvendit të kaluar, në kontakte tona të drejtpërdrejta me Brukselin dhe Uashingtonin.

Andaj, sot, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pres nga ju përkrahjen e fuqishme dhe përkushtimin e skajshëm për të kurorëzuar me sukses këtë proces madhor për ardhmërinë e shtetit tonë të ri.

As sot, sikurse edhe herëve të tjera, nuk jemi të vetmuar në këtë proces, e kemi mbështetjen e plotë të partnerëve dhe miqve tanë, siç e kishim në procesin për lirinë dhe ndërtimin e shtetit tonë të pavarur dhe sovran e do ta kemi edhe mbështetjen e vazhdueshme në procesin integruar.

Partnerët tanë ndërkombëtar, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të jenë pjesë e rëndësishme e këtij procesi, prania dhe ndihma e tyre do të jetë garant i suksesit dhe i perspektivës evropiane të Republikës së Kosovës.

Partnerët tanë, miqtë tanë, sikurse edhe më herët, sikurse edhe ne të gjithë, janë të bindur se fuqia e një shteti të ri si Kosova, qëndron në sigurinë e qytetarëve të tij, në stabilitetin dhe zhvillimit ekonomik dhe politik.

Të gjitha këto mund të arrihen vetëm përmes fqinjësisë së mirë, përmes lirisë së lëvizjes për të gjithë dhe përmes mirëkuptimit të ndërsjellë nga të gjithë.

Unë mirëpres debat konstruktiv, të nderuar deputetë, nga ju, të argumentuar dhe të arsyeshëm, në shërbim të interesit tonë nacional dhe të ardhmes sonë evropiane. Mirëpres, konkluzione të përbashkëta dhe implementimin e përgjegjësive të cilat na takojnë të gjithëve. Të gjitha rezultatet dhe suksesin e shtetit tonë të ri, i kemi arritur bashkërisht, kam besim të plotë, se bashkërisht do të implementojmë edhe agjendën tonë për Kosovën evropiane, euroatlantike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Tani është radha për diskutime për kryetarët e grupeve parlamentare.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetin Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: I nderuar kryetar,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e dialogut me interes për Kosovën, në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Duke pasur parasysh projektrezolutën të cilën Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në mandatin e kaluar e ka paraqitur, por për shkak të rrethanave të krijuara nuk ka arritur që të aprovohet, ne kemi përgatitur një projektrezolutë të cilën do t'jua lexojmë këtu para jush dhe jemi të gatshëm t'ua shpërndajmë edhe grupeve parlamentare të Parlamentit të Kosovës.

Duke respektuar Rezolutën për Kosovën të Asamblesë së Përgjithshme të datës 9 shtator 2010, në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës e të nenit 6.1 të Rregullores së vet të punës, i propozojmë Kuvendit të Kosovës të miratojë këtë projektrezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe rajonin.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që dialogu midis dy palëve të lehtësohet nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
3. Dialogu i Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë i përgatitur mirë, me agjendë të qartë dhe të përcaktuar paraprakisht, në marrëveshje me palët dialoguese, duke përfshirë edhe lehtësuesit e dialogut.
4. Agjenda e dialogut duhet të përfshijë vetëm çështje teknike të interesit të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, integritetin territorial të saj dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës.
5. Zëvendëskryeministrja, përgjegjëse për dialogun, do ta informojë në bazë të rregullt, Komisionin për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportojë edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh vullnetin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj, për të vendosur marrëdhënie të mira fqinjësore me Republikën e Serbisë, në të mirë të dy vendeve tona fqinje, popujve tanë, të integritimeve evropiane dhe stabilitetit e prosperitetit politik, social dhe ekonomik të rajonit tonë.
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës e afirmon qëndrimin se bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu, janë kontribut për stabilitet dhe zhvillim ekonomik të vendeve tona dhe të rajonit në përgjithësi, si dhe përsheptimin e integritimeve evropiane dhe evro-atlantike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i gatshëm që t'i dëgjojë të gjitha mendimet, propozimet dhe t'i harmonizojmë me grupet tjera parlamentare para se kjo projektrezolutë të paraqitet për votim në Parlamentin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Para se të them qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, vetëm po e them, ajo që e dëgjuam nga zoti Thaçi, realisht nuk tha asgjë që e vlen për ta dëgjuar dhe asgjë të re çka kemi dëgjuar, ka disa vite.

Të nderuar deputetë,

Tema për të cilën po debatojmë sot është delikate dhe e një rëndësie të madhe për të tashmen dhe të ardhmen e Republikës së Kosovës. Që nga nëntori i vitit 2005, kur sekretari i Përgjithshëm i OKB-së pati emëruar ish- presidentin finlandez, Marti Ahttisari, të dërguar të posaçëm për statusin, Kosova ka kaluar një periudhë të vështirë negociatash për zgjidhjen e statusit të saj, të cilat kanë prodhuar Propozimin gjithëpërfshirës për Kosovën, me rekomandim të qartë për pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën. Gjatë po thuaj dy vjet negociatash nën drejtimin Marti Ahttisarit dhe më vonë negociatave shtesë, delegacionet e Kosovës kanë demonstruar një shkallë të lartë të seriozitetit dhe të përkushtimit për të arritur zgjidhje të pranueshme për të dyja palët rreth të gjitha temave që ishin shtruar për negociata.

Në partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë me SHBA-të dhe Bashkimin Evropian, udhëheqja më e lartë e Kosovës, ishte pajtuar për një varg zgjidhjes pozitive të cilat rregullonin statusin e pakicave nacionale në Kosovë e në veçanti asaj serbe. Shumë nga zgjidhjet në pakon e Ahttisarit e vështirësojnë dhe e ndërlikojnë funksionimin normal të shtetit të Kosovës. Kosova, megjithatë është pajtuar që pakon e Ahttisarit ta implementojë në tërësi, duke e bërë edhe pjesë të kushtetutës së vendit.

Këto zgjidhje sigurojnë të drejta dhe privilegje shtesë për komunitetet jo shumicë në Kosovë dhe sërish në veçanti për komunitetin serb. Kosova ka dhënë maksimumin e saj për të gjetur një zgjidhje sa më të mirë dhe në harmoni me kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare, për grupet etnike jo shumicë në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Sot, kur në Kuvendin e Kosovës po shtrohet çështja e dialogut me Serbinë, pyetja e parë që shtrohet para nesh është - çfarë kërkohet nga ky dialog dhe cilat janë rezultatet e pritura të këtij dialogu për Kosovën? Për këtë nuk kemi përgjigje as nga Qeveria, s'kemi pasur e s'kemi as sot, e cila iu qas dialogut në formë klandestine dhe as nga përfaqësuesit e BE-së, të cilët kërkojnë të fillojë dialogu me Serbinë, pa u lëshuar në përgatitjet e tyre. Ne vazhdojmë të besojmë se problemet dhe parregullsitë që përcollën zgjedhjet e dëmtojnë legjitimitetin e institucioneve për t'u marrë me çështje kaq të rëndësishme, siç janë bisedat me Serbinë.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se Kosova i ka përfunduar negociatat me Serbinë, për statusin politik të Kosovës dhe nuk ka kthim prapa. Ne, konsiderojmë që duhet të saktësohen parimet për çështjet që nuk mund të diskutohen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Nuk mund të zhvillohen biseda që dalin jashtë Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk mund të bëhen takime për negociata, por vetëm për dialog ose bisedime.

Për çdo çështje që bisedohet, duhet të merret vendim në Kuvend. Çdo marrëveshje duhet të ratifikohet me 2/3 në Kuvend.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se me Serbinë mund të bisedohet për çështjet praktike të marrëdhënieve ndërshtetërore, ashtu siç mund të bisedohet edhe me vendet tjera fqinje.

Bisedat e tilla duhet ta kenë një kornizë të përcaktuar qartë nga Kuvendi i Republikës, e cila do të sigurojë që bisedat për çështjet praktike të kenë të caktuar kohën e fillimit dhe kohën e mbarimit.

Lidhja Demokratike e Kosovës, po ashtu, konsideron se Qeveria duhet ta bëjë të qartë dhe transparente se cilat çështje mund të diskutohen me Serbinë. Këtë duhet ta bëjë edhe Bashkimi Evropian, në mënyrë që ky Kuvend të vendosë për to.

Ne konsiderojmë se bisedat me Serbinë nuk janë të natyrës urgjente, bile as me prioritet në krahasim me sfidat e tjera me të cilat po ballafaqohet vendi.

Prandaj, i propozojmë Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që këtij Kuvendi t’ia afrojë një platformë të qartë të nevojave për të biseduar dhe të ofrojë kornizën e çështjeve që mund ose do të mund të bisedohen me Serbinë, një platformë të qartë të pritjeve dhe përfitimeve tona nga këto bisedime dhe një platformë të qartë të ambientit që duhet të sigurohet si parakusht i fillimit të bisedimeve.

Një ambient i nevojshëm për zhvillimin e këtyre bisedimeve kupton tërheqjen e strukturave të paligjshme të Serbisë, adresimin e qartë të Bashkimit Evropian për perspektivën e Kosovës, për anëtarësim në BE. Nëse Bashkimi Evropian kërkon që Kosova të ulet në tavolinën e bisedimeve, atëherë ai duhet të ofrojë kushte të njëjta anëtarësimi si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë.

Lidhja Demokratike e Kosovës mendon që dialogu me Serbinë duhet të organizohet nga institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës, ato duhet të zbresin në nivel të përfaqësimit teknik nga sektorë të caktuar të ministrive që mbulojnë çështje përkatëse. Prandaj, emërimi me nxitim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i zëvendëskryeministres në krye, të siç thuhet, delegacionit të Kosovës për dialog, është veprim i pamenduar mirë dhe mund të jetë paragjykses për karakterin e bisedimeve.

Meqenëse çështjet që diskutohen me Serbinë mund të jenë të ndjeshme dhe janë të ndjeshme, ne kërkojmë që platformën e bisedimeve dhe kornizën e temave dhe të rezultateve të pritura, duhet t’i autorizojë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës e konsideron si të pazëvendësueshëm rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat ishin të kyçura në të gjitha fazat e shtetndërtimit të Kosovës.

Mbi këto parime, LDK do të japë kontributin e vet, si parti parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Ajo që e tha kryeministri Hashim Thaçi, që këto negociata tash po vazhdojnë e kanë filluar shumë më herët, fatkeqësisht është e vërtetë. Kosova është në një proces të vazhdueshëm të negociatave me Serbinë dhe këto negociata nuk po duket se do të kenë ndonjë fund ndonjëherë.

Ne si lëvizje “Vetëvendosje” konsiderojmë që këto negociata duhet të ndalen dhe Kosova duhet që t’i marrë masat që ta ndërtojë shtetin sovran për së brendshmi dhe jo ta negociojë atë për çdo ditë me Serbinë.

Në një mbledhje që e kemi pasur me Grupin Parlamentar dje, kemi marrë vendim që ta parashtrojmë sot këtu një tekst, një projektrezolutë për të cilën pastaj kërkojmë që të votohet në Kuvendin e Kosovës.

Tekstin e kësaj rezolute po e lexoj tash, ndërkohë që natyrisht presim që edhe nga grupet tjera parlamentare të konsultohen me ne, nëse dëshirojnë që t'i shtojnë ndonjë gjë kësaj rezolute, ndonjë pikë të cilën ne ndoshta edhe nuk e kemi shkruar.

Teksti i projektrezolutës është, si vijon:

“Duke pasur parasysh vullnetin politik të popullit të Kosovës, të deklaruar historikisht përmes mënyrave të ndryshme që përfshijnë, por që nuk kufizohen në demonstratat popullore të viteve: 1968, 1981, 1989, 2004 e 2007, referendumi i vitit 1991 dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e shpallur më 7 shtator të vitit 1991, Lufta Çlirimtare e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës për çlirim dhe shkëputje nga Serbia.

Duke marrë parasysh rolin tejet të rëndësishëm të Kuvendit në rregullim republikan të shtetit, si përfaqësues i vullnetit të popullit dhe mbrojtjes i interesave të tij.

Duke u nisur nga neni 1.1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili e përkufizon Republikën e Kosovës si shtet të pavarur, sovran, demokratik, unik dhe të pandashëm si dhe duke u nisur nga neni 2.1 po i të njëjtës kushtetutë, i cili e definon popullin si burim të sovranitetit dhe ia njeh atij të drejtën e demokracisë së drejtpërdrejt përmes referendumit.

Duke i pasur parasysh kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës të përkufizuara në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke e pasur parasysh mandatin e deputetit si përfaqësues i popullit, i cili sipas nenit 70.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk i nënshtrohet asnjë mandati tjetër detyrues, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës e nxjerrin këtë:

R e z o l u t ë

1. Subjektiviteti politik e as pandashmëria territoriale e Kosovës nuk mund të jenë objekt negociatash me asnjë shtet a organizatë mbikombëtare,
2. Çfarëdo procesi bisedimesh me cilindo shtet duhet të paraprihet nga marrëveshja politike.
3. Bisedimet me Serbinë nuk duhet të ndodhin pa u plotësuar 4 parakushtet kryesore, këto janë:
 - a) Njohja dhe respektimi politik e faktik i pavarësisë së Kosovës - Serbia duhet ta njohë Republikën e Kosovës, duhet ta ndryshojë Kushtetutën e vet që e konsideron Kosovën si pjesë të pandashme të integritetit territorial dhe sovranitetit politik e juridik të Serbisë, si dhe duhet ta tërheqë përkrahjen politike dhe financiare për strukturat e saja ilegale që e cenojnë drejtpërdrejt sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës

- si dhe jetën dhe pronën e qytetarëve të Kosovës.
- b) Vënia në vend e drejtësisë për viktimat – Serbia duhet të kërkojë falje për të gjitha krimet e kryera në Kosovë përgjatë viteve sa e ka mbajtur nën okupim vendin tonë, si dhe duhet t'i kthejë pa kurrfarë kushti dhe pa vonesë rreth 1800 trupat e pajetë të shqiptarëve të Kosovës të vrarë gjatë luftës së fundit, duhet t'i dorëzojë kriminelët e luftës për t'iu nënshtruar procesit gjyqësor në Kosovë, si dhe ta nisë procesin e dënimit të kriminelëve të luftës të cilët gjenden të lirë në Serbi.
 - c) Reparacionet dhe dëmshpërblimi për shkatërrimet materiale të pronës – Serbia duhet t'i paguajë dëmet e luftës dhe okupimit, ta kthejë fondin e grabitur pensioanl të qytetarëve të Kosovës, t'i kthejë depozitat bankare që i ka grabitur nga qytetarët e Kosovës, t'i kthejë librat kadastralë dhe mbi 1200 eksponate kulturore të grabitura po ashtu nga Kosova.
 - d) Të drejtat reciproke - Serbia duhet ta ndërpresë shtypjen e shqiptarëve autoktonë në Luginën e Preshevës dhe shkeljen e të drejtave të tyre njerëzore dhe kombëtare, por edhe ndaj shqiptarëve të tjerë që jetojnë në Serbi. Serbia duhet të garantojë për shqiptarët me kushtetutë të drejta dhe liri të nivelit të njëjtë me ato të serbëve në Kosovë.
- 4. Edhe pas plotësimit të këtyre kushteve Kosova në asnjë mënyrë nuk duhet të negociojë me Serbinë rregullimin e brendshëm territorial dhe institucional të vendit, dhe pika e fundit.
 - 5. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Ekzekutivi dhe institucionet tjera përkatëse ndërprerjen e bisedimeve të përgatitura që të fillojnë më 8 mars 2011, dhe t'i nisë përgatitjet për grumbullimin dhe hartimin e dokumenteve dhe materialit tjetër të nevojshëm për argumentimin e kushteve të sipërpërmendura.

Ky është teksti i rezolutës të cilën e propozon lëvizja “Vetëvendosje”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Para se të filloj të paraqes cili është qëndrimi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duhet të them se nuk pajtohem me njërin prej parafolësve, i cili tha se kryeministri nuk tha kurrgjë. Kryeministri i tha disa çështje të cilat janë tepër të rëndësishme, tha se bisedimet po vazhdojnë, duhet të marrim shënim, edhe tha se e ardhmja e vendit varet nga bisedimet me Serbinë. Ma merr mendja se secilit prej jush po ju duket pak sa, në rastin më të mirë, si ekzagjerim.

Çështje tjetër është se kryeministri tha se dialogu i tejkalon përmasat partiake dhe ideologjike. Nuk është problem vetëm semantik ky, për shkak se po shihet se nuk po i tejkalon, realisht. Kryeministri ka qenë dashur të thotë: nuk duhet t'i tejkalojë ose dialogu duhet t'i tejkalojë përmasat partiake dhe ideologjike. Mirëpo, kryeministri dhe Qeveria e tij as tash as në të kaluarën nuk e kanë bërë as minimumin që kjo çështje e kësaj rëndësie që po jepet kaq të madhe, t'i tejkalojë këto përmasa, për shkak se çka do që ka bërë e ka bërë vetëm, bile, bile në shumë raste po shihet se edhe pa pajtimin e partisë së vetë, ka caktuar njerëz vetë, ka dhënë premtime

vetë, edhe tash shpejt e shpejt kërkohet prej Kuvendit të Kosovës t'ia miratojë diqysh çuditshëm krejt këtë punë që e ka bërë. Ka qenë dashur ta bëjë minimumin për të arritur në pozitë që dialogu me cilëndo vend fqinj, në këtë rast me Serbinë, t'i tejkalojë përmasat politike dhe ideologjike.

Ne sot duhet t'u përgjigjemi disa pyetjeve si deputetë të Kuvendit të Kosovës të cilat janë të natyrës politike, por edhe praktike të punës së Kuvendit, për shkak se ky është Kuvend. Pse bisedime? Pse tash, mendoj se një numër i madh i partive politike janë përgjegjëse, nuk kanë ndonjë agjendë tjetër përpos bisedimeve me vendet fqinje, mirëpo pse tash, pse kaq shpejtë dhe çka fiton Kosova? Çka fiton Kosova nëse nesër dikush shkon në Bruksel edhe fillon bisedimet me Serbinë? Ne nuk e kemi të qartë për shkak se nuk na është ofruar asnjë material, asnjë agjendë, as ndonjë qëndrim zyrtar i Qeverisë së Kosovës, të cilën do ta përfaqësojë e përzgjedhura për bisedime, do të thotë ne nuk e dimë çka do të përfaqësojë përfaqësuesja e Qeverisë.

Ne e kemi të qartë se Kushtetuta nuk ndryshohet pa 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, po kjo e bën edhe më të komplikuar krejt këtë çështje të bisedimeve për shkak se nëse dikush e di që nuk mund ta ndryshojë kushtetutën, pa 2/3, çka do të merren vesh me Serbinë para se të mbërrihet konsensus politik në Kosovë apo duhet prapë mbasi të merret vesh dikush me dikë prapa shpinës të popullit të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës, që të vijë dikush dhe të na bëjë presion neve atëherë t' i votojmë ndryshimet në kushtetutë. A po thotë diku që Kosova shkon me agjendë të qartë se nuk ndryshon kushtetuta e Kosovës, në asnjë pikë. Serbia ka platformë të veten, nuk e ndryshon kushtetutën e vet, në kushtetutë të Serbisë thotë që Kosova është pjesë integrale e saj. A ka mund t' i shkojë mendja dikujt në Kosovë që të jetë pikë e parë e agjendës kjo që ne kushtetutën tonë nuk e ndërrojmë, shembull ta marrim ose diçka tjetër? Thotë Kosova ka pak problem për të treguar se çka po fiton në këto biseda, çka fiton Kosova? Përderisa e kemi më se të qartë çka fiton Serbia, vetëm me faktin se ne kemi për t'u ulur në tryezë me ta, Serbia ofrohet drejt statusit të kandidatit për Unionin Evropian dhe pyetja jonë politike duhet të ishte a i kemi borxh ne Serbisë për t'ia bërë një nder, po flas me gjuhën më popullore të mundshme? Mendimi im është që jo, ne e kemi të qartë se në marrëdhëniet ndërkombëtare duhet të bisedohet, se në marrëdhëniet ndërkombëtare problemet zgjidhen me biseda bilaterale, por bisedat bilaterale duhet të qojnë te benefitet për të gjitha vendet që marrin pjesë në biseda, jo për benefite vetëm për njërin vend, thuaj ti se na i kemi shumë borxh Serbisë.

Çështje tjetër është se në Kuvend të Kosovës, ne sot kemi hyrë në një debat edhe na dalin dy rezoluta këtu na lexohen para nesh, për çështjen të cilën kryeministri i Kosovës e quajti më të rëndësishme në historinë e Kosovës. Dy çështje të çuditshme prapë, në vend se deputetët e Kosovës t' i kenë rezolutat, paraprakisht ne e kemi një kryetar të Kuvendit, që se ka kryer punën sot, me keqardhje, kemi të gjithë ata nënkryetarë të Kuvendit që ka qenë dashur t' i thonë Qeverisë, nuk është kjo mënyra për ta përgatitur seancën për një çështje kaq të rëndësishme, kjo nuk është mënyra edhe rezoluta edhe propozimet, cilat do që kishin qenë ato, ka qenë dashur që të diskutohen me Kryesi të Kuvendit e t'ju sillen deputetëve pak më herët e jo për të lexuar deklarata. Ne e dimë sa e rëndësishme ka qenë deklarata kushtetuese para dyerve të Kuvendit dikur, po nuk është më koha ashtu, jemi tri vjet shtet i pavarur për të lexuar deklarata para mikrofonit. Hajde, hajde se partitë opozitare s'kanë çka të bëjnë tjetër se janë ngushtur, po partia në pushtet. Qysh mund të dalë partia në pushtet para Kuvendit të Kosovës, të thotë po ju lexoj një deklaratë që është më e rëndësishmja për historinë e vendit, edhe mbani në mend ju edhe votoni tash pro asaj çështje? Do të thotë, Kuvendit sot i kërkohet që ta mbështes një propozim Qeverisë një propozim për të cilin është totalisht i paimformuar, totalisht i papërgatitur. Do të thotë

një Kuvendi i cili e din që nuk e kontrollon territorin e vetë edhe hyn në bisedime, i kërkohet të vendosë për diçka ta ndërtojë një konsensus këtu shpejt e shpejt pa e pyetur askënd. Pse duhet deputetët e opozitë t'i japin mbështetje Qeverisë së Kosovës për një ide të veten përderisa janë totalisht të pa informuar se çka po bënë Qeveria? Hajde se ka vullnet të mirë, po supozojmë, se ka vullnet të mirë për negociata edhe në partitë opozitare, vullnet në parim, po pse t'i mbështesim ne vendimet e qeverisë kur kurrkush nuk e informon askënd? Pse të marrim përgjegjësi për diçka që ndoshta totalisht është e gabueshme edhe ne mendojmë se në këtë fazë është totalisht e gabueshme.

Kuvendi sot nuk ka material, nuk ka agjendë edhe kur për çështjet më të rëndësishme thirret Kuvendi me propozim të qeverisë që të votohet kështu shpejt e shpejt, prapë disa njerëz po provojnë t' i qesin hi syve Kuvendit edhe t' i qesin hi syve popullit të Kosovës, për ta legjitimuar një proces i cili nuk duhet të legjitimohet në këtë mënyrë. Kjo është çka po kërkohet prej nesh sot.

Ne mendojmë se Kosova nuk është e përgatitur për këto negociata për ato që i thashë, për ato që i thanë parafolësit e mi, mendojmë se përgatitje nënkupton kërkesat e Kosovës të qarta, kundrejt Unionit Evropian, fillimisht kundrejt bashkësisë ndërkombëtare dhe garanca se çka fiton Kosova në këtë dialog, kjo do të jetë pjesa e parë, duhet të ketë agjendë dhe ne duhet ta shohim, Kosova duhet ta ketë agjendën e qartë për shkak se vetëm me agjendë ndërtohet strategjia, duhet ta dimë çka vjen më së pari, çka vjen së dyti. Ne duhet ta dimë përfundimisht edhe një herë pa e komplikuar se çka duhet të fitojmë.

Krejt këto që i thashë unë mund të duken për dikun që ndoshta edhe janë paksa ndoshta ekzagjerim, por po ju them se vetë fakti se sot kërkohet prej nesh ta legjitimojmë një proces të bisedimeve, domethënë që realisht janë negociata të cilat fillojnë nesër, dëshmon se nuk kemi të bëjmë vetëm me një proces i cili mundet të na duket neve paksa i kamufluar për shkak se ne jemi deputetë të Kuvendit të Kosovës e duam pavarësinë. Kjo ka të bëjë edhe me çështje tjera e mendoj se dikush diçka po fsheh. Nëse dikush nuk kishte fshehur fare diçka, atëherë ka qenë dashur, të paktën që deputetët e Kuvendit të Kosovës të informohen, paraprakisht, t'u sillet agjenda, t'iu sillen materialet.

Edhe një herë mendoj se kjo që po ndodh po dëshmon edhe një herë se nuk ka përgjegjësi shtetformuese me qeverinë aktuale të Kosovës, nuk ka përgjegjësi nacionale në këtë qeveri të Kosovës dhe fundi i fundit nuk ka as përgjegjësi politike dhe demokratike as para njerëzve që i kanë votuar as para Kuvendit i cili është organi më i lartë vendimmarrës në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi pritur që Qeveria sot të na ofrojë një plan më të detajuar për bisedimet e paralajmëruara me Serbinë, duke ditur kompleksitetin e këtyre bisedimeve, të cilat duhet ta pranojmë as nuk janë të dëshiruara, e as të ngutshme për Kosovën, sa janë për Serbinë. Megjithatë, tashmë është caktuar data e fillimit të këtyre bisedimeve dhe kryesuesi i delegacionit të Kosovës, por nuk dihen me

saktësi çështjet për të cilat do të bisedohet dhe cilat janë përfitimet e Kosovës në këtë proces, përpos dëshmisë para bashkësisë ndërkombëtare për gatishmërinë për të biseduar me fqinjë.

Kosova në filozofinë e saj duhet të ketë bashkëpunimin rajonal dhe integrimin me strukturat euroatlantike. Ne, si grup mbështesim çdo angazhim për dialog me vendet e rajonit e në këtë rast edhe me Serbinë, me çka do të fillonte normalizimi i raporteve ndërshtetërore.

Dua të shtroj një pyetje, të cilën ma merr mendja do të dëshironte ta dinte çdo qytetar i Kosovës. Çka do të përfitojë Kosova dhe qytetari i saj nga këto bisedime? A do të vazhdojë të mbetet edhe më tutje qytetari i Kosovës më i izoluari në Evropë? Cilat janë kërkesat e Kosovës për bashkësinë ndërkombëtare dhe për Serbinë? A do të duhej kushtëzuar këto bisedime Kosova edhe për Serbinë edhe për bashkësinë ndërkombëtare? Këto janë pyetje të cilat kam shpresuar se do t'u përgjigjet sot Qeveria.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e vitit 2010, bën thirrje për bisedime, por nuk jam i bindur se sot Kosova është aq e përgatitur për to edhe për faktin se ne akoma nuk kemi kompletuar institucionet e dala nga zgjedhjet.

A do të duhej sot Qeveria të na ofrojë një plan të detajuar të këtyre bisedimeve, se cilat do të jenë çështjet që do të bisedohen, cilat janë të priturat dhe cili është afati i këtyre bisedimeve apo do të jenë në pafundësi?

Serbisë duhet t'i bëhet e qartë se pa shpërbërjen e strukturave kriminale dhe ato shtetërore që financohen nga Serbia, nuk mund të llogaritet në seriozitetin e këtij dialogu.

Serbia në këtë proces duhet të kërkojë falje për krimet e kryera në Kosovë, jo vetëm në luftën e fundit, të shpërbëjë strukturat e veta në Kosovë dhe të ndalojë financimin e strukturave paralele, të zbulojë fatin e personave të kidnapuar, të dorëzojë kriminelët e luftës, të paguajë dëmet e luftës, t'ia kthejë Kosovës librat kadastral dhe pronën tjetër të Kosovës të cilën e ka bartur me vete gjatë tërheqjes, të lejojë qarkullimin e lirë të mallrave dhe të njerëzve nëpër territorin e Serbisë dhe të kthejë fondin pensional.

Bashkësia ndërkombëtare duhet që t'i bëjë të qartë Beogradit se nuk do të lejojë obstruksione gjatë procesit, ndërkaj Kosovës duhet t'i bëhet e qartë rruga e saj drejt Bashkimit Evropian, sidomos data e saktë për liberalizimin e vizave.

Grupi i Kosovës për bisedime duhet të jetë i kujdesshëm dhe ta ketë parasysh se nuk mund të bisedojë për: statusin politik të Kosovës, për sovranitetin dhe integritetin e vendit, si dhe për rregullimin e brendshëm të Kosovës.

Grupi për bisedime duhet jo vetëm ta njoftojë, por edhe të raportojë para këtij Kuvendi, pas secilit takim se çka është arritur me të.

Qeveria duhet të ndërtojë një konsensus, pozitë, opozitë, shoqëri civile, sepse çështjet e tilla tejkalojnë interesat e vetëm një grupi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, deputeti Sasha Rashiq e ka fjalën.

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsjedniče!

Poštovani premijeru, ministri,

Poštovani narodni poslanici,

Samostalna liberalna stranka je od osnivanja direktno ili indirektno učestvovala u svim procesima koji su imali za cilj poboljšanje uslova života srpske zajednice na Kosovu i ne samo srpske zajednice, već celokupnog društva na Kosovu.

Kroz institucije Kosova na lokalnom i centralnom nivou Samostalna liberalna stranka i dan danas daje svoj doprinos a sve u cilju, kao što rekoh, poboljšanja uslova života svih koji danas žive na Kosovu.

Verujući da će dolazeći pregovori doneti dobro ne samo srpskoj zajednici, nego svima koji danas žive na Kosovu i olakšati svakodnevni život i rešiti određene tehničke probleme, Samostalna liberalna stranka podržava pregovore između Prištine i Beograda. Svakako se želim zahvaliti Evropskoj uniji, međunarodnoj zajednici, Evropskoj uniji i Sjedinjenim Američkim državama na organizovanju ovih pregovora i Samostalna liberalna stranka će svojim eventualnim učešćem punim svojim kapacitetom dati svoj doprinos da se kroz pregovore dođe do rešenja prihvatljivi za sve.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsjedniče,

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Uvaženi poslanici,

Parlamentarna grupa „6+“ koja okuplja Bošnjake, Turke i Rome smatra da stabilnost Kosova, stabilnost regiona i priključenje Republike Kosova u Evropskoj Uniji su od najznačajnijih pitanja.

Parlamentarna grupa „6+“ smatra da prestojeći pregovori koji će se voditi između Republike Kosova i Srbije su od vrlo velikog značaja za obe strane. Smatramo da pregovori treba da se razvijaju jer mislimo da postoje puno nerešenih tehničkih stvari koje stvaraju poteškoće u svakodnevnom životu građana za obe države.

Agenda treba da bude jasna, prihvatljiva za obe strane i rezultati pregovora treba da budu prihvatljivi za obe strane, drugim rečima, optimalno rešenje bilo bi obostrano priznavanje obe države.

Smatramo da tema pregovora ne bi trebalo da budu pitanje teritorijalnog integriteta i suvereniteta naše države.

Kao Parlamentarna grupa „6+“ smo zainteresovani da u timu za predstojeće pregovore budemo aktivni učesnici i smatramo da ćemo dati veliki doprinos u tim pregovorima. Hvala, puno!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministri e ka kërkuar fjalën. E keni fjalën, kryeministër!

Grupet parlamentare janë kryer, tani janë deputetët e lajmëruar për debat.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Faleminderit, të nderuar shefa të grupeve parlamentare,

Unë dëshiroj që gjithë këtë proces ta sqaroj nga fillimi deri sot këtu ku kemi ardhur.

Ajo çka dëshiroj të them është se ne të gjithë e dimë të kaluarën e raporteve Kosovë – Serbi, ne të gjithë e dimë të kaluarën e hidhur, të errët dhe armiqësore, të gjithë e kemi përjetuar, të gjithë kemi sakrifikuar dhe sot e kemi Kosovën të lirë dhe të pavarur. Por, tani është hapur një kapitull i ri, ai i integriteteve euroatlantike.

Në pyetjen se çka fiton Kosova nga agjenda evropiane e bashkëpunimit të fqinjësisë së mirë me të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë: Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë, një fqinjësi e mirë reflekton në njohjen e Republikës së Kosovës edhe nga pesë vendet e tjera të Bashkimit Evropian. Pastaj, përshpejtimin e procesit të liberalizimit të vizave, sepse një nga parakushtet për liberalizimin e vizave, që është edhe një nga kriteret kryesore politike të Kopenhagës, është bashkëpunimi rajonal, pra, fuqizimi i bashkëpunimit rajonal, pastaj, menaxhimi i integruar i kufijve, zbatimi i marrëveshjes së CEFTA-s. Kështu që, të gjithë këto ndërlidhen drejtpërdrejt me kriteret e Kopenhagës, agjendën evropiane.

Pra, Kosova nga bashkëpunimi i fqinjësisë së mirë fiton pesë njohje të munguara nga vendet e Bashkimit Evropian, përshpejtimin e procesit të liberalizimit të vizave, pastaj përshpejtimin në procesin e integritetit në NATO (vitin e ardhshëm do të bëhet edhe vlerësimi i zhvillimit të Forcës Mbrojtëse të Kosovës), si dhe përshpejtimin e procesit për t'u integruar në Bashkim Evropian dhe anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Nuk do të ketë liberalizim të vizave, as anëtarësim në NATO, as në OKB, as në EU, pa normalizim të marrëdhënieve ndërshtetërore me të gjitha vendet e rajonit. Ky është një proces i dialogut dhe jo i negociatave, për qartësim.

Prandaj, kishte të drejtë njëri që, apo këtu u deklaruan dy shefat e grupeve parlamentare, njëri që kryeministri s' tha kurrëgjë dhe tjetri që tha shumëçka.

Unë kam folur atë që e mendoj dhe që kam qenë i përgatitur në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mund ta vlerësoni si të doni.

Por, dëshiroj të theksoj se unë i vlerësoj dhe i mirëpres të gjitha komentet që u prezantuan këtu dhe të gjithë deputetëve.

Kishte të drejtë Ardiani që e theksoi se ky është proces në vazhdimësi dhe jo i filluar sot, i bashkëpunimit ndërfqinjësor.

Prandaj, unë dëshiroj që sot, duke vazhduar me transparencën e plotë para të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës, të prezantoj pasi që pjesë të saj veç janë prezantuar edhe më herët, draft-kornizën për dialog teknik me vendet fqinje, por edhe me Serbinë.

Qeveria e Republikës së Kosovës është plotësisht e vetëdijshme që bashkëpunimi rajonal,

marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu janë çështje kyçe për stabilitet, zhvillim ekonomik dhe kusht për integrimin në NATO dhe Bashkim Evropian.

Kosova është përcaktuar për politikën e fqinjësisë së mirë, për integritet rajonale dhe evropiane.

Raportet e mira fqinjësore mund të krijohen vetëm në baza të marrëdhënieve që udhëhiqen nga politika e bashkëpunimit të drejtë dhe partneritetit reciprok.

Dialogu me Serbinë dhe vendet e tjera: Malin e Zi, Maqedoninë dhe Shqipërinë, në kuptimin e ndërtimit të një bashkëpunimi, është i dobishëm, është i pashmangshëm dhe do të hapë një kapitull të ri të zhvillimit të marrëdhënieve fqinjësore dhe rajonale.

Qëndrimi i Republikës së Kosovës në zhvillimin e dialogut me Serbinë, bazohet në Propozimin gjithëpërfshirës për statusin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si shtet i pavarur, i shpallur pas bisedimeve të gjata me shtetin e Serbisë, me ndërmjetësin e të dërguarit të Kombeve të Bashkuara, presidentit Ahtisaari dhe në koordinim dhe bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare.

Në procesin e negociatave të asaj kohe (ky është dialog, është dallim i madh), ka qenë i përfshirë i gjithë spektri politik, me përjashtim të njëri që nuk ka qenë në atë kohë në Parlament. Dhe, të gjithë e kanë mirëpritur, përshëndetur dhe Kuvendi, natyrisht tash me pjesëmarrje në zgjedhje gjithë e kanë përqaftuar dhe duartrokitur dokumentin e presidentit Ahtisari.

Për më tepër, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, dialogu me Serbinë është në përputhje edhe me rezolutën për Kosovën, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, datë 9 shtator 2010, rezolutë kjo e mirëpritur dhe përshëndetur nga Kuvendi i kaluar i Republikës së Kosovës.

Prandaj, Qeveria, të gjitha që i ka bërë, i ka bërë në përputhshmëri me vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, edhe Kuvendi i kaluar, edhe ky, por nga legjitimiteti i përfaqësuesve të zgjedhur të popullit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë i kuptoj edhe kritikën për dialog dhe mundohem t'i respektoj. Janë hedhur kritika të dialogut, për dialogun teknik me Serbinë. Këto kritika për mua dhe për të gjithë juve do të ishin shumë të mirëseardhura sikur të ishin ide për të fuqizuar dhe konsoliduar shtetin e Kosovës, ide këto që do të inkorporoheshin në platformën e Republikës së Kosovës për bisedime.

Prandaj, unë ju ftoj që në vend të kritikave, të prezantoni idetë dhe sugjerimet tuaja ndihmuese.

Kritikët, por edhe skeptikët që janë paraqitur të këtij procesi, kanë akuzuar, duke mos ofruar ide. Kanë akuzuar në vazhdimësi se Qeveria e Republikës së Kosovës ka mungesë të platformës.

Unë si kryeministër ju siguroj se Kosova ka platformën e saj që nga shtatori i vitit të kaluar. (Faleminderit, Ismet, se të kujtohet). Pra, si kryeministër ju siguroj se Kosova ka platformën e saj që nga shtatori i vitit të kaluar.

Kjo platformë është përgatitur qysh përpara se të aprovohej Rezoluta për Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Për më tepër, kjo platformë i është dhënë edhe zyrtarisht lehtësuesve të këtij dialogu, përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe elementet kyçe të saj janë plotësisht të pranuar nga Bashkimi Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse mungon diçka besoj që ish ministri i jashtëm, zoti Hyseni, mund të më plotësoj, pastaj ka qenë i kyçur edhe presidenti Sejdiu në takimet që kemi zhvilluar në të gjitha, në prezantimin e platformës.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që t'ju siguroj juve si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, por gjithashtu dua t'ju siguroj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, se Qeveria e Republikës së Kosovës në asnjë rrethanë nuk do të bisedojë me Serbinë për çështjet në vazhdim.

Në fakt, këto janë ato çështjet që në vazhdimësi ju kemi referuar si vija të kuqe, që i kemi përcaktuar herët, me kohë dhe shumë vendosmërisht dhe për të cilat nuk do të bisedohet me askënd, kurrë, e as me Serbinë.

E para, statusi politik i Republikës së Kosovës. Kosova ka shpallur pavarësinë në pajtim me vullnetin e popullit të Kosovës dhe pas shterjes së të gjitha mundësive për arritjen e një marrëveshjeje të pajtuar nga të gjitha palët. Shpallja e pavarësisë është bërë pas negociatave të gjata direkte dhe me ndërmjetësimin e të gjithë akterëve kryesorë ndërkombëtarë, të udhëhequr nga i emëruari i Kombeve të Bashkuara, ku janë përfshirë edhe Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Rusia. Për më tepër, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e dha mendimin e saj këshillëdhënës për Kosovën, duke konstatuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës është bërë në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Edhe në atë kohë kishte skeptikë se Kosova është e papërgatitur, por Kosova ishte super e përgatitur dhe shënoi fitore të thellë, bindëse, të argumentuar dhe historike.

Shteti ynë, deri më sot është njohur nga 75 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Kosova tashmë është anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe së shpejti do të bëhet anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Zgjidhja e statusit politik të Kosovës ka ndikuar dukshëm në krijimin e stabilitetit rajonal, zhvillimin ekonomik, përmirësimin e ekonomisë dhe pajtimin ndëretnik. Dhe, hapja e çështjes së statusit do të ndikonte direkt në cenimin dhe dëmtimin e këtyre arritjeve, ndërsa rezultati gjykohet të jetë i njëjtë.

Pra, kjo është pika e parë e vijës së kuqe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pika e dytë, - Çështjet që lidhen me integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Çdo diskutim që do të vinte në pikëpyetje integritetin territorial të Kosovës, do të jetë i papranueshëm prej institucioneve dhe popullit të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e bazuar në Propozimin gjithëpërfshirës për statusin, përcakton se, Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm.

Hapja e çështjes së ndryshimit të kufijve të Kosovës, në mënyrë të pashmangshme do të ketë implikime zinxhirore edhe në vendet tjera të rajonit, përfshirë: Serbinë, Maqedoninë, Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën e më tutje.

Pika e tretë, - Çështjet që janë në kundërshtim me Propozimin gjithëpërfshirës për statusin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është kriteri vital dhe parakushti i vetëm për funksionimin e shtetit të Kosovës.

Kushtetuta është hartuar si rezultat i një konsensusi ndërkombëtar dhe mbi bazat e Propozimit gjithëpërfshirës për statusin.

Kushtetuta qëndron mbi themelet e një kornize të gjerë legislative që garanton mbrojtjen e të drejtave të gjithë popullsisë së Kosovës dhe, në veçanti të komuniteteve jo shumicë në kuptimin afirmativ.

Kushtetuta përcakton parimet dhe dispozitat si dhe mekanizmat që garantojnë përfaqësimin e komuniteteve pakicë dhe rolin e komuniteteve në të gjitha institucionet publike.

Prandaj, hapja e diskutimit për çështjet të cilat veç janë të rregulluara me Kushtetutën e Kosovës, do të thotë cenim i Kushtetutës, gjë e cila është e papranueshme për Kosovën.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se pas përfundimit të një procesi të gjatë politik, i cili rezultoi me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe përmbylljes së dilemave sa i përket ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë, ne mendojmë se është koha të hapet, e ritheksoj edhe njëherë, perspektivë e re në zhvillimin e marrëdhënieve normale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në baza plotësisht të barabarta.

Frymën e marrëdhënieve të krijuara me vendet e tjera të rajonit synojmë ta përcjellim edhe në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht qëndrimit të Serbisë, pas dhënies së mendimit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Jemi të angazhuar dhe të interesuar që sa më parë të vendosim baza të një dialogu, e ritheksoj, jo negociatave, dialogut të mirëfilltë, që do të shpinte drejt tejkalimit të barrierave të krijuara me vite dhe krijimit të kushteve sa më të mira jetësore për qytetarët e dy shteteve.

Sfera e çështjeve që mund të diskutohen është shumë e gjerë, ndërsa dialogu për zgjidhjen e tyre do të jetë i vazhdueshëm, varësisht nga natyra e çështjeve që diskutohen dhe qëndrimit të palëve në dialog.

Konsiderojmë që sferat në të cilat duhet të përqendrohemi procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pra çështjet për të cilat Kosova ka gatishmëri për t'i deleguar, janë si në vijim:

1. Dialogu për zgjidhjen e problemit të krijuar nga lufta apo raporti që Kosova ka pasur me Serbinë në të kaluarën, konsiderojmë që duhet të fillojnë sa më parë dhe të përfshijë: bashkëpunimin reciprok për gjetjen e personave të zhdukur, kthimin e dokumentacionit kadastral të regjistrave civil të pronës nga Serbia, kthimin e refugjatëve në pronat e tyre, çështjet e kthimit të fondit pensional për qytetarët e Kosovës, vendosjen e demarkacionit të kufirit mes dy shteteve, marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Serbisë. Pastaj, dialogun për çështje të bashkëpunimit rajonal, anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e plotë e Kosovës ... e Serbisë në iniciativat dhe mekanizmat rajonalë, tejkalimin e pengesave për lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë nëpër Serbi dhe anasjelltas, njohjen e pasaportave, të tabelave të veturave e më tutje. Marrëveshjet që kanë të bëjnë me respektimin dhe zbatimin e CEFT-s, bashkëpunimi në sektorin e energjisë në përputhje me Traktatin e Athinës, pastaj bashkëpunimi ndërshtetëror në fushën e transportit hekurudhor, të transportit ajror, telekomunikacionit.

Pra, e ritheksoj edhe një herë, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj, i gjithë procesi ka qenë, është dhe do të mbetet transparent edhe unë personalisht edhe zëvendëskryeministrja përgjegjëse për dialog do të jemi vazhdimisht në Kuvend për të informuar, duke ju ftuar edhe sot të gjithëve për t'u integruar në mbështetje të plotë dhe marrë përgjegjësitë që mund të na takojnë bashkërisht, në mënyrë që kjo platformë të plotësohet, të fuqizohet dhe pastaj dhe të dialogohet.

Natyrisht që çështja e ndërmjetësuesit apo lehtësuesve të këtij procesi të dialogut teknik është zgjidhur në përputhje të plotë me kërkesën tonë. Zoti ish ministër i Jashtëm, Hyseni, dhe presidenti, Sejdiu, janë dëshmitarë të gjitha këtyre takimeve. Dhe, ky ndërmjetësim apo lehtësim është i faktorëve me të cilët kemi negociuar në Rambuje dhe në Vjenë dhe është mbështetje e plotë edhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Në fund, më lejoni të sqaroj gjithashtu edhe një gjë shumë të rëndësishme. Përmes këtij dialogu ne synojmë, ritheksoj edhe një herë, njohjen sa më të shpejtë edhe të 5 vendeve të Bashkimit Evropian, përsheptimin e procesit të liberalizimit të vizave, anëtarësimin sa më të shpejtë në NATO dhe Bashkim Evropian dhe ky proces me bindje të plotë të përmbyllet me njohjet reciproke mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ju faleminderit!

Çdo herë që e përmenda edhe ish ministrin dhe ish presidentin Sejdiu, e përmenda në kuptimin më pozitiv dhe afirmativ të mundshëm mbështetës dhe pjesëmarrës të këtij procesi të përbashkët që e kemi zhvilluar dhe jo ta politizoj në kuptimin ndërpartiak në kryerjen e përgjegjësiave shtetërore! Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë, ta ka përmendur emrin, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk po hy gjatë në ato që i tha kryeministri, por mendoj se është për t'u shënuar se kryeministri tha se po vazhdojnë bisedimet dhe në të njëjtën kohë tha që po fillojnë bisedimet. Ndoshta është mirë për të thënë - po fillon vazhdimi ose diqysh ta lidhë, se nuk bën edhe të fillojnë, edhe të vazhdojnë në të njëjtën kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ndoshta ke të drejtë, i nderuar deputet.

Është një proces i vazhdimësisë së përgatitjeve me komunitetin ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, ndërsa dialogu fillon në të ardhmen.

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e deputetëve të lajmëruar për debat. Po, jam i obliguar t'ju njoftoj për një praktikë të mirë të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili më njoftoi paraprakisht se sa deputetë do të lajmërohen për diskutim në këtë seancë. Përveç kryetarit të grupit, për debat do të angazhohen nga Lidhja Demokratike, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Lutfi Haziri dhe Vjosa Osmani. Mendoj që kjo duhet të jetë një praktikë e mirë edhe për grupet tjera.

Tani vazhdojmë sipas radhës së paraqitjes.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë të nderuar e të çmuar deputetë,

Në dy paraqitjet e kryeministrit sot këtu, unë pash një sublimim, një variant të deklaruar të testamentit politik rugovian, i cili thotë: "Kosova e pavarur e demokratike, e integruar në NATO e në BE, në raporte të përhershme dhe speciale me SHBA-të" Unë i uroj sukses në Klubin rugovian, sa i përket kësaj deklaratë.

Kolegë të dashur,

Të gjitha negociatat mes Kosovës dhe të Serbisë në dy deceniet e fundit kanë dështuar. Të dhënat thonë kështu, jo ne, po të dhënat. Retorika politike e formulimit të sojit - ta harrojmë të kaluarën, të merremi me të ardhmen, është një utopi politike. Në raportet në mes të Kosovës e të Serbisë, e kaluara, për fat të keq, është edhe e tashme.

Për ta bërë edhe pak më të qartë, ne edhe sot e dëgjuam në variantin kryesisht të kryeministrit, të kemi mentalitet evropian, e jo të së kaluarës. Keni kujdes, sepse mentalitet evropian nuk do të thotë të mos e konsiderosh të kaluarën, hiq bile, shumë pak. Me të kaluarën evropianët merren më shumë se ne, për fatin e zi tonin.

Evidencat edhe më tutje thonë: prova e gjenocidit serb në Kosovë, ka vrarë rreth 20 mijë, gjysmën e popullsisë e ka shpërngulur me dhunë, rreth 120 mijë shtëpi janë shkatërruar, janë shkatërruar biblioteka, librat e gjendjes civile janë vjedhur, mijëra artefakte janë rrëmbyer, librat kadastrale janë vjedhur, fondi pensional është tjetërsuar, mbi 1800 njerëz që i konsiderojmë të pagjetur, nuk japin as shenja ku janë, shkurt i bie, janë vdekur, janë mbytur dhe janë vjedhur kufomat.

Evidencat thonë, po ashtu, Serbia nuk e njeh Kosovën dhe pengon njohjen e Kosovës, financon e organizon vija pushtetore ilegale në Kosovë dhe pengon zhvillimin e saj ekonomik e demokratik. Atëherë, si do të ndërtohet barazia në dialogun, vullneti për dialog dypalësh, gjesti për shtendosje dhe përmirësimi i marrëdhënieve? Nisma është në dorë të Serbisë, nuk është në dorë të Kosovës. Të kërkojë falje për gjenocidin në Kosovë, të kthejë të pagjeturit, të kthejë librat e gjendjes civile dhe librat kadastral, të kthejë artefaktet, krejt këto janë sende që i ka rrëmbyer, s'është punë bisedash, çka ke të bisedosh për to? Ta kthejë Fondin pensional, të ndalë pushtetin

ilegal dhe financimin e tij në Kosovë. Të gjitha këto mund t'i bëjë Serbia njëanshëm, sot ose nesër.

Sa i takon dialogut a vullnetit për bisedime, mund të shtrohen disa pyetje, për të kërkuar dhe disa përgjigje.

Nën një, a ka obligim ndërkombëtar Kosova të bëjë sot dialog me Serbinë? Po, sipas rezolutës së Asamblesë Gjenerale të Kombeve të Bashkuara të datës 9 shtator 2010. Ky dialog, po citoj unë atje, sepse është një rezolutë tepër e rrumbullakësuar, që i ka dy fraza krejt, thotë: “Ky dialog do të kishte për qëllim promovimin e bashkëpunimit, arritjen e përparimit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe të përmirësojë jetën e qytetarëve”. Pra, këto janë shenjat e kësaj rezolute, në cilën bile as që përmendet, thotë dy palë, po s’dihen kush janë se s’përmendet as Kosova, as Serbia.

Kjo ka ndodhur mbas mendimit të GJND-së, që ka qenë një fitore për Kosovën, e cila është kthyer, nuk po them krejt në humbje, po në relativizim total me këtë rezolutë, të cilën ju e dini mirë, e kanë sponsoruar Serbia, bashkë me BE-në. Kjo e jep atë “po”-në që thashë unë, si obligim.

E dyta, çka do të arrijë Kosova në këtë kërkim? Hapjen e perspektivës për liberalizimin e vizave, u tha nga kryeministri, lëvizjen e lirë në zonën Schengen ose në BE, por këto para gjithash i detyrohen zhvillimit të brendshëm tonit dhe vullnetit të BE-së ta afrojë këtë me masa konkrete, jo me deklarime shumë të përgjegjshme politike, qysh ka ndodhur edhe deri sot. Pa e përsëritur, po e them, frazën e harxhuar për perspektivën evropiane të Kosovës, se perspektivën evropiane të Kosovës s’mund t’ia falë askush, ajo s’është dhuratë, atë ose kemi për ta krijuar ne, ose ka për të qenë një përrallë mijëvjeçare, domethënë ajo ndërtohet brenda perspektiva, nuk merr t’i leje prej kujt do qoftë, një funksionari evropian të sotëm, a djeshëm, a të nesërm, të ta japë perspektivën evropiane, se është problem i zhvillimit të brendshëm, apo BE-ja s’ka çka ta luajë këtu rolin e lehtësuesit, që po i thonë - fasilitorit, se këtë funksion s’e ka, në rast se këtë funksion e merr për t’i krijuar favore Serbisë që të bëhet kandidat për BE-në. Le të bëhet Serbia kandidat për BE-në, s’është problem i ynë ai, mirë nëse bëhet. Problem i Kosovës është të bëhet vetë kandidat, të shpejtojë në zhvillim që të kapë interesat e vet, kjo është çështja e Kosovës. Dhe, nëse bën dialog, do të bëjë dialog për këto përfitime, përndryshe s’ka pse.

E treta, si të përmirësohet jeta e qytetarit? Tri herë po i referohem atyre farë nënvizimeve që i ka kjo rezolutë e famshme e 9 shtatorit. Me punë praktike që rrisin bashkëpunimin për interesa të përbashkëta të qytetarëve të dy vendeve, punë që prapë nuk mund të arrihen pa pranuar normat e marrëdhënieve demokratike dhe pa njohur normat e vullneteve politike, institucionale të dy vendeve: prona, lëvizja, qarkullimi, të gjitha këto me parime, norma e garanci ndërkombëtare.

Nëse dialogu Kosovë – Serbi është i paevitueshëm e i domosdoshëm, kryeministri tha është i paevitueshëm, në një formë, qysh e dëgjova, ndoshta jo fjalën, po kuptimi është ky, atëherë Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të kërkojë nga Qeveria kornizën e bisedimeve, formatin e bisedimeve, regjistrin e saktë të çështjeve praktike të bisedimeve, duke ruajtur detyrimin kushtetues e qytetar që të bëjë të vlefshme rezultatet vetëm pas ratifikimit në këtë Kuvend. Pra, Kuvendi aprovon strategji dhe korniza dhe aprovon rezultate të strategjive të kornizave, çdo që tjetër nuk e bën faktor Kuvendin, po e bën vend ku flitet edhe ky dhe informohet, si u dëgjua sot. Unë mendoj që Kuvendit këtë rol nuk ia lejon kushtetuta dhe nuk do ta marrë vetë, te organi që informohet për diçka që ndodh.

Kjo në vazhdim do të thotë që dialogu, kjo në fillim do të thotë që Kosova mund të dialogoje vetëm si shtet i pavarur dhe i barabartë për nevojën e vendit e të qytetarëve të vet. Kjo në vazhdim do të thotë që dialogu duhet të ketë të përcaktuar fillimin e fundin në kohë, në mënyrë që të mos niset si vullnet i mirë për të zgjidhur probleme e të degjenerojë në pengesë e bllokada për zhvillimin e Kosovës ose të legjitimojë status quo, qoftë politike, qoftë demokratike, qoftë të zbatimit të ligjit. Dhe, në fillim edhe në fund, kjo do të thotë - të mos bisedohet e të mos pranohet asgjë që nuk respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kolegë të mi të dashur,

Të lutem, i kam edhe dy fjalë, mos ma ndal, se e kam të drejtën ta marrë edhe kohën e dikujt, po s'po e marr.

Pra, ne këtu dëgjuam që në hyrje, që është pak e panatyrshme, e pazakonshme të propozohet mbyllja pa u nisur diskutimi, po unë besoj që deputetët do të diskutojnë dhe janë të lirë nga 10 minuta e vet t'i shfrytëzojë kush do, për këtë problem kaq të madh, dy rezoluta, që është interesante për hesap timin, unë çka dëgjova këtu, sepse dialogun s'e refuzon asnjëra, veç njëra s'merr parasysh kurrfarë kushtesh, e tjetra parashtron kushte pak a shumë, që janë zhvillime interesante. Sido që të jetë, unë mendoj që s'është dashur të lexohet bash asnjëra, po të provohet të diskutojnë të gjithë deputetët dhe të gjithë të përpiqemi të sublimojmë atë që del nga diskutimet në Kuvend, sepse kjo është rruga më e dobishme, më e nevojshme për të arritur një mendim të përbashkët. Faleminderit!

Seancën e drejton nënkryetari i Kryesisë, Xhavit Haliti

XHAVIT HALITI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nuk është problemi që bisedimet e paralajmëruara nuk kanë agjendë, por që agjenda e bisedimeve nuk është publike. Nuk do të ishte e mundur të thuhej që bisedimet nisin nesër, pra më 8 mars, sikur të mos dihej fare agjenda. Agjenda dihet, por nuk e dimë atë ne si qytetarë e si deputetë.

Agjenda e bisedimeve po mbahet fshehtë, në mënyrë që bisedimet të nisin mbarë, përkundër agjendës së mbrapshtë. Agjenda e këtyre bisedimeve i sillet rrotull 6 - pikëshit famëkeq të Ban Ki Mun- it, prandaj edhe mbahet e fshehtë. Këto bisedime e cenojnë vetë qenien tonë, sepse Kosova është edhe palë në bisedime, por edhe temë e bisedimeve.

Bisedimet u pranuan pa u biseduar fare për to. Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri u emërua si kryenegociatore pa vendim zyrtar a institucional për bisedime dhe pa debat publik e parlamentar. Për çështjet si këto, jo vetëm që duhet të vendosë Kuvendi, por është shumë normale që të organizohet edhe referendum gjithëpopullor.

Gatishmëria për bisedime nënkupton gatishmëri për kompromis. Lehtësia me të cilën Qeveria e Kosovës i ka pranuar këto bisedime me Serbinë, pa kurrfarë kushtesh, paralajmëron lehtësi me të cilën ajo do ta pranojë kompromisin në fund. Për çka do që Qeveria e Kosovës do të bisedojë me

Serbinë, ajo do të pranojë që ajo gjë nuk i takon Kosovës, pra që ajo gjë është çështje e diskutueshme. Me këto bisedime nuk do të gjejmë përgjigje për pyetjet, por çështje të brendshme të Kosovës do të vihen në pikëpyetje.

Pavarësia formale e Kosovës njëmend na solli shumë pak si shtet, por me këto bisedime, pa agjendë publike dhe me një kryenegociatore, pa platformë për negociata, gjithçka është e rrezikuar. Agjenda përcakton se çka është e negociueshme dhe çka është e panegociueshme. Duke e mbajtur agjendën e fshehtë, Qeveria e Kosovës na e ka dëshmuar që e vetmja gjë e panegociueshme për të janë vetë negociatat.

Me këtë mënyrë të të bërit politikë, Republika e Kosovës nuk është më Republikë parlamentare, por është Republikë qeveritare. E, nëse politika e Republikës vazhdon të mbetet pa Parlament, atëherë edhe qeveria e shtetit shpejt do të mbetet pa Republikë.

Këta qeveritarë kanë deklaruar se do ta përfshijnë edhe opozitën e shoqërinë civile në bisedime me Serbinë. Së pari, ata po orvaten që ta shmangin vëmendjen nga bisedimet e pranuar te biseduesit ende të papranuar. Dhe, së dyti, ata duan ta mbajnë pushtetin për vete e ta ndajnë fajin me gjithë të tjerët. Problemi me këto bisedime nuk është te përfaqësimi i pamjaftueshëm në bisedime, por te pronësia e pamundshme mbi këto bisedime.

Ne s'jemi të lirë që të bisedojmë lirshëm me Serbinë. Serbia është shtet me ushtri e polici të veten dhe me institucione shtetërore që janë sovranë, pa instanca ndërkombëtare mbi kokën e tyre, kurse në Kosovë është KFOR-i mbi FSK-n, është EULEX-i mbi policinë e Kosovës dhe janë Pieter Feithi me dy kapelat e tij e ambasadori amerikan Dell, pa kapelë, përmbi të gjitha institucionet e Kosovës. Neve, jo vetëm që nuk na njeh e pranon Serbia, por edhe ndërmjetësi, pra Bashkimi Evropian, e njeh Serbinë, që s'na njeh neve dhe nuk na njeh neve porsi Serbia. Kjo pabarazi drastike është padrejtësi elementare që doemos është reflektuar edhe në agjendën e fshehtë dhe s'ka se si të sjellë rezultate të mira për neve.

Përderisa ne ndodhemi nën protektorat ndërkombëtar, Serbia vazhdimisht do të kërkojë negociata me ne, sepse, ajo fiton koncesione të reja dhe në fund s'ka nevojë ta pranojë tërësinë e atyre koncesioneve, pasi që e din që sundimi ndërkombëtar në Kosovë do t'ia imponojë Kosovës zbatimin e njëanshëm të atyre koncesioneve. Të gjithë e mbani mend që Serbia e dëshiroi decentralizimin etnik në Kosovë, të drejtën e vetos për serbët në këtë Kuvend për të gjitha ligjet për çështjet jetike, shuarjen e TMK-së, pjesëmarrjen e Kosovës në borxhin e jashtëm të Serbisë, zonat e veçanta për trashëgiminë kulturore ortodokse që i nënshtrohen serbizimit etj. etj. por ajo nuk e pranoi tërësinë e këtyre koncesioneve që u quajt Paketa e Ahtisarit pasi që e dinte që Qeveria e Kosovës, duke qenë përfundim sundimit ndërkombëtar, do t'i implementojë një nga një të gjitha këto. Duke qenë josoovran, në bisedime me Serbinë, vetëm sa zvogëlohet perspektiva jonë për t'u bërë sovran ndonjë ditë.

Këto negociata njëmend kanë të bëjnë me integrimet evropiane, por ama me integrimin e Serbisë në BE dhe jo me integrimin e Kosovës në BE. Këto bisedime nuk kontribuojnë fare në integrimin e Kosovës në BE. Përkundrazi, me këto bisedime ne bëhemi si Bosnja të cilën BE-ja nuk e pranon pikërisht pse është tepër e decentralizuar për të qenë sovranë. Dhe, për shkak se Serbia do të hyjë para nesh në BE, ajo mandej do të na kushtëzojë ngjashëm siç bën Greqia me Maqedoninë.

E dëgjuam kryeministri kur tha se në fund pason njohja reciproke, por edhe Milosheviqi e ka njohur Bosnjën, jashtë Serbisë, atëherë kur Izetbegoviqi e ka njohur Serbinë, brenda Bosnjës. Nuk është me rëndësi njohja reciproke çka është me rëndësi çfarë shteti brenda po bëhesh, a po bëhesh shtet sovran e me integritet territorial apo po bëhesh si Bosnja? Me planin e Ahtisarit është hedhur farë e bosnjëzimit, këta po e qojnë më tutje këtë.

Në fillim të shekullit XX, Serbia e pat okupuar Kosovën, kurse në fund të shekullit XX, Serbia kreu gjenocid ndaj popullit të Kosovës. Përgjatë këtij shekulli populli ynë aq shumë u shtyp e u diskriminua, kurse pasuritë e vendit tonë aq egër u shfrytëzuan sa që mund të themi se pikërisht shqiptarët janë e vërteta e Serbisë. Mirëpo, në takimin e nesërm në Bruksel, zonja Edita Tahiri do ta maskojë këtë të vërtetë. Ajo do të mundësojë që Serbia të duket ashtu siç nuk është, të duket e mirë me shqiptarët ndaj të cilëve nuk lëshon asnjë shans t'ua nxijë jetën dhe të fitojë poenë për fqinjësinë e mirë karshi Kosovës brenda së cilës i financon dhe dirigjon strukturat e saj ilegale.

Milloseviqi, Koshtunica dhe Tadiqi kanë dallime kur shihen nga Brukseli, Nju Jorku apo Uashingtoni, por jo edhe kur shihen nga Prishtina. Ata i kanë qëllimet e njëjta, kurse mjetet iu ndryshojnë kryesisht vetëm në masën në të cilën rrethanat kanë ndryshuar. Serbia i ka shumë borxh Kosovës dhe shqiptarëve. Borxhet që na i ka Serbia duhet të jenë kusht për bisedimet me të. Bisedimet pa kushte me Serbinë, janë falje ndaj saj, pa na kërkuar ajo njëherë ajo falje neve.

Kosovës nuk kanë se çfarë i duhen këto bisedime. Këto bisedime po i nevojiten kryeministrit Thaçi për pushtet e jo Kosovës si shtet. Politikanët e korruptuar e të shantazhuar si puna e Hashim Thaçit, po i pranojnë negociatat në mënyrë që korrupsioni e shantazhi ndaj tyre, të bëhet i negociueshëm.

Në kohën kur kemi gjithnjë e më pak bukë e vende pune dhe gjithnjë e më shumë premtime që nuk i rrisin pagat, por çmimet, qeveria ka vendosur tinëz për spektaklin nga Brukseli, të cilin do ta paguajmë shumë shtrenjtë.

Neve na duhen bisedime me Tiranën e jo me Beogradin. Ne duhet të koordinohemi si komb dhe t'i harmonizojmë hapat strategjik që të bëhemi komplementarë e jo të jemi konkurrentë. Ne duhet t'i kthehemi vetes, ne duhet ta lidhim sistemin energjetik të Kosovës me atë të Shqipërisë; ne duhet t'i përafrojmë sistemet fiskale drejt integritetit në një zonë tatimore dhe doganore etj. etj. ta realizojmë shtetndërtimin si sovranitet dhe zhvillimin ekonomik si prodhim. Asnjëra prej këtyre

nuk bëhen nga bisedimet me Serbinë, secila prej këtyre bëhet shumë më kollaj në bisedime me Shqipërinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues, unë pritja pak më vonë.

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër, veçanërisht ministrat e rinj,

Përshtendës kolegët deputetë, veçanërisht deputetët e rinj dhe grupet e reja këtu në Kuvend, Përshtendës edhe këtë debat, të cilin e konsideroj të rëndësishëm, sado që është i vonuar dhe e konsideroj të një rëndësie vërtet të gjerë që zor mund të futet në korniza të ngushta parciale e partiake. Është diçka që na bashkon dhe do të duhej të na bashkonte. Është mirë që ky debat është sjellë këtu në Kuvend, Kuvendi është vendi i artikullimit dhe i operacionalizimit, do të thosha, edhe i koordinimit të opinionëve, qofshin ato edhe hetoregjene në shoqëri.

Po, ne në këtë debat po vijmë me shumë hendikepe, përveç tjerash pos se është i vonuar, kemi edhe një konfuzion me konceptet. Tani po bisedojmë për dialog dhe po na pëlqen ta quajmë si dialog, por kur vjen puna për të biseduar për ekipin, themi ekipi negociator. Në Beograd, e dëgjoj flitet për “pregovori”, që shqip i bie bisedime dhe këto nuk janë e njëjta gjë. Pa dashur të stërholloj, po na pëlqen ta quajmë bisedime teknike, praktike teknike, por zor është pastaj ta justifikojmë pse ne atëherë angazhojmë një nga postet më të larta qeveritare, zëvendësen e kryeministrit për bisedime të tilla? Bisedimet teknike praktike bëhen nga personeli teknik e praktik dhe jo nga funksionarë të lartë. Krijohet kështu përshtypja sikur nuk e kemi krejt të qartë çka po bëjmë, ku po shkojmë dhe ku do të arrijmë? Aq më tepër kur në çështje që i quajmë teknike, praktike na janë futur edhe çështje që zor se mund të konsiderohen të tilla dhe defekti tjetër është që ne, pos që jemi vonuar, sepse kemi hezituuar kur duhet dhe nuk e kemi marrë iniciativën, kemi hyrë në agjendë që praktikisht nuk ka qenë e jona. Nuk kemi pasur rol të duhur në atë që quhet bisedime për bisedimet, nuk kemi pasur rol të duhur edhe në ndikimin për të krijuar masat e mirëbesimit të cilat i paraprinë praktikisht çdo procesi, qoftë dialogut, qoftë bisedimet. Shtrohet pyetja, çka ka bërë Beogradi për të bindur palën tjetër, Kosovën se ka një vullnet të mirë për të hyrë në këtë proces? Praktikisht, asgjë. Për më tepër, janë liferuar dhe liferohen vazhdimisht mesazhe që qojnë në përfundimin se, siç u tha, politika ndaj Kosovës nuk ndryshon dhe le të jemi të lirë ta themi dhe le të mirëkuptohemi, për të tjerët mund të ketë kritere të ndryshme për të vlerësuar shkallën e ndryshimeve dhe të demokratizimit në Serbi, por për ne nuk mund të mos jetë qëndrimi ndaj Kosovës në radhë të parë, qëndrimi ndaj të ardhmes tonë.

Ne mund të flasim për pajtim e për normalizim dhe duhet të flasim, duhet të ishim edhe më agresiv në këtë çështje, duhet të merrnim ne nisma, askush nuk duhet ta kontestojë këtë. Por, ama

një gjë është e qartë, mund edhe të falim diçka nga e kaluara, por nuk mund të falim në asnjë variant të ardhmen, kurse zonja dhe zotërinj, shpesh ne na kontestohet dhe na rrezikohet e ardhmja dhe këtë s'mund ta gëlltisim lehtë, s'mund ta gëlltisim lehtë duke i kthyer në çështje teknike disa çështje, ta zëmë, të cilat objektivisht janë të panegocijueshme. Për mua është e pakuptueshme, ta zëmë, si mund të bisedojmë për dokumentet kadastrale ose dokumentet e shërbimit civil? Ai është krim. I janë plaçkitur Kosovës dhe tash ne duhet të fillojmë dialog, bisedime për të kthyer atë që është vjedhur, është marrë në mënyrë të paligjshme edhe me ligjet e ish Jugosllavisë edhe me ligjet e Serbisë vetë ato janë ilegale. Pse ne duhet të bisedojmë për diçka që s'është e bisedueshme, kurse kemi sa e sa çështje tjera të cilat nuk i kemi futur në agjendë. Për shembull, pse nuk bisedojmë për plaçkitjen e madhe që i është bërë popullit të Kosovës, pse nuk bisedojmë për krimet, pse nuk bisedojmë për pasojat e kolonizimit e sa e sa shfaqje të politikës gjenocidale ndaj Kosovës, pse nuk bisedojmë, ta zëmë, për Fondin pensional e kështu me radhë.

Edhe sot këtu po na përvijohen dy qëndrime, një, bisedime me çdo kusht dhe një tjetër jo bisedimeve, bisedime me asnjë kusht. I konsideroj të dyja të njëanshme.

Mendoj që në mes na ka munguar edhe në të kaluarën, po na mungon edhe sot qëndrimi që është i përgjegjshëm konform porosisë së ish presidentit amerikan John Kennedy, i cili thoshte tekstualisht: "Kurrë të mos negociojmë pa pasur frikë, por kurrë mos të kemi frikë për të negociuar". Për mendimin tim, Kosova nuk ka arsye për t'iu frikësuar dialogut, qoftë edhe bisedimeve, qoftë edhe negociatave, nëse Kosova i qaset siç duhet si partner i barabartë me pjesëmarrje edhe në ndërtimin e agjendës edhe në bisedime për bisedimet dhe në gjithë procesin. Kosova ka arsye, përkundrazi, për të insistuar në këto bisedime, por Kosova nuk i ka kushtet që të hyjë në negociata, qoftë edhe në dialog në mënyrë noshalante, siç po krijohet përshtypje pa përgatitjet e duhura, pa sqaruar sa duhet pozicionin e saj dhe duke e rrudhur qëndrimin e saj, siç na ka ndodhur edhe në të kaluarën.

Unë mendoj se këto dy qëndrime duhen bashkuar, do të thosha, madje se mund të bashkohen edhe dy tekste të rezolutës që unë i dëgjova. Rrezikoj të quhem eklektik e sinkretist, por një qasje konstruktive për mendimin tim mund t'i shkrijë dy rezolutat. Në një rezolutë që do të ishte po për dialog, por po edhe për bisedime, po për çështje që janë të dialogueshme dhe që janë të bisedueshme dhe me kriteret që u theksuan nga këtu dhe zor është t'i kontestosh, qoftë ato që thuhet prej opozitës, qoftë edhe ato që janë në favor të bisedimeve si interes i Kosovës, të thëna nga përfaqësuesit e Qeverisë, hiq këtu ato që nganjëherë është ekzagjerim dhe është edhe jo adekuate.

Unë angazhohem për një qasje të tillë. Për mendimin tim, një çështje është e rëndësishme këtu që qëndrimi i Kosovës kësaj radhe të jetë pa ekuivoke, në të gjitha çështjet që e preokupojnë opinionin kosovar që edhe janë pjesë e pa anashkalueshme e kauzës së Kosovës dhe kjo mendoj

nënkupton edhe një qasje të reciprocitetit, nëse flitet për çështje praktike të një komuniteti brenda Kosovës.

Çështje të cilat duhen mirëpritur, Kosova ka pretenduar të jetë kampion në zbatimin e të drejtave të minoriteteve dhe kjo e nderon Kosovën e re. Mendoj që këtë duhet ta themi, jo pse na detyron dikush, po pse është pjesë e programit tonë. Por, askush nuk duhet të na marrë për të keq nëse ne insistojmë që të njëjtat standarde të zbatohen edhe jashtë Kosovës, jo vetëm në Kosovë në të gjitha pjesët e saj, por edhe në pjesët e banuara me shqiptarë brenda Serbisë.

Veriu i Kosovës, Leposaviqi, Zubin Potoku, janë probleme ekuivalente me Preshevën e Bujanovcin, pse mos t'i shtojmë si probleme ekuivalente? Problemet ekuivalente duan edhe zgjidhje adekuate, reciproke që s'mund të jenë me kute të ndryshëm.

Unë angazhohem që një qëndrim të tillë ta ndërtojë Qeveria jonë në platformën e saj, të cilën do të duhej të na e kishte sjellë më herët, që grupet parlamentare të harmonizojnë qëndrimet që u shprehën këtu dhe do të shprehen edhe në diskutimet e më vonshme dhe të dalin me një qëndrim unik që i përgjigjet momentin në të cilin jetojmë dhe aspiratave të popullit të cilin e përfaqësojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Do ta hap fjalën time me një shënim rreth asaj çfarë tha kryeministri se Kosova duhet të bisedojë me Serbinë për shkak të liberalizimit të vizave.

Unë po ia përkujtoj kryeministrit Thaçi që janë disa standarde të njohura ndërkombëtarisht edhe këtu në Kosovë, që lidhen me liberalizim të vizave, që Kosova është shumë larg për të filluar për t'i përmbushur apo Qeveria juaj është shumë larg që të fillojë përmbushjen e tyre, sepse lidhen me rendin dhe ligjin, lidhen me një qeveri e cila duhet të jetë e pakorruptuar dhe të luftojë korrupsionin në vepër, lidhen me lirinë e mediave, lidhen edhe me standardet e tjera të cilat ju siç shihet ashtu siç keni filluar nuk e keni as idenë se si duhet t'i përmbushni. Po kthehem te dialogu dhe gjithashtu po ju përkujtoj që në Serbi janë liberalizuar vizat edhe pse Serbia nuk është ithtarë e fqinjësisë së mirë. Prandaj, nuk e di pse ky standard duhet të përmbushet nga Kosova e cila në fakt është viktimë.

Po kthehem te dialogu, zakonisht një informatë shumë e thjeshtë e cila plasohet në opinion, qoftë edhe një lajm më i vogli i përgjigjet 5 pyetjeve bazike që janë: kur, ku, pse, si dhe çfarë? Informata që ne i kemi si Kuvend i përgjigjet vetëm dy pyetjeve.

E para është kur dhe përgjigja është nesër. Dhe, ju sot keni ardhur në Kuvend me këtë informatë. Dhe e dyta, ku? Në Bruksel.

Ndërkaq na mungojnë edhe tri përgjigje në pyetjet kryesore pse, si dhe çfarë? Pse të bisedohet me Serbinë në këtë fazë?

Kosova në agjendën e saj shtetëndërtuese ka një mori prioritetesh për trajtim, në mes të tjerave: rendin dhe ligjin, zhvillimin ekonomik, uljen e papunësisë, çmimet tepër të larta, inflacionin, pagat, energjinë, edukimin. Janë të gjitha këto premtime për të cilat ju kryeministër Thaçi jeni zotuar përmes memorandumeve të shumta që do t'i zgjidhni dhe do të filloni punën në zgjidhjen e tyre në ditët e para të Qeverisë, kështu edhe i keni marrë votat dhe keni ardhur në pushtet.

Ka edhe probleme të trashëguara nga lufta siç janë: të pagjeturit dhe vuajtjet që kanë familjet e tyre në mungesë të informatave për fatin e tyre. Po thuaj se 13 vjet pas lufte ata presin në ankth. Para Kuvendit, fotografitë e tyre po zbehen, po bashkë me to edhe informatat më të vogla se çfarë ka ndodhur me këta njerëz ku janë dhe a ka ndonjë informatë se mund të gjenden, të paktën trupat e tyre.

Dua të them që Kosova na agjendën e saj të brendshme ka shumë punë të cilat duhet të jenë prioritet i institucioneve të vendit, e Qeverisë, e Kuvendit dhe e gjitha institucioneve të tjera.

Gjithashtu ka edhe prioritete të tjera në raport me politikën e jashtme e të cilat lidhen me numrin e njohjeve të cilat duhet të rriten në Kosovë me një krijim të një mjedisi më të mirë për investime dhe investitorë, i cili në këtë fazë po duket të jetë e pamundur, sepse jemi goditur fortë nga raporte ndërkombëtare, të cilat imazhin e Kosovës e kanë sjellë në pikën zero.

Duke i pasur të gjitha këto probleme ne nuk e dimë se pse është me prioritet që në ditët e para të Qeverisë të filloni dialogun.

Të gjitha këto bashkë bëjnë që ne si vend duhet t'i venë prioritete të cilat janë në favor të zhvillimit të Kosovës, dhe përmbushjes së obligimeve që kemi ndaj qytetarëve tanë në rend të parë.

Ndërsa, çfarë bërë Qeveria? Nga gjithë këto prioritete i dha rëndësi një pike që nuk është e parëndësishme, por nuk është prioritet në Republikën e Kosovës e ajo është dialogu me Serbinë.

Në një fazë kur ende nuk ka filluar të punojë apo të trajtojë asnjërin nga prioritetet të cilat janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe ne si Kuvend i Kosovës shtrojmë një pyetje- pse, pse gjithë kjo energji e Qeverisë, e Kuvendit, e mediave dhe e gjithëve është orientuar nga dialogu me Serbinë në këtë fazë?

Cilat janë përfitimet që do të ketë Kosova nga ky dialog? Ajo çka dimë sot nga informatat që kemi marrë nga ju është se këto bisedime i duhen Serbisë për të fituar statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, mirëpo se çka fiton Kosova ne ende nuk e dimë.

Siç duket nuk e dini as ju as vetë zyrtarët e Qeverisë të cilët kanë marrë obligime që me çdo kusht dhe për çfarë do çmimi do të futen në këto bisedime, ose e dini po nuk keni guxim të thoni, sepse nuk është në të mirë të interesave të qytetarëve dhe në të mirë të interesave të Kosovës.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, konsideron se ne nuk kemi nevojë të bëhemi argatë i një shteti i cili ushtroi dhunë dhe represion, i cili asnjëherë nuk tregoi gatishmëri të kërkojë falje për krimet e bëra në Kosovës, ndaj civilëve, ndaj grave dhe fëmijëve të pafajshëm, i cili nuk njeh Kosovën shtet dhe vazhdon të punojë me të gjitha forcat kundërshtetësisë dhe qytetarëve të Kosovës, duke përfshirë edhe minoritetin serb të cilin e manipulon dhe nuk lejon të jetë i integruar në realitetin e ri të Republikës së Kosovës. Dhe, këtu po i referohem problemeve të shumta të cilat kemi në veriun e Kosovës.

Prandaj, ne propozojmë që këto bisedime me Serbinë dhe shtetet e tjera fqinje, sepse nëse flitet për fqinjësinë e mirë, ne i kemi edhe shtetet tjera fqinje me të cilat duhet të bisedojmë, por sa po shohim nuk ka diçka në agjendë, të ndodhin kur Kosova të jetë e gatshme për to dhe jo pse të tjerët kanë nevojë të ndodhin.

Kosova ka nevojë të bisedojë me Serbinë për fatin e të pagjeturve, Kosova ka nevojë të bisedojë me Serbinë për dëmet e luftës të cilat Serbia i shkaktoi Kosovës. Kosova ka nevojë të bisedojë me Serbinë për të drejtat e qytetarëve shqiptarë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc. Sigurisht edhe temat ekonomike, transporti, telekomunikacioni e plot pika të tjera do të vijnë në radhë. Mirëpo, paraprakisht Kosova ka nevojë për një dialog të brendshëm, i cili nuk ka ndodhur. Kosovës i duhet një dakordim i brendshëm para këtyre bisedimeve, na duhet dakordim i të gjitha palëve në shoqëri, i shoqërisë civile, i Kuvendit të Kosovës dhe më në fund të vijë një dokument i cili do të marrë një formë në Kuvendin e Kosovës.

Kosova duhet të niset me agjendë të detajizuar të procesit, të konfirmuar nga ky Kuvend. Dialogu duhet të mbështetet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian dhe rezultati i bisedimeve duhet të jetë në të mirë të gjithëve, mirëpo ne jemi të interesuar të jetë në të mirë të qytetarëve të Kosovës, të jetë për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Prandaj, ju ftojme Qeveri e Republikës së Kosovës, që të mos niseni me hapa të shpejtë e të papërgatitur, në një nivel disproporcional ndërmjet palëve biseduese, sepse Kosova nuk ka mundësi të lëshojë më shumë pe, sepse vija e kuqe është në fakt pakoja e Ahtisarit dhe ne nuk guxojmë të shkojmë përtej.

Edhe një gjë e fundit do të dua të them, sepse po shoh që do të kemi mimika, kemi edhe ikje nga Kuvendi ashtu siç ikë nga përgjegjësia çdo herë kryeministri Thaçi, nuk është mirë për t' u nisur në bisedime me Serbinë me inate personale ndaj Kuvendit dhe deputetëve, nuk është mirë. Duhet t'i merrni parasysh këto të dhëna që dalin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe duhet që patjetër dialogu të jetë në një formë më të përgatitur. Ju, deputetëve të Kuvendit të Kosovës nuk i servuat asgjë, nuk sollët një informacion të qartë se për çka do të bisedoni me kë dhe si do të shkojnë këto biseda dhe se çfarë do të përfitojë Kosova?

Prandaj, ne kërkojmë që të mos nguteni dhe të mos gaboni edhe një herë, sepse gabimet e juaja të vazhdueshme po na kushtojnë të gjithëve, po i kushtojnë Kosovës në rend të parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: I nderuar zoti kryesues,

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Mendoj që pas fjalës së kryeministrit herës së dytë, gjërat janë shumë më të qarta edhe do të na mundësoj neve si Parlament që ta orientojmë diskutimin tonë në një temë e cila besoj që do t'i shërbejë dhe do t'i ndihmojë para së gjithash Qeverisë, por në tërësi edhe vendit.

Kryeministri e paraqiti një pjesë të platformës dhe vijave të kuqe çka nuk duhet të bisedohet, dhe mendoj që tash nuk duhet shumë diskutim- temë rreth asaj se çka më nuk duhet të diskutohet, sepse e tha kryeministri dhe kjo është një pjesë e madhe e asaj që ka qenë shumë diskutabile çka duhet apo s' duhet të bisedohet me Serbinë. Dhe, unë kisha kërkuar që ne tash të orientohejmë në pjesën tjetër çka duhet të bisedohet, si do të bisedohet, cilat janë temat që mund të bisedojmë, çka mund të përfitojë Kosova sikur që u dëgjua nga diskutuesit?

Ajo unë çka dua të them, të nderuar kolegë, është se, duhet të nisem nga dialogu- kujt i konvenon dhe kujt i duhet dialogu? Këtu ishte gati thuaje që tha parafolësi im një disponim i të gjithëve, i deklaruar edhe shumë herë nga nivele të ndryshme të Kosovës, që Kosova është e gatshme për dialog, nuk i thotë jo dialogut me Serbinë. Tash i shtohet diskutimi ose çështja se sa, a jemi të përgatitur, kur mund të fillojmë, dhe çka përfitojmë nga ky dialog?

Unë dua të nisi nga një prespektivë tjetër diskutimin tim, askujt në këtë vend nuk i duhet dhe nuk ka interes më shumë të dialogojë se sa Kosovës. Në qoftë se ne bisedojmë dhe themi se është në interes të Serbisë, po futemi një grackë të vet Serbisë, Serbia absolutisht s'ka interes të dialogojë me Kosovën, pse? Është shtet, gjysmën e territorit e ka të, ka intervenuar ose ka cenuar integritetin, sovranitetin e këtij vendi, në pjesën veriore dhe jo vetëm pjesën veriore. Me të gjitha problemet që i shkakton këtij shteti të ri, Serbia përpiqet në çdo kusht që Kosovës, nëse nuk mund ta ndajë, ta shpallë një vend të dështuar dhe po e shohim që tentativat e tilla janë jashtëzakonisht të gjithanshme, jo vetëm brenda Kosovës, por edhe jashtë Kosovës. Prandaj, Kosova, ka nevojë të diskutojë, të bisedojë, t'i mbyllë problemet së pari brenda vetes, çështjen për shembull, pjesa veriore të Kosovës duhet sa më shpejtë të futët nën kontrollin e sistemit kushtetues juridik të këtij vendi. Po mirë atëherë a ka interes Serbia? Unë mendoj vetëm një interes e ka Serbia dhe ajo për atë po do sot ta kryejë interesin e saj. Serbisë i intereson ajo që e tha kryeministri, sepse jo vetëm Kosova, para së gjithash edhe Serbia edhe çdo vend fqinje ka kusht dialogun, fqinjësinë e mirë me vendet tjera që të mund të marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.

Unë jam i bindur që Serbia pasi ta marrë këtë kandidaturë, atëherë më asnjë interes nuk i mbetet Serbisë të vazhdojë dialogun me Kosovën, do ta zvarris, do ta qojë pa fund.

U tha këtu Kosova ka biseduar me Serbinë në të kaluarën, është e vërtetë edhe në Rambuje, edhe në Vjenë, po ne e kemi filluar me Serbinë, asnjëherë s'e kemi mbyllur me Serbinë, kurrë s'e kemi mbyllur. Kemi mbetur me bashkësinë ndërkombëtare edhe në Rambuje, po edhe në Vjenë dhe e dini që kemi mbetur qysh s'kemi mbetur. E dini kush i ka sponsorizuar bisedimet e Vjenës-Këshilli i Sigurimit, OKB-ja, përfaqësuesi zoti Ahtisari ka qenë përfaqësuesi special i Ban Ki Munit a kush ka qenë sekretari gjeneral në atë kohë. Dhe, në momentin kur Serbisë nuk i ka konvnuar, siç e dini paketa e Ahtisarit, është larguar dhe ne kemi pasur pastaj një marrëveshje me komunitetin ndërkombëtar dhe kemi vazhduar rrugën tonë që pastaj po i sjell problemet që janë.

Prandaj, unë do të kisha dashur që ne sot ta qartësojmë, po bisedime me Serbinë, po në drejtim të atyre që na ndërmjetësojë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës se, po mirë, në qoftë se Serbia largohet nga bisedimet çka pastaj si do të vijnë punët? Në qoftë se Serbia nuk pranon të ulët e të dialogojë për t'i zgjidhur problemet me të cilat, në një mënyrë apo tjetër ka dëmtuar edhe vazhdon të dëmtojë stabilitetin në këtë rajon dhe nuk është interesuar të ndërtojë fqinjësi të mirë me vendet fqinje, cilët do të jenë aktivitetet që bashkësia ndërkombëtare, në këtë rast do t'i marrë në raport me Serbinë?

Që të ketë një përfundim të suksesshëm, Kosova, Qeveria e Kosovës mendoj që institucionet e Kosovës duhet t'i drejtohen Bashkimit Evropian edhe përmes Bashkimit Evropian t'i bëhet presion Serbisë, të tregojë vullnetin e mirë që është e gatshme vërtet të bisedojë dhe ta ndërtojë një fqinjësi të mirë dhe përfundimisht të japim fund këtyre konflikteve dhe të fillojë një epokë e re e

bashkëpunimit reciprok. Cilat janë? Serbia pa kushte, të bëjë shuarjen zyrtarisht të të gjitha institucioneve ilegale paralele me të cilat ka cenuar dhe vazhdon të cenojë integritetin territorial të Kosovës jo vetëm në veri, po gjithandej Kosovës. Serbia të bëjë shuarjen dhe largimin e administratës, policisë, MUP-it, BIJ-as dhe gjithë atyre mekanizmave që një mënyrë apo tjetër po ndikojnë direkt në cenushmërinë e sigurisë në Kosovë.

Serbia do të duhej që problemet, të cilat janë të njëanshme, sepse Kosova nuk ka problem në raport me verin, Kosova ka problemet teknike për ne, po asnjëherë nuk janë teknike për Serbinë, sepse edhe çështja e kufirit edhe çështja e transportit, edhe çështja e telekomunikacionit, krejt janë çështje politike kah pjesa e Serbisë, mund të jenë për ne teknike, po për ta janë çështje politike.

Prandaj, Bashkimi Evropian si sponzorizues duhet të japë përgjigje çka nëse ajo largohet nga bisedimet pas fitimit të kandidatit të statusit?

Nuk mund të konsiderojmë raportet me vendet tjera fqinje si me Serbinë, ne duhet të jemi realist, ne kemi problem me shtetin serb edhe ata kanë problem me ne, kështu e shohin. Ne nuk mund të konsiderojmë Maqedoninë si Serbinë, as Shqipërinë, as Malin e Zi. Serbia ka problem për faktin se nuk e njeh shtetin e Kosovës, Serbia ka cenuar integritetin territorial të Kosovës dhe raportet ose marrëdhëniet dhe bisedimet me Serbinë, janë krejt një karakteri tjetër.

Gjithashtu, Kosova duhet të kërkojë nga Bashkimi Evropian që edhe Kosovën përfundimisht ta trajtojë si partner të barabartë sikur të gjitha vendet tjera në rajon. Kosova duhet të kërkojë nga Bashkimi Evropian t'i japë përgjigje çka pas bisedimeve, cili do të jetë statusi i 5 vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën? Ne duam nga Bashkimi Evropian, duhet të negociohet e bisedohet, të dialogohet me Bashkimin Evropian për këto pika të cilat ja kanë kushtuar në të kaluarën.

Kosova, së dyti duhet të kërkojë nga Brukseli, u tha këtu, u thanë kritere për liberalizimin e vizave, asnjë vend në rajon nuk i ka plotësuar ato kritere sikurse i ka Kosova. Kosova i plotëson kriteret për të marrë liberalizimin e vizave dhe Kosova duhet të kërkojë datën, jo hapjen e asaj agjende, perspektivën për viza, po datën e liberalizimit të vizave. Nuk mundet një vend me 2.5 milion në këtë pjesë të Ballkanit dhe të Evropës të mbetet pikë e zezë në pafundësi dhe duam trajtim të njëjtë sikur për vendet tjera.

Së treti, Kosova duhet të kërkojë nga Bashkimi Evropian nënshkrimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit, i njohur nën emrin "Mekanizmi përcjellës". Kosova ka tash e dhjetë vjet që përmbush standardet evropiane, madje nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e drejtpërdrejtë të politikës dhe të politikave të Bashkimit Evropian. Në asnjë vend në këtë pjesë nuk është më i involvuar Bashkimi Evropian se sa në Kosovë. Edhe në mekanizma ekzekutiv, në politikë, në ligje e në çdo gjë, prandaj duam që tani të fillojë një epokë e re dhe Kosova të fillojë të përfitojë

dhe jo të jetë vetëm ajo - Kosova duhej të dëshmoë.Nuk ka nevojë Kosova gjithë të dëshmojë, ka ardhur koha që edhe Kosova duhet të përfitojë sikur të tjerët.

Së katërti, anëtarësimi, siç e tha edhe kryeministri, anëtarësimi i menjëhershëm i Kosovës në Bankën Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim, i cili është shumë i domosdoshëm për perspektivën ekonomike të këtij vendi. Unë mendoj që diskutimi ynë duhet të orientohet në përfitimit, në një agjendë të qartë që vendi ynë sot kur futet në bisedime, të ketë pozita të tilla që nesër ose pasnesër të mos bëhet me gisht për problemet e mundshme, sepse unë dyshoj se ky dialog do të jetë i pafund, nuk do të ketë fund. Cili është fundi, edhe kjo duhet të kërkohet. Po fillohen bisedimet, qartë të dihet kur kanë përfundim ato bisedime, kur mund të përfundojnë? Me atë çka ne po shohim sot, dyshoj që këto bisedime kanë për të pasur fund. Serbia po shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme. Në momentin kur ta marrë statusin e kandidatit, ajo nuk ka për të pasur interes më për të biseduar, atëherë kush? Sot Bashkimi Evropian po vjen po ... Kosovën, sepse po i duhet Serbisë të bisedojë, por nesër Kosova, kah, si do të mund të gjejë Serbinë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

... edhe kjo mendoj që i shërben, do t'i shërbente shumë Qeverisë së Kosovës për të pasur një qartësi në krejt agjendën e bisedimeve dhe nën të gjitha këto, mendoj që Parlamenti i Kosovës, duke qartësuar mirë interesat dhe vizionin tonë, duhet ta mbështesim fuqishëm që vendi ynë t'i ketë pozicionet e duhura dhe të përfitojë shumë nga ajo që do të vjen pas, pas një përcaktimit të qartë të kësaj platforme, për të cilën, për mua ishte me rëndësi çka nuk duhet biseduar me Serbinë dhe kryeministri e tha qartë, shpresoj se kjo do të zë vend në dokumentin e Parlamentit të Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar deputet,

Kosova dhe Serbia, si dy vende fqinje, kanë interes jetik që t'i rregullojnë marrëdhëniet në mes tyre dhe të zgjidhin një varg çështjesh për të përmirësuar pozicionin e tyre ndërkombëtar. Pra, sipas meje, ekziston nevoja për bisedime lidhur me njohjen reciproke dhe vendosjen e marrëdhënieve ndërshtetërore, rregullimin e marrëdhënieve ekonomike dhe lehtësimin e këmbimit tregtar, rregullimin e transportit dhe të komunikimit, rregullimin e pozitës së pakicave, bashkëpunimin rajonal, fuqizimin e dyanshëm të procesit të integritetit në Bashkësinë Evropiane. Mirëpo, cila është gatishmëria për një dialog domethënës rreth këtyre çështjeve të pazgjidhura dhe cili është pozicioni nisës...?

Pozicioni i Kosovës nuk është shumë i qartë, nuk është i përgatitur dhe nuk është i kornizuar sa duhet formati dhe përmbajtja, por nga deklaratat e kryeministrit sot, del se synimi është që këto bisedime të përfundojnë me njohjen reciproke, gjë që është një parashikim optimist dhe i mirëseardhur. Ndërkaq, pozicioni i palës serbe dhe synimi i palës serbe është dhe kjo shihet nga deklaratat dhe bisedat që janë bërë, konsolidimi institucional shtetëror nëpërmjet strukturave të ashtuquajtura paralele në të gjitha komunat me shumicë serbe dhe sigurimi i një qasjeje asimetrike për veriun, që praktikisht do ta konservonte një status – quo... të Kosovës, e që do të përfundonte me ndarje ose të paktën me një status special, që vetëm formalisht do të ishte brenda kufijve administrativ të Kosovës, siç do t'i quanin ata dhe si shpërblim për këtë ata

presin një agjendë të përshpejtuar në integrimin evropian. Mbi këtë sfond pozicionesh, disa nga aktet e bisedimeve i kanë quajtur ato bisedime teknike për të zgjidhur disa çështje praktike. Mirëpo, ka pak ose hiq të ashtuquajtura probleme praktike apo teknike që mund të nxirren dhe ekstrahohen nga fondi që përshkrua më lartë. Në këtë situatë, është shumë vështirë këtu të gjenden zgjidhje kalimtare, pragmatike, për shembull, për dokumentacionin që sjell këmbimin tregtar, për dokumentacionin lidhur me dokumentet e udhëtimit, për targat e automjeteve, për mbajtjen gjallë të strukturave të ashtuquajtura të Serbisë.

Nga kjo perspektivë, bisedimet për çështje të ashtuquajtura “teknike”, nuk duken një qasje produktive. Janë joproduktive sepse bazohen në premisa të gabueshme. Në bisedimet e Vjenës, pala kosovare ka qenë konstruktive dhe bashkëpunuese në komunitetin ndërkombëtar, duke bërë lëshime dhe pranuar një koncept decentralizimi, i cili delegon në mënyrë asimetrike shumë funksione qendrore dhe të drejta të komunitetit me popullatë shumice serbe e duke krijuar dhe komuna të reja për të akomoduar pakicën serbe dhe duke siguruar instrumente të komunikimit dhe të bashkëpunimit me qeverinë serbe në të gjitha çështjet e identitetit kombëtar, kulturor, fetar, me standarde që paraqesin sui - generis përtej praktikave dhe standardeve më të avancuara të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të minoriteteve.

Këto zgjedhje janë në kufirin përtej të cilit rrezikohet tërësia e sistemit ekonomik dhe politik dhe efektiviteti i funksionimit të Kosovës si shtet. Kam frikë se e gjithë tendenca e palës serbe në këto bisedime është që mbi planin e Ahtisarit të insistojë për lëshime, kompromise të reja nëpërmes të cilave institucionet e Serbisë legalizohen në Kosovë. Kjo dukej si një vi përcaktuese, të cilën e prezantoi në një bisedë të organizuar nga Tanjugi, ditë më parë, udhëheqësi i ekipit serb për këto bisedime. Pra, është e qartë strategjia e Serbisë, por nuk jam i sigurt se e kemi të qartë se çfarë ne ofrojmë në këto bisedime, përpos kërkesës që Serbia duhet ta pranojë realitete të reja dhe shtetësinë e Kosovës. Gjithashtu, është shumë e qartë se pala kosovare nuk ka hapësirë që të shkojë përtej planit të Ahtisari. Një dialog shqiptaro-serb për të ndërtuar raportet e fqinjësisë së mirë pas një historie të vështirë, është i nevojshëm. Kosova duhet të jetë në favor të këtij dialogu dhe e gatshme për këtë dhe të përgatitet mirë për këtë. Kusht për kthesë pozitive ose historike, si quhet nganjëherë, është që të dy palët t’i përqafojnë standardet evropiane dhe civilizuese për t’i rregulluar marrëdhëniet reciproke.

Krijimi i standardeve dhe praktikave asimetrike që do të vlenin për pakicën serbe në Kosovë, e që nuk do të vlenin për pakicën shqiptare në Serbi, nuk besoj dot se do të jetë zgjidhje e mirë dhe e pranueshme. Pra, pala kosovare në këto bisedime, duhet ta paraqet këtë kërkesë pa hezitim, përndryshe çfarë shpjegimi ne mund t’u japim shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Pozita e minoriteteve shpeshherë paraqitet si një nga problemet për rregullimin e marrëdhënieve midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe integritet të tyre në Bashkësinë Evropiane. Për këtë duhet të nxirret një pako standardesh të obligueshme për të gjitha vendet, për t’i përmbushur secila prej tyre drejt integritet në Bashkësinë Evropiane në vend të zgjedhjeve ad-hoc dhe të zgjedhjeve asimetrike dhe selektive.

Rregullimi i marrëdhënieve ekonomike midis Serbisë dhe Kosovës ka mbetur një çështje pezull nga negociatat në vijim. Kërkesa e Kosovës për pagat e humbura për një dekadë të të përjashtuarve nga puna për motive politike, fondi i grabitur i pensioneve, kursimet devizore, dëmet në sistemin buxhetor, dëmet e luftës dhe në pasurinë publike dhe private dhe humbjet njerëzore, ndarja e pasurisë së ish-Federatës Jugosllave dhe borxhet e jashtme janë çështje që duhet të vihen në tryezën e bisedimeve. Ndërkaq, çështja e kthimit të kufomave të transportuara

gjatë luftës nga Kosova në varrezat masive në Serbi është një çështje që rëndon dhe dhemb shumë sa që nuk duhet të jetë objekt negocimi, është çështje, është thjeshtë një punë që duhet bërë menjëherë. Kthimi i librave të kadastrit, të eksponateve të artefakteve, të regjistrave civil, po ashtu nuk duhet të jetë objekt i negociatave. Ky është një ... i palës serbe, realizim i së cilës do të tregonte një qasje të re në rezonimin e tyre, një fillim i shkëputjes nga politikat e deritashme serbe ndaj Kosovës.

Fuqizimi i integritetit të Serbisë në Bashkësinë Evropiane është interes i padyshimtë për rajonin dhe Kosovën. Duket se fillimi i bisedimeve do të përcillet me favore nga Komisioni Evropian për palën serbe, e jo edhe për Kosovën. Mendoj se pala e Kosovës duhet të sqarojë këtë me Komisionin Evropian, sepse nuk besoj se kjo çështje është produktive dhe e drejtë. Zgjidhja duhet të jetë në një fuqizim të agjendës evropiane për të dyja palët dhe gjithë Ballkanin Perëndimor dhe jo qasje selektive dhe asimetrike këtu. Pala kosovare po hyn në proces bisedimesh me Serbinë në kohën kur para institucioneve të saj ka shumë detyra të tjera të mëdha dhe me prioritet edhe më të madh.

Kuvendi i Kosovës, presidenti dhe qeveria duhet fuqishëm të marrin kursin e funksionalizmit të shtetit, zbatimin e ligjit, krijimin e mjedisit të favorshëm për investime, luftimin e korrupsionit dhe përmirësimin e imazhit të vendit. Në këtë mënyrë, Kosova gjeneron iniciativa pozitive edhe për rajonin dhe më lehtë forcon pozitën e saj ndërkombëtare dhe në perspektivë rregullon më lehtë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin edhe me Serbinë. Ajo që është më me rëndësi, një kurs i tillë i përmirësimit të qeverisë dhe të gjendjes vend ofron perspektiva dhe shanse për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e saj, për shqiptarët dhe komunitetet pakice: serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe malazeztë.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është afatizimi i bisedimeve. Pala kosovare nuk duhet të pranojë bisedime pa fund, e që pritet të jenë një nga opsionet në të cilat do të shkojë pala tjetër. Nëse hy në bisedime, pala kosovare duhet të përcaktojë një afat jo më të gjatë se 6 muaj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Duda Bale.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani predsedavajući,

Poštovani premijeru sa čitavom vladinim strukturom,

Poštovani poslanici,

Parlamentarna grupa „6+“, kao što je poznato, sastavljena je od triju zajednica. Ja ću ovom prilikom izneti stav Bošnjačke zajednice i stavove koalicije „Vakat“ koja ne predstavlja većinu upravo tog naroda.

Kao zajednica podržavamo prijedlog vlade i konciznu takstativno predstavljenu Rezoluciju od strane premijera. Verujemo da postoji kvalitetna razređena strategija o onome o čemu će se pričati i onome o čemu će se neće pričati na predstojećem dijalogu i kao zajednica smo vrlo zainteresovani da u timu koji će predvoditi našu državu, budu uključeni i naši predstavnici.

Teme koje će biti razmotrene u dijalogu se tiču uglavnom većine naroda Kosova, a i nas kao takvih, ali je evidentno da postoji neki specifični problemi koji su vezani isključivo za našu zajednicu. U većini njih napomenuću jedan, znači to je činjenica da veoma veliki broj naših

mladih odlazi na doškolovanje u Srbiji i nepriznavanje diploma Republike Kosova tamo. Znači, to je samo jedan od problema. Postoji veoma veliki broj drugih problema. Zahtevi Bošnjačkih predstavnika postavljeni u timu za pregovore, baziraju se na tome da oni budu aktivirani samo onda kada se budu analizirala pitanja koja se direktno tiču naše zajednice. Ukoliko je vama ovaj prijedlog dovoljno interesantan kao i nama, na nama će biti da izaberemo one koje će nas najbolje predstavljati. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Rada Trajković e ka fjalën.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani predsedavajući,

Poštovane kolege poslanici,

Iskreno da vam kažem, slušam ovu diskusiju od početka i moram da vam kažem da oni koji su najviše zainteresovani za nešto što jesu pregovori i razgovori, to je stanovništvo srpsko i albansko. Ako slušate Skupštinu današnju, najveći deo se odnosi ustvari na statusno pitanje, da se ne povredi i da se ne ugrozi nezavisnost Kosova i Metohije, a svi su donekle uplašeni jer očigledno ne veruju da je ona prava. Ovde smo čuli i projekte koje podrazumevaju stvaranje paralele između juga centralne Srbije, mislim na Preševo, Bujanovac, i sa druge strane za sever Kosova, što definitivno govori da je prekrajanje granica jeste ideja kod nekih ljudi koji se nalaze u ovom parlamentu.

Projekt konsolidacije zakona sa Albanijom, kao projekt panalbanski, isto tako je jedna od ideja. Dakle, vidi se da unutar albanskog naroda na Kosovu i Metohiji još uvek ne postoji jasno opredeljenje, ustvari za koji projekat svog bitisanja su se definitivno opredelili. Ono što ovde čujem, a što čujem i u Beogradu, mnogi predstavnici politike u Beogradu kažu: „moramo poštovati Ustav, moramo poštovati teritorijalni integritet“, ali ono što je realnost i za lidere institucionalne albanske u Prištini i u Beogradu, to je da narod ima mnogo problema.

Vi ćete danas videti mnogo Albanaca, kojima je na ceni srpski pasoš i prihvatanje srpskog državljanstva, jer žele da olakšaju sebi život, da se slobodnije kreću, da mogu da putuju u sve one države koje su priznale i nisu priznale nezavisnost Kosova i Metohije, a znamo da najveći broj nije ih priznao. Oni žele i rade to netransparentno krijući, možda i ovde u ovom parlamentu mnogi od njih imaju pasoše srpske države da bi lakše funkcionisali. Oni odlaze da se leče u Beograd, oni odlaze po biznis u Beograd. Dakle, razgovori nisu za pozicioniranje političkog liderstva, za poene politički ... da ima. Razgovori jesu za boljitak života običnog čoveka koji živi na ovom prostoru i koji želi na jedan način da vreme rata, netrpeljivosti ostavi iza sebe. Ja kao Srbin, moram da vam kažem, ne pripadam onoj političkoj srpskoj opciji koja misli da Srbi treba da se nalaze u pregovaračkom timu Prištine, prosto za to jer u ovom trenutku najveći poslodavac Srbima na Kosovu i Metohiji jeste Beograd. 20 hiljada Srba prima platu od Beograda...

KRYESUESI: E nderuara deputete, me falni, po ua tërheq vërejtjen! Po trajtoni çështje antikushtetuese. Ju nuk keni të drejtë në Kuvendin e Kosovës të thoni “Kosovë e Metohi”. Ju jeni të obliguar ta zbatoni Kushtetutën e Kosovës, përndryshe ne jemi të obliguar që konform Rregullores të marrim masa për secilin këtu.

RADA TRAJKOVIĆ: Ja znam da mnogi u ovom Parlamentu govore „Kosova“ i da sve nikada nisu opominjani.

KRYESUESI: Nauçi se i ti!

RADA TRAJKOKVIĆ: Hvala!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Skender Hyseni.

SKENDER HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po debatojmë për një temë e cila ka peshë të veçantë në kontekstualitetin e përgjithshëm politik të vendit.

Pyetja thelbësore e cila shtrohet sot para nesh është nëse kjo është koha më e përshtatshme për të bërë dialog me Beogradin, e madje nëse ky dialog edhe duhet të ndodhë fare. Lidhja Demokratike e Kosovës, siç u dëgjua edhe nga ekspozetja e kryetarit të grupit parlamentar, është e mendimit se me Serbinë duhet të bisedohet për çështje praktike të interesit të ndërsjellë. Ky është qëndrim parimor i cili konsiston në atë se dialogu është mekanizmi më i mirë dhe më efikas për të zbutur dallimet dhe për të krijuar ato parakushte thelbësore për stabilitet dhe njohje reciproke një ditë. Dialog po, po pyetje tash thelbësore është nëse është koha më e përshtatshme për Kosovën dhe nëse janë bërë përgatitjet e duhura, në mënyrë që Kosova të dalë me benificionet më të mëdha të mundshme nga një proces bisedimi.

Dialogu është i nevojshëm, por ai duhet të ndodhë vetëm atëherë kur Kosova të ketë identifikuar qartë rezultatet përfundimtare të cilat i synon dhe kur të ketë bërë përgatitjet e duhura, në mënyrë që këto interesa të cilat i ka identifikuar apriori, i bën të realizueshme.

Zoti kryeministër iu referuar në dy raste emrit tim, në kuadër të asaj që u tha që dialogu vazhdon, ka filluar kaherë dhe vazhdon. Më duhet ta korrigjoj kryeministrin. Dialogu nuk ka filluar asnjëherë, mirëpo Kosova ka kohë që zhvillon dialog me Brukselin dhe Uashingtonin për fillimin e një dialogu me Serbinë një ditë dhe këto janë dallime thelbësore. Për më tepër, në takimet e shumta që përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës kanë pasur me eksponentët kyç të bashkësisë ndërkombëtare, qoftë në Prishtinë, qoftë gjetiu, kërkesë kyçe e Republikës së Kosovës ka qenë nevoja e strukturimit, e formatizimit të qartë dhe e krijimit të një agjende po ashtu të qartë, e cila në fund do të rezultojë me një sukses për Kosovën, natyrisht edhe për rajonin. Është e saktë dhe shumë e vërtetë që Kosova ka insistuar dhe unë e inkurajoj Qeverinë që të insistojë në vazhdimin e dialogut edhe me Brukselin, edhe me Uashingtonin për të siguruar suksesin për Kosovën të këtij procesi dhe unë inkurajoj po ashtu Qeverinë që të insistojë në atë që kemi insistuar edhe në Nju Jork që ky dialog, bisedimet me Serbinë të lehtësohen jo vetëm nga Brukseli, nga Bashkimi Evropian, por edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kosova ka nevojë të dëgjojë qartë një sfond parimesh prijëse, të cilat e kornizojnë edhe si tema për bisedime, por edhe si afat këtë proces dialogu.

Shumë parafolës, kolegë të mi, me të drejtë e theksuan fuqishëm nevojën që dialogu me Serbinë të mos mbetet i pa afatizuar, sepse ky është synim i Serbisë. Në Nju Jork, në Prishtinë e gjetiu e kemi demonstruar me insistimin dhe këmbënguljen më të fortë dhe të gjithë ata që kanë qenë të

pranishëm, janë dëshmitarë të kësaj. Frikën tonë se klauzola për dialogun në Rezolutën e OKB-së do të ndërpresë procesin e njohjeve të Republikës së Kosovës, sepse dhjetëra shtete të cikat gjatë procesit në GJND ishin zotuar se do ta trajtonin njohjen e Kosovës pas GJND-së, me këtë klauzolë në rezolutën, për të cilën ne kemi pasur vërejtje serioze, kjo klauzolë në këtë rezolutë nga shumë vende do të interpretohej, do të merrej si alibi për ta zvarritur njohjet dhe këtu unë kam qenë kritik publikisht, do të jem kritik edhe këtu ndaj të gjithë partnerëve të Republikës së Kosovës, të cilat janë zotuar se kjo klauzolë nuk do ta ndërpres, nuk do ta zvarris, nuk do të pengojë njohjet e mëtejme të Kosovës. Mirëpo, kjo ka ndodhur, unë e kam thënë atëherë, e them edhe sot dhe ka plotë vende partnere të Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare, të cilat do të mund të bënin më shumë për të përçarur mesazhin të cilin ne e kemi përçarur, që klauzola për dialogun në Rezolutën e shtatorit nuk është klauzolë për dialog për statusin e Kosovës, është klauzolë për një dialog i cili synon normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve sovrane.

Kosova nuk mund dhe nuk guxon të harrojë të kaluarën, të nderuar kolegë deputetë. Këto na është sugjeruar nga instanca tepër të larta të shtetit që shqiptarët duhet të harrojnë çka ka ndodhur dhe duhet ta harrojnë urrejtjen ndaj serbëve, thua se janë vetëm shqiptarët ata që kanë urrejtje ndaj serbëve dhe të tjerët janë engjëj. Shqiptarët nuk guxojnë të harrojnë asnjëherë, shqiptarët mund të falin, nëse kërkohet falje nga ata dhe kjo kërkim falje nuk ka ndodhur asnjëherë deri më sot.

Krejt në fund, edhe një herë po e theksoj, e që është më e rëndësishmja, këto biseda duhet të afatizohen në kohë. Nuk guxon, nuk guxojmë t'i lëmë të jenë ajo që në anglisht quhet: "open ended", pa fund, sepse kjo mund ta libanizojë Kosovën, mund ta qiprizojë këtë çështje. Përpos vijave të kuqe të cilat këtu u përmendën dhe me të cilat absolutisht pajtohem, sepse edhe në dokumentin për qëndrimin e Republikës së Kosovës pas GJND-së, që është shpërndarë zyrtarisht dhe është deponuar zyrtarisht në të gjitha instancat ndërkombëtare dhe të gjitha vendet e botës, janë tërhequr qartë këto vija të kuqe. Kosova nuk guxon të riciklojë proces negociationi. Pakoja e Ahtisarit e vë në buzë të funksionalitetit shtetin e Kosovës. Nëse kjo rastësisht rihapet për rinegociata, unë ju siguroj që karakteri unitar i Republikës së Kosovës do të lëndohet pariparueshëm dhe funksionaliteti i Kosovës do të jetë i pamundshëm. Ne nuk guxojmë të lejojmë nivele të treta të qeverisjes në Kosovë, që janë midis nivelit qendror dhe lokal, nuk guxojmë të lejojmë bomba të tempuara brenda territorit të Kosovës, të tipit të a Alsterit të Irlandës, siç mund të synojë dikush në Mitrovicën e veriut. Janë të gjitha këto shqetësime reale të cilat, jam i sigurt, i ka secili nga ne, mirëpo si qëndrim parimor, Kosova synon marrëdhënie fqinjësore absolutisht të qëndrueshme me secilin vend.

Dhe, krejt në fund të performatit, mua më ka befasuar shumë nxitimi totalisht i paarsyeshëm i Qeverisë që të emërojë një eksponent aq të lartë qeveritar ...

(ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit! Edhe një minutë, regjia!

SKENDER HYSENI... I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputetë, në emër të Kosovës duhet të bisedojnë vetëm institucionet e Kosovës, mirëpo Kosova në këto biseda duhet ta aplikojë në mënyrë rigoroze parimin e reciprocitetit. Flasim për biseda për çështje praktike, këto biseda për

çështje praktike duhet të udhëhiqen nga dikasteret përkatëse, përkatësisht nga drejtoritë përkatëse në ministrinë përkatëse. Ndërkaq krejt në fund, çdo marrëveshje eventuale e arritur, patjetër duhet të vij në Parlamentin e Republikës së Kosovës, për ratifikim. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Blerim Shala e ka fjalën.

BLERIM SHALA: I nderuar kryetar!

Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Nuk është pyetja a do të ketë bisedime midis Kosovës dhe Serbisë. Bisedime do të ketë për arsye të shumta, sepse është detyrim ndërkombëtar i Kosovës, sepse dialogu për fqinjësinë e mirë është pjesë e agjendës euro-atlantike të Kosovës, sepse akoma kemi hesape të pasqaruara me Serbinë, sepse për Uashingtonin dhe Brukselin njohja e Kosovës nga Serbia është agjendë rajonale dhe ndërkombëtare për stabilizimin e kësaj pjese të Evropës.

Pyetja e mirëfilltë është: - cila do të jetë përmbajtja e këtyre bisedimeve dhe çfarë do të përfitojë Kosova me to: Përgjigja në këto pyetje kyçe nuk mund të artikulohet pa ison dhe pa autorësinë tonë, e këtu flasim para së gjithash për Kuvendin e Kosovës. Dialogu i Kosovës dhe i Serbisë është temë me interes shtetëror, e interesat shtetëror duhet të tejkalojnë hendekun politik që ndan Qeverinë me opozitën. Tek e fundit, edhe përvoja e kaluar flet për një gjë të tillë. Dihet se si u përgatit Kosova në aspektin politik dhe organizativ për bisedime për statusin e Kosovës dhe çfarë roli pati Kuvendi i Kosovës. Po, atëherë si është dashur të përgatitet Prishtina për bisedimet ardhshme?

Së pari, duke instaluar dialogun gjithëpërfshirës politik në mes nesh,

Së dyti, duke krijuar një trup të përbashkët politik, i cili do të përzgjidhte kryesuesin kosovar të këtij dialogu,

Së treti, duke përgatitur strategjinë politike dhe platformën e bisedimeve.

Gjatë hartimit të tyre, do të shihnim së bashku që:

1) Kosova është në pozicion më të keq se Serbia në fillim të bisedimeve, që pozicioni ynë ndërkombëtar nuk është çfarë ka qenë në vitet 1999, Konferenca e Rambujesë, apo në vitet 2005-2007, statusi i Kosovës, që karshi Brukselit Beogradi ka përparësitë që nuk i kemi, që derisa Serbia mban efektivisht nën kontroll veriun e Kosovës, ne nuk mund të jemi palë e barabartë në këtë dialog, që për këtë shkak duhet të insistojmë në avancimin e rendit dhe të ligjit në veri të Kosovës në përputhje të plotë me strategjinë për veriun e Kosovës dhe në qëndrimin politik që largimi i Serbisë nga veriu i Kosovës është kusht për afrimin e Serbisë kah BE-ja dhe që njohja e shtetit të Kosovës nga Serbia është kusht për hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian.

2) Kosova ka aktualisht disavantazhe të mëdha politike sepse nuk është ndërtuar konsensusi politik midis nesh, kryekëput me fajin e autoriteteve institucionale të vendit.

3) Kosova duhet të definojë vetë territorin e bisedimeve me Serbinë. Kosova nuk do të flet për statusin, për identitetin territorial, për rendin kushtetues, për ndryshimin e pakos së presidentit Ahtisari.

4) Duke miratuar në Kuvendin e Kosovës një rezolutë të qartë për këto bisedime në përputhje të plotë me strategjinë dhe platformën e bisedimeve.

5) Duke konfirmuar që Kuvendi i Kosovës është autoriteti suprem në trajtimin e kësaj çështjeje.

6) Duke krijuar grupet punuese për këtë dialog, në të cilat do të merrnin pjesë politikanë dhe ekspertë të të gjitha partive dhe të shoqërisë civile.

7) Duke definuar qartë afatin kohor për përfundimin këtyre bisedimeve dhe duke krijuar raporte të reja midis Prishtinës dhe Brukselit në kuadër të synimit strategjik të Kosovës për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Albana Fetoshi. e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë.

Nëse kthehemi disa vite prapa dhe i hedhim një vështrim të kaluarës politike të Serbisë ndaj Kosovës, na del se ajo ishte një politikë shoviniste që e mbante të okupuar Kosovën dhe të shtypur popullin shqiptar, duke ia mohuar të drejtën për vetëvendosje.

Vetëm gjatë luftës së fundit në Kosovë, shteti i Serbisë vrau mbi 12.000 njerëz, më shumë se 1800 persona janë ende të pagjetur, afër 20.000 femra të dhunuara, 7400 persona u larguan dhunshëm nga shtëpitë e tyre, 120.000 shtëpi u shkatërruan gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Institucionet e Kosovës nuk bënë asgjë për fatin e të pagjeturve. Në mesin e tyre është edhe Ukshin Hoti e për këtë nuk duhet të negociohet, por ky është një kusht i pa kompromis që duhet ta plotësojë shteti i Serbisë. Kjo dëshmon se politika e Serbisë edhe sot nuk ka ndryshuar aspak, ajo është e njëjtë. Serbia nuk kërkoi falje për krimet kryera këtu, e ky kërkim falje duhet të rezultonte me veprime konkrete për të na dëshmuar se ajo është penduar për krimet e kryera këtu. Ky është minimumi që mund të bënte. Kjo dëshmon se edhe e tashmja e Serbisë vazhdon të mbetet e njëjtë në raport me Kosovën. Pas gjithë këtyre, është e turpshme që të kërkohet të shkohet në negociata me Serbinë për Kosovën.

Pra, Kosova nuk duhet të shkojë në negociata, sepse në rastin më të mirë mund të mos fitojë asgjë, kurse në rastin e keq, mund të humbas shumë, e të negociosh me një shtet të tillë si Serbia, do të humbasësh sigurisht, sepse po shkohet të bisedohet për Kosovën, me vetë armikun e Kosovës. Kjo është arsyeja pse Serbia po i kërkon këto negociata, duke llogaritur gjithmonë në gatishmërinë e Hashim Thaçit dhe të shokëve të tij sa herë që ajo i kërkonte këto negociata.

Hashim Thaçi nuk e mori asnjëherë seriozisht shtetin e Kosovës, nuk i përdori asnjëherë mekanizmat shtetëror për ta vendosur kontrollin në territorin e Kosovës. Gjithmonë e kërkonte shpëtimin tek të tjerët, duke shkuar në negociata me Serbinë edhe pse e kishte të qartë se në këtë mënyrë nuk mund të shpëtohet Kosova, por ndoshta në këtë mënyrë dëshiron që ta shpëtonte veten e tij. Në këtë mënyrë Hashim Thaçi po na e bën të qartë se politika e tij nuk është vazhdimësi e një politike të pastër kombëtare që do të na ofronte me Shqipërinë, por është një angazhim politik që po na çon drejt Serbisë.

Qeveria është ajo që po i toleron strukturat paralele të Serbisë të veprojnë lirisht në territorin e Kosovës dhe pastaj del me deklarata boshe se për t'i zgjidhur problemet e brendshme të Kosovës, duhet të bisedohet me Serbinë. Sovraniteti dhe integriteti territorial nuk maten me deklarime boshe, por me veprime konkrete. Janë pikërisht këta njerëz që e hoqën himnin dhe flamurin kombëtar nga institucionet dhe tani po shkojnë në negociata me Serbinë për ta vulosur ndarjen e brendshme të saj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,

Ashtu si edhe unë, grupi im parlamentar mbështet që vendi ynë ka nevojë të bisedojë me këdo që kërkohet nga shtetet e rajonit, në këtë rast edhe me Serbinë, por jemi të interesuar që këto bisedime të zhvillohen në suaza ndërshtetërore dhe me interes për vendin, në mbështetje të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shteteve të BE-së. Miratimi i një rezolute jo të dy palëve të cilët i prezantuan sot këtu, njëra në fillim dhe tjetra pas diskutimit tjetër, por i një rezolute me kornizë të qartë në fund të debatit të sotëm, në të cilin do të theksoheshin rrugët në të cilat duhet të shkonte delegacioni ynë, është shumë i nevojshëm. Kosova ka nevojë të jetë serioze me bashkësinë ndërkombëtare dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe Kosova duhet të ketë kërkesa konkrete ndaj bashkësisë ndërkombëtare për arsye se pikë së pari Kosova duhet të jetë e përgatitur së bashku me Qeverinë dhe me të gjitha partitë politike të cilat janë në Kuvend dhe ato jashtë Kuvendit dhe njëkohësisht me të gjitha organizatat joqeveritare, me grupin e ekspertëve dhe me Akademinë e Shkencave që të jetë një platformë apo një kornizë e detajuar mirë për çështjen e këtyre bisedimeve.

Kosova duhet të japë një ofertë serioze dhe konkrete lidhur me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Ashtu sikur edhe shumë të tjerë që diskutuan, edhe unë kam frikë se mos ky dialog nuk duhet të bëhet vetëm për interesa të një pale. Prandaj, i bëj thirrje Qeverisë dhe delegacionit, i cili duhet të jetë i përgatitur dhe të informojë në vazhdimësi Kuvendin e Kosovës dhe gjithë legjislativin për çdo hap të mëtutjeshëm të këtyre bisedimeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Zoti kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë të zgjedhur,

Sot është 7 marsi, ditë e përkujtimit të lavdisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sot është 7 mars, dita e lavdisë së Jasharajve dhe e komandantit legjendar, Adem Jashari.

E rastësishme apo jo, sot pikërisht në 13 vjetorin e epopesë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të Jasharajve, në Kuvendin e asaj Kosove për të cilën ata luftuan dhe ranë, po kërkohet të negociohet ideali madhor i tyre, po kërkohet të negociohet me një shtet që i vrau ata. Si deputetë të Kuvendit të Kosovës, ne sot marrim pjesë në këtë debat për t'i kundërshtuar fuqishëm këto negociata si të dëmshme, për t'i demaskuar këto negociata si të fshehta dhe për t'i denoncuar hartuesit e këtyre prapaskenave në dëm të Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Po i parafrazoj vetëm dy deklarime të kreut të Qeverisë së Kosovës ditëve të fundit. Parafrazoj: këto bisedime i hapin rrugë integritetit euro-atlantik të të dyja vendeve dhe, parafrazoj sërish: me këto bisedime po përfundon një armiqësi e vjetër shqiptaro-serbe dhe po fillon një miqësi e re në mes dy shteteve.

Zotërinj deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Kosovës, Kosova do të integrohet edhe në Bashkimin Evropian, edhe në NATO, edhe në të gjitha mekanizmat tjera ndërkombëtarë, por jo me negociata me Serbinë. Rruga e integritit të Kosovës dhe e shqiptarëve kalon përmes integritit kombëtar kah Tirana drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s, e jo përmes bisedimeve me Serbinë, andej kah është nisur kryeministri kosovar.

Raporti i Kosovës me Serbinë nuk është jetik, madje as i nevojshëm e as i domosdoshëm, siç u tha këtu.

Zoti kryeministër, ju përmendni edhe miqësinë me Serbinë. Ju lumtë! Dhe jam shumë kurioz ta dijtë se ku e gjeni këtë miqësi me atë shtet që vrau, masakroi, dëboi qindra mijëra shqiptarë për një shekull të tërë? Ku e gjeni atë miqësi me atë shtet që vrau 12.000 shqiptarë brenda një viti të vetëm gjatë luftë së fundit në Kosovë, që dogji 120.000 shtëpi shqiptare, dhunoi motra dhe nëna shqiptare, që mbanë akoma 2000 trupa të vrarë shqiptarë. Zoti kryeministër, ku e gjeni atë miqësi me atë shtet që vrau Adem Jasharin dhe familjen e tij, për atë shtet që vrau Fehmiun, Mujën, Luanin, Agimin dhe 200 dëshmorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dikur bashkëlufëtar tanë. Ju zotërinj qeveritar, kur i kujtoni gjithë ato që bëri Serbia me shqiptarët, do të duhej që së paku ta kishit para veti një prag moral të pakapërcyeshëm edhe për ju. Mos e kapërceni këtë prag i cili është prag i pa kthim. Kthehuni në anën e bashkëkombësve tuaj nëse ju ka mbetur ende kohë. U thoni jo negociatave me Serbinë, të cilat janë në dëm të Kosovës dhe në dëm të shqiptarëve.

Asnjëherë, në asnjë periudhë të historisë dhe në asnjë rrethanë nuk iu ka ardhur shqiptarëve ndonjë e mirë nga Serbia dhe nuk do t'i vijë as tash e as më tutje. Përkundrazi, ne kemi fatin e keq ta kemi shtet fqinj Serbinë. Tek e fundit, ne s'kemi nevojë fare për Serbinë as të bisedojmë, as të negociojmë, as të ecim me Serbinë drejt integritimeve. Kjo pra është ideja jonë, kur u tha më herët që kemi mungesë idesh. Fatin jo të përbashkët në mes të Kosovës dhe të Serbisë e ka përcaktuar një lum gjaku i derdhur nga barbaria njëshekullore serbe nga krimet e tyre mbi shqiptarët. Qeveritarët e Kosovës po i japin vetes një të drejtë që nuk i takon, që nuk ia kanë dhënë qytetarët e Kosovës, madje as votuesit e tyre. Një grupacion politik po i jep vetes të drejtë të vendosë keq për të ardhmen e vendit tonë, duke shkelur vetëdijshëm mbi të kaluarën e lavdishme dhe mbi sakrificën e popullit shqiptarë për liri dhe demokraci. Le të demokratizohet dhe të integrohet populli i Serbisë kur dhe ku të dojë, kjo s'është punë e jona, madje kjo nuk është as detyrë e jona që ta paguajmë integritimin e Serbisë në dëm të qytetarëve të vendit tonë.

Të nderuar deputetë,

U tha këtu që negociatat janë të domosdoshme. Ne themi që negociatat janë të shmangshme dhe jo të shëndetshme ashtu siç thuhet. U tha këtu që nuk jemi vendi i parë që bisedojmë pas konfliktit, theksoj - pas konfliktit, por ua rikujtoj, këtu nuk ishte thjeshtë një konflikt, por këtu ka pasur një luftë çlirimtare, që ju zotëri ndoshta e paskësh harruar. U përmend këtu edhe mentaliteti i së kaluarës. Po, kemi mentalitet edhe në të kaluarën, edhe në tashmen, edhe në të ardhmen. Ky është mentaliteti shqiptarë i ruajtjes së atdheut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRAJ: Ju faleminderit, shumë!

Zoti kryetar i Kuvendit,
Kryeministër,

Anëtarë të kabinetit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duhet ta konstatojmë gjendjen në të cilën Kosova po hyn në një proces bisedimesh me Serbinë në periudhën post pavarësisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ketë kontinuitet të asaj çfarë Kosova ka arritur deri më 17 shkurt, ditën kur është shpallur Deklarata e koordinuar për Pavarësinë e Kosovës.

Dialogimi, bisedat dhe rregullimi i marrëdhënieve ndërfqinjësore është dhe mbetet prioritet i çdo qeverie dhe në këtë rast nuk mund të sillemi sikur që kjo nuk duhet të ekzistojë, por le të konstatojmë që Serbia ka kohë, apo themi koha është që pas shtatorit të vitit të kaluar, që e ka platformën e saj, që ka agjendën e qartë për bisedime, që e ka periudhën kohore të bisedimeve dhe që e ka emëruar një shërbyes civil i cili e mbulon agjendën politike të bisedimeve të Serbisë me një kamuflazhë tashmë të njohur për bisedime teknike, ndërsa Kosova, sot për herë të parë publikisht u pa që ka një kornizë për bisedime, se i ka vijat e kuqe të tërhequra në këto bisedime dhe ka emëruar një përfaqësues politik për ta kamufluar një agjendë teknike.

Dallimet nuk janë të vogla në esencë, dallimet janë shumë të mëdha, përveç asaj që Serbia fiton hapin e fundit të procesit të integrimi evropian dhe Bashkësia Evropiane apo BE-ja, në këtë rast Komisioni Evropian ia bën favorin e dytë brenda dy vitesh Serbisë në këtë proces. Duhet të mos harrojmë, ajo që e thotë nënkryetari i LDK-së dhe i Parlamentit, zoti Hamiti, memoria e kombit tonë duhet të jetë e qartë, sepse favor i parë Serbisë i është bërë me liberalizimin e vizave, duke e larguar kushtin e Holandës në raport me bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës, që Serbia e ka pasur kërkesë eksplicite të një anëtar. Eliminimi i kësaj kërkesë dhe të vetos të Holandës në procesin e liberalizimit të vizave, pas dy vitesh Serbisë ia jap edhe një favor që përmes bisedimeve me Kosovën ta fitojë të drejtën e statusit të kandidatit dhe datën për anëtarësim, ndërsa Kosova hyn e hendikepuar sepse pesë shtete të BE-së, të boshtit ortodoks që nuk e kanë pranuar Kosovën, do ta kenë edhe një anëtarë të gjashtë të boshtit të vet që do ta pengojnë Kosovën në proces dhe duhet ta bëjmë të qartë që edhe 5 shtete mike të Kosovës të boshtit perëndimor janë kundër procesit të liberalizimit të vizave dhe fatkeqësia e madhe që këtyre shteteve mike është apo udhëhiqet nga Gjermania, e cila është e para e cila e ka bllokuar procesin dhe Kosova sot nuk ka udhërrëfyes teknik të këtij procesi. Për ta deblokuar këtë proces, nuk jam ithtarë të përmend shifra të mëdha, por duhet ta themi se 92% të rinisë së Kosovës nuk ka udhëtuar me larg se në Shkup ose Tiranë. Kosova jeton në një geto, në një izolim dhe hyn në këto bisedime pa i kërkuar këto kushte apo pa i bërë të qarta këto kërkesa për të cilat edhe me të cilat dhe pa të cilat Kosova nuk mund të jetojë. Nuk mund të jetojë sepse vetëm premtimi se Kosova në këtë agjendë do ta përballon çdo sfidë që është e kushtëzuar nga Serbia, mendoj se është e paqëndrueshme sepse qartë është, do të krijon bllokime të mëtutjeshme të procesit të saj të integrimi dhe, natyrisht, përveç nesh, në Ballkanin Perëndimor mbetet edhe më tutje me probleme të tilla shteti ynë shqiptar, Shqipëria, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina, por i vetmi shtet në Ballkanin Perëndimor i cili tashmë përfundimisht e ka këtë agjendë të qartë dhe këtë hap për të arritur këtë proces, natyrisht është Serbia.

Për herë të parë Kosova po hyn në bisedime me lehtësues e jo me ndërmjetësues. Edhe kjo është gjendja në të cilën duhet ta pranojmë se po hyjmë. Lehtësuesi ndërkombëtar është i zgjedhur, ai ka filluar shuttle diplomacinë, ai ka vendosur formulën e bisedimeve, ai ka kontaktuar autoritet tona dhe, natyrisht, zëvendëskryeministren e emëruar vetëm për këtë problem, për këtë çështje në Qeverinë e Kosovës tashmë e pret në shtrëngim duarsh për të filluar procesin e bisedimeve. Ajo që ne duhet ta kemi të qartë dhe duhet ta themi hapur është: Serbia deri

më 17 shkurt të vitit 2008, ka punuar për ta preventuar Republikën e Kosovës, si shtetin e dytë të shumicës shqiptare në Ballkan, ka punuar shumë për ta preventuar Republikën e Kosovës si shtet funksional. Ajo që tash po punon Serbia, është për ta gjymtuar shtetin e dytë të shqiptarëve në Ballkan, Republikën e Kosovës, ta gjymtojë deri në defunksionalizim të saj për të dëshmuar se nuk ka qenë i nevojshëm shteti i dytë i shqiptarëve, sepse shteti i dytë i shqiptarëve është problem për komunitetin ndërkombëtar, sepse shteti i dytë i shqiptarëve nuk di ta mbajë veten dhe nuk do të arrijë ta mbajë veten dhe nuk do të arrijë të jetë pjesë e këtij procesi.

Ajo që ne duhet të dëshmojmë qartë, është e kundërta e kësaj të cilën po e shohim. Të gjithë ne që jemi të interesuar për këtë punë, e kemi parë dhe kemi mund ta lexojmë platformën e shtetit serb sa u përket bisedimeve. Atëherë, janë një milionë probleme që duhet zgjidhur me Serbinë, por të gjitha këto probleme e kanë natyrën politike, nga e cila nuk guxojmë të ikim dhe nuk guxojmë të fshihemi. Pse duhet vazhdimisht të themi që nuk janë probleme politike, janë teknike. Gjithçka për Serbinë është problem politik në raport me Kosovën, sepse shumica shqiptare këtu udhëheqë me këtë shtet, se ky shtet i takon shumicës shqiptare dhe gjithçka tjetër që është këtu me status të privilegjuar, mbetet çështje e hapur për Serbinë, atëherë unë besoj që krejt ky proces ka për të shkuar në formulën e njëjtë. Jemi marrë vesh për të mos u marr vesh dhe Kosova në fund të nëntorit do të mbetet me problemet e njëjta, ndërsa Serbia do ta marrë datën për anëtarësim në BE. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Mendoj që edhe ju jeni dakord që të shkojmë në një pauzë deri në orë 14:15 minuta. A jeni dakord? Pauzë deri në 14:15 minuta.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, mendoj se mund të vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra, deputetë,

Ne mund të bisedojmë këtu edhe 48 orë pa u ndalë edhe nuk mundemi tok së bashku t'i numërojmë të gjitha krimet që i ka bërë Serbia në shekullin e kaluar në Kosovës. Në formë të ndryshme fqinji ynë vazhdon sot e kësaj dite të shpikë mënyra për të minuar atë që e kemi ndërtuar ne, mirëpo nuk besoj që kjo duhet të jetë arsyeja që tash ne këtu t'i shndërrojmë ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës në një log të mejdanit për ekspozë se kush është më patriot se tjetri dhe kush e urren më shumë Serbinë se tjetri. Këtu u tha se me Serbinë nuk duhet të bisedohet, e me kënd duhet të bisedohet me krimet që ai shtet na i ka shkaktuar problemet që vazhdon t'i shkaktojë, nuk besoj me Indonezinë as me Kroacinë, përveç me Serbinë, e cila edhe sot e tutje vazhdon t'i ushqejë strukturat paralele në veriun e vendit. Pra, kjo nuk ka alternativë, duhet të bisedojmë me shtetin serb dhe me përfaqësuesit që ata i zgjedhin, bile për hir të vërtetës, bilanci i bisedave me Serbinë është shumë optimist për ne. Kemi fituar në Rambuje dhe kemi fituar në Vjenë. Në të dyja këto procese ka pasur zëra skeptik se do t'i humbim betejat, por qytetarët e dinë dhe realiteti tregon se ne të dyja këto raste është shënuar sukses i paparamendueshëm. E kemi parë edhe dje, edhe pardje ushtrinë tonë, që për momentin e quajmë Forca e Sigurisë, mirëpo është rrugës për t'u shndërruar në ushtri, dhe parakalimet që ata i kanë bërë. Po mendoj, në të gjitha format, edhe simbolike, edhe përmbajtjesore Kosova është shtet dhe shtet shumë serioz për rajonin në të cilin ne gjendemi.

Plus kësaj, unë mendoj që Kosova kurrë nuk ka qenë më e përgatitur për t'u përballur me bisedimet për të gjitha problemet që e rëndojnë vendin tonë. Çfarë përgatitjesh dhe çfarë njohurish të veçanta duhet të kemi për të dëshmuar para botës se duhet të zgjidhet sa më parë problemi i pikave kufitare numër 1 dhe 31 që po sabotohen prej Serbisë. Këto probleme i dinë të gjitha institucionet tona. Kanë punuar në atë drejtim dhe i dimë humbjet të cilat na i shkakton mungesa e kontrollit të plotë. Ne i dimë edhe arsyet e vërteta pse nuk funksionojnë ato pika dhe Serbia ato i di dhe ajo punon natë e ditë për t'i dëshmuar. Nëse ne ulemi dhe bisedojmë me Serbinë dhe me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, të cilët do ta monitorojnë këtë proces dhe do t'i lehtësojnë bisedat, ky nuk është standard çka bën Serbia për Bashkimin Evropian. Format që i përdor Serbia për ta sabotuar jetën në Kosovë, është kundër standardeve të bashkësisë ndërkombëtare, prandaj unë nuk shoh kurrfarë frike që ne të ulemi dhe të bisedojmë në kuadër të pakos së Ahtisarit. Normalisht që Kushtetuta e Kosovës nuk vjen në shprehje për t'u ndryshuar se ajo është aprovuar këtu. Ajo mund të ndryshohet vetëm nga Kuvendi i Kosovës dhe unë nuk shoh kurrfarë paralaje, kurrfarë frike nuk duhet të kemi që të ulemi të bisedojmë dhe t'i themi haptazi ato probleme. Ose çfarë përgatitjesh të veçanta duhet të kemi për të dëshmuar në biseda se nuk dihet për fatin e Ukshin Hotit dhe mijëra të zhdukurve të tjerë. Ne të gjithë e dimë që ata mungojnë dhe nuk janë këtu. Ne të gjithë e dimë që Serbia e di ku gjenden trupat e tyre. Prandaj, çka humbim ne nëse bisedojmë edhe ua dëshmojmë edhe një herë publikisht edhe me ndihmën e ndërmjetësuesve për fatin e atyre që ne nuk e dimë ku janë.

Për zgjidhjen e problemit të CEFT-as, librat kadastral, për strukturat paralele, të gjitha këto probleme për ne janë të njohura dhe nuk ka kurrfarë frike, nuk do të duhej të kishte kurrfarë frike që Kuvendi i Kosovës sot ta aprovojë atë rezolutë, me të cilën ne do të futemi në bisedime në mënyrë serioze si partner i barabartë me shtetin serb, në kudër të dy republikave. Kosova tash e 10 vjet i ka institucionet e veta që kanë punuar në këtë drejtim për t'i identifikuar problemet që rëndojnë që e rëndojnë kryekëput vendin tonë. Prandaj, nëse Serbia përfiton rastësisht prej këtyre bisedave, pra duke marrë statusin e kandidatit për Bashkimin Evropian, është çështje tjetër, që për mendimin tim nuk është shumë relevante. Relevante për mua është që ne t'i zgjedhim problemet brenda shtetit tonë. Mund të them që në kuadër të bisedave me Serbinë, institucionet tona, përfaqësuesit e popullit tonë asnjëherë nuk kanë dështuar. Pika jonë më e dobët është menaxhimi i problemeve tona të brendshme, korrupsioni, drejtësia, shëndetësia, me të cilat ne duhet të merremi si Kuvend. Mirëpo, nuk e kemi asnjë njollë në biografinë e përfaqësuesve tanë që i kanë udhëhequr bisedimet, qofshin ato negociata, qofshin ato bisedime, ne vazhdimisht kemi dalë, kemi fituar ndaj Serbisë, ka fituar e drejta, jo ne.

Madje, nuk më duket shumë punë e zgjuar që ne të vejmë kushte për liberalizim të vizave, në mënyrë që ne të futemi në bisedime. Ky proces mund të vijë si pasojë e punës tonë, por jo edhe si kusht. Për mua personalisht, nëse bisedimet do të ishin të dëmshme vetvetiu, atëherë pak do të kishte rëndësi liberalizimi i vizave. Ne futemi në bisedime duke konsideruar që ato do të na i zgjidhin problemet që i kemi këtu dhe duke e identifikuar shkaktarin kryesor të këtyre problemeve që është Serbia.

Unë mendoj që më e rëndësishme është t'i zgjedhim problemet tona, sesa të insistojmë në viza. Në këtë seancë mund të diskutojmë me gjuhë revolucionare, mund të imitojmë edhe Leninin, edhe Maon, edhe revolucionarët tjerë majtistë, mund t'i frikësojmë qytetarët me faktin se bashkësia ndërkombëtare po na tradhton, por të gjitha këto janë vetëm paralaje që, dorën në zemër, nga kokat e disa individëve kanë zënë vend që prej vitit '99, në kohën e Konferencës së Rambujesë, kur thuhej se ne do të mbetemi krahinë autonome, që ushtria edhe policia serbe do të mbeten në

këto troje përgjithmonë. Mirëpo, u dëshmuar e kundërta, forcat e rregullta ushtarake dhe policore serbe janë larguar nga këtu. Ka mbizotëruar në vitin 2007, kur kemi qenë në Vjenë në bisedime, që Kosova do ta marrë njëfarë pavarësie gjysmake, një pavarësi që nuk do t'i hyjë në punë askujt, mirëpo fatbardhësisht ata zëra janë treguar që me të vërtetë kanë qenë vetëm paranoja, sepse 75 shtete e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur, plotësisht të pavarur, e këto shtete në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, pra janë miq tanë dhe pikë. Këtu nuk ka asnjë dyshim. E keni parë edhe sot, keni rastin për të lexuar edhe më tutje, në faqen 3 të "Kosova sot", e keni një editorial jashtëzakonisht të mirë të ambasadorit amerikan Kristofer Dell, i cili shkruan për bisedime dhe thotë - mos e luani lojën e tjetër kujt, luani lojën e juaj, futuni në bisedime, demonstroi se jeni të gatshëm për ta ndërtuar shtetin dhe demonstroi jani edhe shtetit serb që ata po shkaktojnë këto probleme dhe ne duhet t'i qasemi kësaj pune. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Kosova, për fat të keq, çdo ditë e më tepër është duke përparuar në rrugën e deformimit të demokracisë. Kjo përbën rast në shumë fusha, por ai që është më i rëndi ka të bëjë pikërisht në raport me këtë institucion ku jemi sot. Ajo që kemi parë për një kohë të gjatë është defaktorizimi i vazhdueshëm i organit më përfaqësues të popullit dhe koncentrimi i pushtetit në organin që çdo ditë e më tepër po përfaqëson interesat e individëve. Kuvendi i Kosovës është shndërruar në një skelet, i zhveshur nga çdo rol, përveç atij elementar. Me një viktimizim të tillë e nisi jetën edhe në këtë legjislaturë. Ai u anashkalua plotësisht edhe për një çështje fundamentale për interesin e qytetarëve, të cilët edhe i përfaqëson për çështjen e bisedimeve Kosovë-Serbi.

Bisedimet Kosovë-Serbi nuk janë çështje thjeshtë ekzekutive që hyjnë në kuadër të kompetencave të Qeverisë. Bisedimet janë çështje politike. Madje, edhe atëherë kur flitet vetëm për çështje teknike e praktike, vendimi për të biseduar me Serbinë është vendim politik. Prandaj, rrjedhimisht, është çështje për të cilën duhet të vendosë Kuvendi i Kosovës, si organi më përfaqësues i qytetarëve.

Këtu po shohim një lojë idesh, një garë idesh për dhe kundër bisedimeve. Jam i bindur se në fund të kësaj beteje, humbës do të dalë qytetari. Kjo është kështu sepse po e bëjmë një gabim qysh në fillim, çështjen e bisedimeve, më tepër se një çështje shumë të rëndësishme, po e trajtojmë si një çështje shumë të ngutshme. Kjo bën që për hir të kohës të sakrifkohet përmbajtja.

Është shumë lehtë që pa pasur agjendë e pa përgatitur platformë, përgjigjia për bisedimet të jetë - po. Po ashtu, është shumë lehtë që pa u përpjekur për agjendë e pa përgatitur platformë, përgjigjia për bisedime të jetë - jo. Por, a janë përgjigjet e tilla të merituar për bashkëkombësit tanë që jetojnë në gjendje të mjerueshme në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, e që nëse vazhdojmë t'i injorojmë kështu shpejt, nuk do të mund të jetojnë as kështu, sepse nga presioni do të zhvendosen nga atje krejtësisht? A janë përgjigjet e tilla të merituar për mbi 10.000 qytetarë të veriut të Mitrovicës, që mbi 10 vjet më parë janë dëbuar me dhunë nga pronat e tyre? A janë përgjigjet e tilla të merituar për mbi 2 milion qytetarë të Kosovës që i vuajnë përditë pasojat e pengesave ekonomike e politike që vijnë si rezultat i moszgjidhjes së çështjes shqiptaro-serbe?

Ne, si deputetë, nuk do të duhej ta ngujonim veten midis dy zgjidhjeve skajshmërisht të kundërta. Ne do të duhej të pajtoheshim për një zgjidhje më racionale. Në vend të ndaljes në vend, nga njëra anë, dhe në vend të tërheqjes prapa, në anën tjetër, ne sot do të duhej të vendosnim për ecjen përpara.

Duke pasur parasysh këtë ne, si deputetë të Lëvizjes për Bashkim, konsiderojmë se sot nuk kemi nevojë për ngutje. Nuk kemi nevojë për një rezolutë “për”, apo për një tjetër “kundër” bisedimeve. Sot kemi nevojë për një rezolutë që do ta ndërpriste procesin e bisedimeve të nisur në mënyrë arbitrare dhe do t’i linte kohë të mjaftueshme Kuvendit për të debatuar dhe hartuar një platformë për bisedimet e ardhshme. Për një rezolutë të tillë do të ishin të mjaftueshme vetëm tri pika:

1. Qeveria e Kosovës t’i ndërpresë të gjitha veprimet e mëtutjeshme në drejtim të bisedimeve Kosovë-Serbi;
2. Kuvendi i Kosovës, në afat sa më të shkurtër, pas një debati në mes të forcave politike, do ta hartojë Platformën politike për bisedimet e mundshme Kosovë-Serbi;
3. Kuvendi i Kosovës në kohën e duhur do ta autorizojë Qeverinë e Kosovës për zbatimin e Platformës së Kuvendit për bisedimet Kosovë-Serbi.

Këto pika që ne i propozojmë si përmbajtje të rezolutës janë të ndërtuara mbi premisa që shumë lehtë mund të jenë konsensuale për të gjithë ne, si deputetë. Përmes kësaj rezolute do të ndërpritej ky proces i dëmshëm dhe do të hapej mundësia për debat të mirëfilltë e pa presionin e kohës. Prandaj, në këtë rast, lus kryetarin e Kuvendit që ta ketë parasysh dhe t’ua japë mundësinë deputetëve të shprehen fillimisht për këtë propozim.

Zonja dhe zotërinj,

Me besimin e patundur në vullnetin tuaj të singertë për ta bërë më të mirën për vendin, ju ftoj ta ndjeni mbi supe peshën e vërtetë të situatës në të cilën ndodhemi. Të mos u ikim përgjegjësive ne që jemi këtu brenda, në mënyrë që të mos u rëndohen vuajtjet atyre që janë jashtë. Të marrim përgjegjësi dhe t’i marrim seriozisht ato. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Ahmet Jusufi e ka fjalën.

AHMET JUSUFI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky Kuvend po e vazhdon avazin e vjetër si të legjislaturës së kaluar, duke mos qenë autonom në veprimin e tij, por duke pranuar agjendat të cilat ad-hoc krijohen për t’i qitur para aktit të kryer deputetët e Parlamentit të Kosovës. Kështu ka ndodhur në të kaluarën, kështu po vazhdon, si duket edhe aktorët janë të njëjtit dhe për atë nuk po dallon edhe qasja. Ne në kohën kur po bisedojmë këtu për aprovimin ose mos aprovimin e një rezolute, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, ndoshta tash është në hava duke fluturuar për Bruksel, se nesër duhet të takohet atje, dhe kjo ngutje, ky vrap pa asnjë agjendë, pa asnjë platformë, pa asnjë element i cili do të ishte i përbërë nga vullneti i deputetëve të Parlamentit të Kosovës, tregon për seriozitetin e kësaj qeverie dhe mënyrën se si vepron në Kosovë dhe përgjegjësinë që e ka marrë kaq lehtë.

Disa elemente të cilat na shtyjnë të dyshojmë për nivelin e kësaj qeverisjeje është se pa u konsultuar me askënd, emërohet një përfaqësues i cili do të bisedojë për çështjet kapitale për vendin. Nuk ka asnjë bashkëpunim në mes subjekteve politike dhe institucioneve të cilat kanë përgjegjësi për vendin. Po ashtu, na ofrohet një rezolutë, këtu derisa jemi në gjatë pauzës, e cila duhet të aprovohet, thua se deputetët kanë obligim vetëm të bëjnë amin dhe të vazhdojnë më tutje, ashtu siç e ka parashikuar qeveria dhe kryeministri.

Veprimet e tilla pa asnjë konsensus, pa asnjë marrëveshje paraprake, pa asnjë debat më të gjerë, tregojnë se kjo qeveri nuk përfaqëson vërtet interesat e qytetarëve. Ashtu siç është krijuar, ashtu edhe do të shkojë një ditë, sepse nuk meriton më ndryshe.

Kryeministri flet për transparencë të plotë, ndërsa emërohen njerëzit pa asnjë transparencë, pa asnjë bashkëbisedim. Sillet rezoluta pa e pasur deputetët paraprakisht që ta konsultojnë atë, qoftë një ditë përpara bile së paku, dhe thotë mos përdorni kritika, por jepni ide dhe sugjerime. Po ne nuk mund të japim ide dhe sugjerime pa asnjë material përpara. Duhet të jetë qeveria serioze, duhet të jetë ky institucion që e ka marrë përgjegjësinë serioz, për të qenë na vërtet ata që mund të japim ide ose sugjerime. Si t'i besojmë kësaj qeverie kur Qeveria e Beogradit formon...

(Në sallë hyn Edita Tahiri, zëvendëskryeministre)

...u kthye, i paska ikur aeroplani, ka mundësi, me të mëngjesit po shkuakan, se këta për nguti ashtu e kanë, edhe rezolutat dhe krejt këto i bëjnë për nguti.

Si t'i besojmë kësaj qeverie e cila që në mandatin e parë që e merr, vitin e parë të shpalljes të pavarësisë, thotë brenda vitit do të kemi 100 njohje, e sot lavdërohet për 75 njohje pas 3 vjetësh. Si t'i besojmë kësaj qeverie, po ashtu, që vitin e kaluar vetë kryeministri na tha se do të kemi udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe ende po flasim për udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe nuk do të dimë kur do të jetë ky udhërrëfyes. Po ashtu mund të them se ai element i cili duhet të jetë i zhvillimit të bisedimeve në mes Serbisë dhe i Kosovës, duhet të jetë i nivelit të barabartë. Ne kemi përfaqësuesin tonë, e dini çfarë niveli, e dimë edhe të Serbisë çfarë niveli është dhe paramendoni me sa joseriozitet i qaset qeveria kësaj pune.

Po ashtu, në kohën kur Qeveria e Serbisë krijon ministri për Kosovën, ne nuk kemi asnjë zyre, madje, për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanovc, e ju e dini që para pak ditësh janë dënuar shqiptarët e kësaj pjese ku banojnë shqiptarët me 101 vit dhe asnjë zë nuk i ka dalë kësaj qeverie prej goje, së paku të solidarizohet me ndjenjat e familjarëve të tyre, ndërsa ata akuzohen gjëja për krimet brenda territorit të Kosovës.

Kjo mënyrë e sjelljes nuk është tregues i asgjëje tjetër përveç se deputetët të flasin në Parlamentin e Kosovës, mundësisht ta aprovojnë një rezolutë, e cila më shumë është propagandistike se sa që ka të bëjë me elemente konkrete për të cilat në vazhdimësi flitet dhe bisedimet të vazhdojnë në mënyrën që dikush i ka paraparë atje, që besoj që as këta nuk e dinë, dhe e keqja është këtu pikërisht, se shkohet në bisedime pa pasur agjendë, pa pasur platformë, pa pasur një marrëveshje të brendshme, një konsensus i cili do të mundësonte bisedime serioze. Prandaj, me mënyrën se si po sillet kjo qeveri, me mënyrën si po i imponohet parlamentit diçka që nuk është serioze, unë e di që nuk ka afat tjetër përveç që sa më shpejt të shkojë prej këtij institucioni kjo përbërje. Ju faleminderit!

KYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsedniče,

Uvaženi premijeru,

Zamenici premijera,

Ministri,

Predstavnici međunarodnih organizacija,

Drage kolege poslanici,

U ime Nove demokratske stranke i u ime nezavisnog kandidata koji štite pravo i interese Bošnjacke i Goranske nacionalne zajednice, koji su dobili poverenje našeg naroda koji živi na teritoriji celokupnog Kosova, mi u potpunosti podržavamo pregovore koji će uslediti između Republike Kosovo i Republike Srbije, odnosno sve ono što se tiče slobodne komunikacije, interesa svih naših građana, biznisa, slobode kretanja, otvorenosti u regionu, liberalizacije viza. Zahtevamo takođe od naše vlade da u procesu pregovora učestvuju i predstavnici Bošnjacke i Goranske nacionalne zajednice zato što na teritoriji Republike Srbije, a pogotovo na teritoriji Sandžaka živi veliki broj pripadnika Bošnjacke nacionalne zajednice. Takođe, zahtevamo da je od prioritetne važnosti uspostavljanje kontakata i pregovora sa Republikom Bosnom i Hercegovinom, gde mi kao predstavnici, odnosno poslanici Bošnjacke nacionalne zajednice nudimo se Vladi Kosova tokom ovih pregovora. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Amir Ahmeti, e ka fjalën. Regjia fjalën deputetit Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Tenderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Kam nderin që si deputet i Partisë së Drejtësisë, në kuadër të Koalicionit për Kosovë të Re, për herë të parë të marrë pjesë aktive në këtë kuvend, organin më të lartë legjislativ të Republikës së Kosovës, për këtë çështje kaq të rëndësishme - bisedimet midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane.

Pajtohem plotësisht me shumë kolegë deputetë, të cilët u deklaruan pro bisedimeve dhe ne, nëse e dimë se çka po duam, atëherë nuk duhet të frikësohemi prej këtyre bisedimeve. Po, para kësaj duhet të kemi parasysh se specifika e këtyre bisedimeve qëndron në faktin se po ndodhin pas një periudhe të rëndë, pas një gjakderdhjeje të madhe, pas një agresioni të paparë, pas një gjenocidi, pas një shtypjeje dhe dhune që iu bë popullit të Kosovës, e tëra e frymëzuar dhe e ushtruar nga makineria ushtarako-politike e Beogradit.

Bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë do të zhvillohen nën hijen e kësaj tragjedie, me barrë kaq të madhe dhe me pasoja po aq të rënda. Me çlirimin e Kosovës nga sundimi i Serbisë dhe duke u ç'konolizuar, fitoi jo vetëm Kosova, por edhe Evropa dhe hapi rrugë të integriteteve të lira në Evropën e kombeve dhe të shteteve të barabarta dhe të bashkuara.

Ne vlerësojmë se ndër temat për bisedë midis Kosovës dhe Serbisë duhet të jenë, që disa edhe i dëgjuam edhe prej kryeministrit dhe kolegëve tjerë deputetë, por për t'i fuqizuar ato, unë dua t'i përmend edhe disa:

1. Të zhdukurit dhe të pagjeturit;
2. Kompensimi i dëmeve të luftës,
3. Në bazë të reciprocitetit, të drejtat që i gëzojnë e Kosovës, duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës
4. Fondi i pensionistëve,
5. Lëvizja e lirë dhe njohja reciproke e dokumenteve personale dhe të udhëtimit,
6. Shuarja e strukturave paralele,
7. Tregtia e lirë dhe qarkullimi i lirë i mallrave e automjeteve dhe respektimi i reciprocitetit të plotë si në mallra, ashtu edhe në automjete, duke njohur edhe targat në mënyrë të ndërsjellë.

Dhe, krejt në fund, por jo më pak e rëndësishme, ndoshta pjesa më e rëndësishme e kësaj dhe, meqenëse e kemi këtu edhe zëvendëskryeministren për dialog, është shumë e rëndësishme që pas çdo rundi të bisedimeve, pala kosovare nuk duhet të lë përshtypje se bisedimet kanë kahe pozitive nëse nuk ka rezultate konkrete. Përkundrazi, duhet të theksoj qartë se bisedimet nuk po shënojnë kurrfarë përparimi në mënyrë që Serbisë të mos i mundësohet të krijojë opinionin pozitiv në bashkësinë ndërkombëtare dhe me këtë të lehtësojë marrjen e statusit të shtetit kandidat për anëtarësimin në BE. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot u përmend disa herë si nga kryeministri, ashtu edhe nga disa kolegë deputetë këtu se Republika e Kosovës duhet të hyjë në këtë dialog, në mënyrë që ta përmbush kriterin e fqinjësisë së mirë, që është ndër kriteret për integrimin e saj në Evropë. Në fakt, nuk besoj që ka ndonjë shtet në Ballkan, por në përgjithësi në Evropën Juglindore që e ka përmbushur këtë kriter deri më tani më mirë se Kosova, e cila ka shprehur përkushtimin për marrëdhënie të mira dhe paqësore me të gjithë fqinjët tash e vite me radhë, por çka është më me rëndësi, ky përkushtim është materializuar me fqinjët tanë të parë, si Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe me shtetet tjera të Evropës Juglindore me të cilat Kosova tanimë ka krijuar raporte të shkëlqyeshme dhe këto raporte po thellohen çdo ditë e më shumë.

I njëjti përkushtim për të ndërtuar raporte të mira me Serbinë dhe për të hapur rrugën e pajtimit në mes dy popujve tanë, është dëshmuar nga Kosova tash e disa vite, në fakt, përkundër asaj se Serbia asnjëherë nuk ka kërkuar falje për tentim shfarosjen e shqiptarëve të Kosovës, si dhe për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, të konfirmuara edhe nga aktgjykimet e Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë dhe nuk tregojnë për vendndodhjen e rreth 2000 të zhdukurve nga Kosova. Ne gjithmonë kemi dhënë sinjale pozitive për fqinjësi të mirë, duke menduar për të ardhmen e gjeneratave të reja të dy shteteve të tona dhe asnjëherë duke mos fajësuar kolektivisht popullin serb për krimet që kanë ndodhur. Pikërisht duke pasur të ardhmen e përbashkët euro-atlantike të gjithë popujve të rajonit si qëllim, Kosova është ulur në një tavolinë me Serbinë dhe ka negociuar për afër 2 vite, mirëpo negociatat kanë përfunduar një herë e përgjithmonë dhe

diskutimi me Serbinë i çfarëdo teme politike që prek çështjen lidhur me statusin, rregullimin e brendshëm kushtetues juridik, integritetin territorial dhe çfarëdo çështje tjetër që është e rregulluar me Kushtetutën e Kosovës, dhe më vjen mirë që kjo u konfirmua edhe nga kryeministri, por fatkeqësisht nuk ishte përmendur në draft - rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së, të gjitha këto çështje nuk negociohen më.

Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mbi të gjitha, ky Kuvend, nuk janë informuar deri në këtë fazë, nëse Qeveria ka bërë qoftë edhe përgatitjen më të vogël për të hyrë në dialog me Serbinë. Emërimi i zëvendëskryeministres nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë përgatitje serioze por, përkundrazi, një veprim i nxituar dhe i pamenduar që e ka vendosur Kosovën ende pa filluar në një pozitë të pabarabartë në këtë dialog. Edhe pse Kosova i ka institucionet e saj dhe ministrinë përkatëse me shërbyes civilë dhe njerëz të sektorëve që do të mund të organizonin këto përgatitje për dialog për çështje praktike, Qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të formuar grupet punuese të përbëra nga stafi teknik e jo politik, të cilët tashmë do të duhej të kishim përgatitur qëndrimet e Kosovës lidhur me të gjitha çështjet praktike që do të diskutohen.

Emërimi i postit të dytë më të lartë politik në Qeveri për të udhëhequr delegacionin e Kosovës në këtë dialog, derisa edhe vetë Serbia ka emëruar në shërbyes civil, i cili kryeson një grup të ekspertëve teknikë, këtë e ka konfirmuar edhe vetë udhëheqësi i delegacionit të Serbisë disa herë që tashmë janë formuar të gjitha grupet e ekspertëve të përbërë nga ekspertë teknikë. Kjo tregon për jo seriozitetin e Qeverisë, përkundër asaj se bëhet fjalë për çështje jashtëzakonisht serioze dhe delikate për Kosovën. Është thënë shpesh se është njësoj si dialogu me Serbinë, ashtu edhe dialogu me Malin e Zi, me Shqipërinë, me Maqedoninë, mirëpo për këto tri të fundit, ne e dimë se nuk kemi caktuar si shef delegacioni njeriun e dytë të Qeverisë, në fakt, asnjë post politik. Dialogu dhe thellimi i bashkëpunimit me këto tri shtete dhe me çdo shtet tjetër të rajonit, me çdo fqinj të Kosovës, bëhet në nivel teknik dhe këtë e dimë të gjithë. E njëjta do të duhej të ishte edhe në dialogun me Serbinë.

Të nderuar deputetë,

Qeveria në asnjë moment nuk e ka arsyetuar pse ky dialog duhet të jetë një proces kaq urgjent dhe prioritet për Republikën e Kosovës, kur është e qartë se ka një varg prioritetesh me të cilat ajo dhe të gjitha institucionet do të duhej të merreshin ose përndryshe pasojat për të ardhmen e vendit do të jenë të mëdha. Nuk ka asnjë informatë nëse Qeveria ka paraqitur një propozim agjendë para përfaqësuesve të BE-së, apo thjeshtë pret që dikush tjetër t'i servojë agjenda para saj, gjë që doemos e vendos Kosovën në pozitë të pafavorshme dhe parqet rreziqe për të ardhmen e saj dhe funksionimin e saj si shtet sovran dhe funksional. Prandaj, është me rëndësi që ky Kuvend t'ia përcaktojë Qeverisë vijat e kuqe, t'ia përcaktojë Qeverisë temat për të cilat nuk mund të bisedohet me Serbinë, por çka është edhe më e rëndësishme, në mënyrë laksative t'ia përcaktojë pikë për pikë, temë për temë ato për të cilat Qeveria mund të bisedojë, e jo siç u tha më herët, të fillojë nga kjo çështje dhe të përfundojë me këtë, sepse ne duhet ta dimë edhe çka është në mes.

Deri tani janë mbajtur një sërë takimesh me të dërguarin e BE-së dhe përmbajtja e tyre është komplet e panjohur për Kuvendin. Nuk dihet çfarë është biseduar apo për çka është pajtuar pala kosovare në ato takime. Mbi të gjitha, nuk dihet çka përfiton pala kosovare nga ky dialog i nxituar dhe i papërgatitur, siç u tha disa herë sot, derisa është më se e qartë çka përfiton Serbia. U shtrua pyetja nga disa kolegë deputetë, thanë - çka përfiton Serbia, në fakt Kosova po përfituaka më shumë. Serbia përfitojë statusin e kandidatit, Serbia përfiton një paqartësi, e cila

do të ndërtohet në kokat e udhëheqësve të shumë shteteve që ende nuk e kanë njohur Kosovën, dhe Serbia do të përfitojë argumentin që e ka përmendur edhe para GjND-së dhe e përmend çdo ditë e më shumë që çështja e Kosovës apo e statusit të Kosovës ende nuk paska përfunduar dhe kështu kërkon që ky dialog të shkojë në pafundësi.

Nuk duhet të lejojmë asesi që ky proces të shndërrohet në një proces negociator, ashtu siç fatkeqësisht është ë quajtur disa herë nga udhëheqës të lartë institucional të Kosovës. Ky duhet të jetë një dialog në mes dy shteteve fqinje të barabarta, në përputhje me parimin e reciprocitetit. Përfundimisht, është e domosdoshme dhe më vjen keq që Grupi Parlamentar i PDK-së, në propozimin e tyre nuk e ka përfshirë, që afati i bisedimeve të përcaktohet qysh tani, në mënyrë që Kosova mos të hyjë në një proces, të cilit nuk i dihet as rezultati, e as fundi. As Rezoluta e Kombeve të Bashkuara që thërret për dialog, nuk cakton afatin kohor kur ky dialog duhet të fillojë, prandaj nxitimi i Qeverisë është i pakuptueshëm.

Jam shumë e sigurt që as miqtë tanë ndërkombëtarë nuk do të donin që Kosova për një proces kaq të rëndësishëm të hynte totalisht e papërgatitur, siç është sot. Afatizimi i bisedimeve duhet të miratohet nga Kuvendi, ashtu siç duhet të miratohet me 2/3 e votave të Kuvendit çdo marrëveshje që e arrin Qeveria e Kosovës në këtë dialog me Serbinë. Ju, besoj, të gjithë e dini që na mandaton Kushtetuta e Republikës së Kosovës që marrëveshjet ndërkombëtare, e ne këtë e karakterizojmë si marrëveshje të karakterit ndërkombëtar, me qenë se do të jenë në mes dy shteteve, duhet të miratohet nga 2/3 e votave të Kuvendit. Pa këtë miratim nga ana e Kuvendit, secila marrëveshje e tillë duhet të konsiderohet e pavlefshme dhe e pazbatueshme. Prandaj, siç u tha edhe më herët, LDK-ja derisa fuqishëm promovon marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët, ajo është e bindur se ky dialog është i nxituar, i papërgatitur, i pa strukturuar, pa agjendë të qartë, i paafatizuar, dhe çka është më e rëndësishmja, Kosova nuk e di çka po përfiton nga ky proces. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nesër në Bruksel do të nisë dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i kërkuar nga faktori ndërkombëtar dhe i përcaktuar në Rezolutën e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, të miratuar më 9 shtator të vitit të kaluar, ku në paragrafin (f) thuhet se: “përkrahet gatishmëria e Bashkimit Evropian që të lehtësojë dialogun ndërmjet palëve”. Prosesi i dialogut, thuhet më tej në këtë Rezolutë, vetvetiu do të ishte faktori i paqes, i sigurisë dhe i stabilitetit në rajon. Ky dialog do të kishte për qëllim që të avancojë bashkëpunimin dhe të realizojë përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe në përmirësimin e jetë së njerëzve.

Të nderuar deputetë,

Duke mos harruar faktin se Kosova nuk mori pjesë në hartimin e kësaj rezolute, me të cilën Serbia u pajtua plotësisht, duhet ditur se kjo rezolutë neve na obligon në mos me asgjë tjetër, atëherë për faktin se Kosova synon një kohë relativisht të afërt të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian dhe e Organizatës të Kombeve të Bashkuara. Pikërisht këtë duhet t’ua bëjmë me dije miqve tanë ndërkombëtarë që në ditën e parë të nisjes së dialogut, duke kërkuar jo vetëm

vizionin në synim të qartë, por kohën dhe datën konkrete. Pa këtë nuk do të kishin asnjë kuptim bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Të përkujtojmë faktin se në vendin tonë që nga viti 1999 kemi një prani të fuqishme civile dhe ushtarake ndërkombëtare. Do të ishte krejtësisht e pakuptimshme nëse Misioni ndërkombëtar në Kosovë do të ishte i përbërë nga kuadrot më të afta, më të përgatitura, më të përkushtuara dhe tash ne të mbetemi mbrapa Serbisë në rrugën e integriteteve evropiane, e cila tash me nisjen e këtij dialogu pritet të fitojë statusin kandidat për Bashkimin Evropian, ndërsa ne si Kosovë nuk do ta marrim as udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, duke mbetur kështu vendi i fundit në botë për të drejtën e qytetarëve për të udhëtuar jashtë shtetit pa pasur nevojë për viza. Mua më duket e turpshme të pranoj se këtu në Kosovë na paskan dërguar një mision shumë të madh, me numër çfarë ishte dikur UNMIK-u, e tash EULEX-i, i cili në të gjitha parametrat qenka mbrapa pushtetarëve e administratës të Serbisë, një vazhdimësi e regjimit që e kalli gjithë Jugosllavinë dhe që e vrau kryeministrin e vet.

Të nderuar deputetë,

Për dalim prej bisedimeve të Vjenës, ku gjithashtu na u tha se nuk po bisedohet për statusin, ne në këtë dialog duhet të shkojmë të përgatitur dhe me një platformë të qartë që do të miratohej na ky Kuvend, si institucioni më i lartë i popullit. Në këtë duhet të jemi të gjithë të bashkuar, sepse me Serbinë e kemi një konflikt apo një luftë tash e 100 vjet, e cila na ka lënë shumë pasoja për vrasjet, masakrat, shkatërrimet dhe shpërnguljet, spastrimin etnik të territorit dhe kolonizimin e dhunshëm, që ne ende nuk jemi këndellur dhe nuk e kemi marrë veten si komb dhe si shtet. Për fatin e keq, jo vetëm tonin, por edhe të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të historisë përgjithësisht, ende fajtorët nuk janë ndëshkuar, as edhe si shembull që gjërat e këtilla të mos ndodhin më në të ardhmen. Evropa nuk pati unitet të dënojë dhe të shpallë të jashtëligjshëm ideologjinë dhe regjimin që shkaktoi luftërat në Slloveni, në Kroaci, në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë. Fatkeqësisht, ne tash detyrohemi të bisedojmë me Serbinë, ku në pushtet janë socialistët e Millosheviqit, që edhe sot e lartësojnë atë, duke e gjykuar bashkësinë ndërkombëtare për intervenimin ushtarak të NATO-s në Kosovë.

Për mua dhe për gjithë popullin e Kosovës, ndërhyrja e NATO-s pas luftës disavjeçare të bijve dhe të bijave më të mirë të Kosovës, të rreshtuar në radhët e Ushtrisë së lavdishme Çlirimtare të Kosovës, përbën pikën më të lavdishme të angazhimit të përbashkët të shumë shteteve, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për ndaljen e gjenocidit dhe deportimin me dhunë të shqiptarëve nga Kosova. Për këtë, populli i Kosovës për jetë falënderohet dhe është i gatshëm që bashkë me miqtë ndërkombëtarë të realizojë ëndrrën që të jetë i lirë dhe i dinjitetshëm krahas popujve dhe shteteve të tjera të Evropës së bashkuar.

Të nderuar deputetë,

Për të gjitha këto që i përmenda, ne si Kuvend i Kosovës duhet ta kryejmë rolin tonë kushtetues gjatë gjithë fazës së dialogut ndërmjet Kosovës dhe të Serbisë, si dy shtete të barabarta dhe me sovranitet dhe integritet territorin të paprekshëm dhe ta arrijnë një marrëveshje paqeje, e cila do të përmbyllte një konflikt, si e deklaroi presidenti i Serbisë, 150 vjeçar, duke marrë përgjegjësitë dhe duke nxjerrë mësim.

Hapi i parë i Serbisë në këtë drejtim do të ishte që të kthej në Kosovë pa asnjë kusht të gjitha ato që në mënyrë të organizuar dhe me plan i mori nga Kosova dhe i dërgoi në Serbi. Këtu, të parët duhet të kthehen trupat e më të dashurve tanë, që si të gjallë apo të vdekur dërguar në Serbi dhe

u varrosën nëpër poligonet policore ushtarake, mandej Serbia të kthej në Kosovë të gjithë ata kriminelë e përgjegjës që këtu vranë, masakruan, plagosën, dhunuan, dogjën e plaçkitën, në mënyrë që ata të përballen me drejtësinë e vendit, ku i kryen krimet, në procese të ndershme e transparente gjyqësore.

Serbia, si fqinj i ynë, nuk duhet të shërbej si atak për vrasjet e kriminelët që vranë rreth 13 mijë qytetarë të Kosovës, që dogjën 127 mijë shtëpi, që larguan me dhunë nga Kosova 800 mijë shqiptarë. Për këtë nuk ka dhe asnjëherë nuk do ketë amnisti. Serbia duhet të kthej pa asnjë kusht të gjithë dokumentacionin zyrtar të marrë nga Kosova e të dërguar në Serbisë, siç janë: librat kadastral, librat e amzës, dokumentacioni arkivor dhe artefaktet muzeore kulturore. Këto nuk duhet të jenë temë e bisedimeve, por Bashkimi Evropian duhet ta detyrojë Serbinë t'i përmbushë këto pa asnjë kusht.

Të nderuar deputetë,

Bisedimet në emër të Kosovës duhet t'i udhëheqë Qeveria e Republikës së Kosovës. Të gjitha grupet duhet të drejtohen prej ministrive përkatëse, në të cilat duhen të jenë të futura komisionet parlamentare, ekspertët dhe shoqëria civile. Vetëm kështu mund të prezantohemi në mënyrë dinjitoze si shtet që respektojmë ligjet dhe Kushtetutën e vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tash kanë mbetur deputetët kryesisht të "Vetëvendosjes" dhe të Partisë Demokratike. Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Kryetar dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kosova nuk do të shkojë në negociata me Serbinë për pa i plotësuar Serbia të gjitha ato kushte që ne i kemi vënë në Rezolutën që tashmë e prezantoi kryetari i grupit tonë parlamentar, sepse për Kosovën Serbia nuk është kurrfarë zgjidhje, përkundrazi Serbia është vetë problemi. Kosova Serbinë e njeh si kujtim të trishtë, si aktualitet kërcënues dhe si të ardhme të rrezikshme. Populli i Kosovës e njeh Serbinë vetëm si okupim, kolonizim, dhunë, dëbim, shkatërrim e gjenocid. Për asnjërin prej këtyre të bëmave në Kosovë, Serbia nuk ka treguar shenja pendese, përse duhet t'i përkulemi kërkesave të saj. Edhe pas gjithë historisë së saj kriminele, jo vetëm në Kosovë, është Serbia ajo të cilën po e kërkon BE-ja me çdo kusht brenda saj dhe është Serbia, asaj të cilës po i ngutet po ashtu për në BE-e, por padurimin e BE-së Serbia po e kushtëzon me koncesione në Kosovë, shumë më shumë se sa Qeveria e Kosovës dhe Brukseli që po e kushtëzojnë Serbinë me pranimin e Kosovës.

Ne nuk pajtohemi që bashkësia ndërkombëtare ta sundojë Kosovën dhe ta shtyjë atë në negociata dhe kompromise të reja me Serbinë. Ky është keqpërdorim. Ne kundërshtojmë që BE-ja ta marrë në gjirin e vet Serbinë duke ia plotësuar asaj apetitet për Kosovën. Në këtë situatë, pra në këtë kohë kur Serbisë po i nxitohet për të hyrë në BE, ky është një rast shumë i mirë që Kosova ta kthej këtë situatë në të mirë të vetvetes duke e kushtëzuar Serbinë. Por, me këtë qeveri që e ka Kosova, po duket që Serbia do të hyjë në BE dhe duke fituar diçka edhe më shumë nga Kosova.

Nëse e keni parë justifikimin e qeverisë dhe të gjithë atyre që i përkrahin negociatat e Kosovës me Serbinë, atëherë janë të qarta katër lloje të arsyetimeve që këta i bëjnë pse Kosova u dashka të shkojë në negociata me Serbinë sa më parë. E para, është se sipas tyre nuk do të rihapet statusi dhe nuk do të flitet për kufijtë, e dyta është se do të na njeh me këto negociata, e treta është se janë çështje vetëm teknike dhe, e katërta, se nuk do të kemi frikë nga negociatat me Serbinë.

Sa i përket rihapjes së statusit apo të kufijve, fakti që nuk do të flitet për statusin e Kosovës apo për kufijtë, nuk është argument i mjaftueshëm që populli i Kosovës të rrijë i qetë. Edhe plani i Ahtisarit u pranua duke u thënë se u zgjidh statusi, por është pikërisht kjo gjendje politike që po na çon në negociata të reja me Serbinë. As plani 6 - pikëshi i Ban ki Munit nuk e prek statusin apo kufijtë, por ai e minon vendin tonë nga brenda. Çka do të na duhen kufijtë e vizatuar në hartë, nëse një pjesë e territorit të Kosovës rrezikon të mos kontrollohet nga shteti ynë. Populli i Kosovës nuk do të shqetësohet dhe do të gëzohet vetëm atëherë kur Kosova e kontrollon çdo pëllëmbë të tokës së vet.

Sa i përket arsyetimit se Serbia do të na njohë me këto negociata, shtrohet pyetja: - po si është e mundur që këto negociata të qojnë në njohje, kur po ka negociata pikërisht pse Serbia nuk po na njeh. Pikërisht negociatat janë riprodhim i mosnjohjes së Kosovës nga ana e Serbisë, dhe së dyti, po ka negociata sepse Kosova nuk po e shtrinë sovranitetin që i takon. Pikërisht mungesa e vullnetit politik për sovranitet po i riprodhon vazhdimisht negociatat. Negociatat, të nderuar deputetë, nuk janë zgjidhje, negociatat me Serbinë. Zgjidhje e vetme është sovraniteti i plotë i Kosovës në të gjithë territorin e vendit tonë.

Populli dhe shoqëria jonë ka vullnet për sovranitet, por problemi është që ky vullnet po i mungon Qeverisë së Kosovës. Tjetra është që po thonë se janë çështje teknike. Gjatë negociatave të shkuara të Vjenës, u fillua me negociata po ashtu të natyrës teknike, por u përfunduan me 5 + 1 komuna të reja serbe, u humb trashëgimia kulturore, u legalizuan strukturat paralele dhe u krijua një potencial i madh për rikolonizimin e Kosovës. Edhe në këto negociata po fillojnë me të ashtuquajtura çështje teknike praktike, por që mund të përfundojnë, ashtu siç ka edhe zëra ndërkombëtarë, edhe me veriun e Kosovës.

Më 2007, kur filloi së zbatuari plani i Ahtisarit, kryeministri Hashim Thaçi pati thënë se nuk do të ketë më negociata me Serbinë. Tash po shkon në negociata. Ai pra nuk është kredibil për bash asnjë premtim. Ti besosh Hashim Thaçit kur premtim, do të thotë ta përçmosh vetveten, kujtesën, po qe besa edhe mediat, të cilat i kanë incizimet.

Të gjithë ata që mendojnë se për lirinë tonë është dashur si sakrificë plani i Ahtisarit, kurse tash janë të gatshëm për kompromise edhe tjera. Të gjithë këta mendojnë se 150 vjet dëbime, shtypje, dhunë e gjenocid janë pak për kombin shqiptar. Të gjithë këta mendojnë se 2500 dëshmorë të luftës së fundit dhe 14 mijë të vrarë janë pak dhe pak janë po ashtu të gjitha ato vuajtje, që për këta janë të papërfillshme. Politikanët si këta nuk e qajnë fare kokën për interesin e popullit të Kosovës.

E fundit është që po thonë se nuk duhet të kemi frikë nga negociatat me Serbinë. Në fakt, unë mendoj që sot guxim dhe mbrojtje e interesit të Kosovës është pikërisht t'i kundërshtosh negociatat me Serbinë, kurse frikë e pashpjegueshme dhe qyqarllëk është t'i përgjigjesh Serbisë kurdo që asaj ti teket, siç janë këto negociata. Prandaj, Kosova nuk ka nevojë për negociata me Serbinë, ajo ka nevojë për sovranitet dhe Kosova nuk ka nevojë për kompromise me Beogradin, sepse ajo ka nevojë për kufi të fortë dhe për ushtri.

Kosovës nuk i duhen aventura të rrezikshme prej të cilave do të mund të humbë Kosova, por Kosovës i duhet zhvillim ekonomik dhe mirëqenie për popullin e saj. Të mendosh dhe të besosh se këto probleme të brendshme që i ka Kosova mund të zgjidhen me negociata me Serbinë, për këtë duhet të jesh goxha i çmendur. Negociatat me Serbinë nuk do t'i zgjidhin problemet e

brendshme të Kosovës. Këto negociata problemet ekzistuese eventualisht do t'i ndërlikojnë dhe do t'i vështirësojnë ato.

Arsye shtesë pse nuk do të shkojmë në negociata me Serbinë janë edhe politikanët e Kosovës. Është jo vetëm e paleverdishme, por madje e rrezikshme të qeverisesh nga njerëz të dyshuar që janë të korruptuar dhe qëllimi suprem i të cilëve është pushteti për të mirën e tyre vetjake, sepse të verbuar pas pushtetit, atyre iu dobësohet ndjenja e dashurisë, si dhe ju mjegullohet interesi i popullit. T'ia lësh fatin e atdheut në negociata me armikun tonë njerëzve të cilët mund të jenë të shantazhuar, është sikur t'ia besosh që do ta ruajnë djathin minjtë. Këta politikan që sot po e quajnë Kosovën në negociata me Serbinë, janë po këta që e kanë përfaqësuar Kosovën në negociata në vitin '99 dhe në vitin 2007 në Vjen. Në të dyja këto raste, këta politikanë nuk duhet t'i falënderohen as zgjuarsisë dhe patriotizmit të vet, sepse herën e parë kanë pranuar autonomi në Serbi, e as bashkësisë ndërkombëtare, por ata duhet t'i falënderohen Serbisë për kokëfortësi të saj, herën e parë Millosheviqit, e herën e dytë Koshtunicës. Nuk e di nëse Serbia do t'i shpëtojë ata edhe herën e tretë, por e di shumë mirë një gjë, që vendi ynë nuk ka nevojë për politikanë të tillë, të cilët Serbisë i rrinë gatitur, e popullin e Kosovës nuk e pyesin për asgjë.

Nëse kam kohë, do ta kisha përmendur edhe Berat Buzhalën, nëse është këtu, i cili tha se duhet të bisedojmë me Serbinë, e cila i ka strukturat e veta paralele në Kosovë. Këqyr çfarë konkludimi! Kjo është thirrje për t'u negociuar edhe ligji, edhe sovraniteti, sepse strukturat paralele të Serbisë, siç e dimë, janë të paligjshme. Shtetet demokratike dhe sovrane nuk debatojnë kurrë a duhet a nuk duhet të zbatohet ligji. Berati tha se të gjithë e dinë këtu se çka ka bërë Serbia dhe nuk ka nevojë garë për patriotizëm. Ne, të nderuar deputetë, nuk dallojmë këtu se cili ma mirë e dimë se çka ka bërë Serbia, por dallimi është se si e përjetojmë këtë, se si i përjetojmë ne këto krime që i ka bërë Serbia. E dimë që Beratit nuk i bëjnë fare përshtypje dhe as që i bën atij nëse Kosova vazhdimisht përfundon me atë shtet që ka bërë kësi krime në negociata të vazhdueshme me Serbinë.

Ne e kuptojmë gjuhën mercenare të Berat Buzhalës, sepse ai ju ka borxh të përjetshëm, do t'ju thosha, këtyre njerëzve të cilët po ju mbrojnë...

KRYETARI: Një minutë, regjia!

... e ka për obligim që t'i mbrojë këta njerëz dhe për atë nuk mund ta marrim seriozisht, sepse nuk mund të jetë objektiv një njeri i cili është këtu për të shlyer borxhe, e jo për ta përfaqësuar interesin e popullit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pasi kërkesa është e Qeverisë, zëvendëskryeministri e ka kërkuar fjalën, në emër të Qeverisë.

ZËVENDËSKREMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, ministra,

Unë debatin e sotëm e kuptoj si diçka krejt normale, të domosdoshme, diçka që duhet të fillojë dhe të mbarojë në Kuvendin e Kosovës. Natyrisht që në këtë rast, në këtë debat i shtohet serioziteti çdo aktiviteti që e bëjnë institucionet e Kosovës. Unë besoj që është edhe një përpjekje për legjitimitet politik dhe demokratik, por edhe për konsensus nëse mund të arrihet, por patjetër është edhe një përpjekje për korrektim të proceseve nëse ka pasur shkarje aty - këtu. Ajo çka

mund të themi, është që vakuumi institucional i muajve të kaluar me siguri ka lejuar edhe një vakum në informacionin e duhur apo të raporteve të institucioneve të vendit.

Unë do të flas për disa fenomene, besoj që lidhen me këtë proces dhe do të mundohem të jap një përgjigje të përbashkët. E para, është një proces që duhet të ballafaqohemi që të gjithë në prizmin tonë, në mendimin tonë, dikush me një pozicion më të sforcuar, dikush me një dilemë më të madhe apo do të thosha ata që kanë dilema dhe që kanë optimizëm. Se do të ketë dialog, a ka qenë vullnet i yni apo jo, është diçka tjetër, por është ditur që nga 9 shtatori i vitit 2010 dhe, nëse e lexon dikush një Rezolutë dhe besoj secili e kemi lexuar nga ne, e kemi parë që aty duhet të ketë. Është krejt e natyrshme që disa të kemi dilema, disa të kemi optimizëm.

Pse po e them këtë?

Dilemat kanë të bëjnë, u përmend në disa raste që dështimet që kanë qenë të raporteve apo të dialogëve Kosovë - Serbi. Është e vërtetë, çdo dialog Kosovë-Serbi, kemi pasur dy deri me tani, kanë dështuar. Por është e vërtetë që në këtë dialog, Kosova bashkë me Bashkësinë ndërkombëtare ka përfituar dhe tani këtu duhet ta shohim këtë prizmin. Nuk po shkojmë në këtë dialog për hir të Serbisë as për nevojat e Serbisë, por po shkojmë për t'i dialoguar, në një rast në Rambuje për të dialoguar ka qenë për të fituar lirinë e Kosovës, në Vjenë për ta fituar pavarësinë e Kosovës dhe tani po mendojmë bashkërisht që do t'i fitojmë proceset integruuese në Union Evropian.

Unë e di që ka tri çështje që janë këtu me rëndësi. E para janë akterët, e dyta tema dhe e treta afati kohor. Akterët, edhe pse në Rezolutë janë paraparë deri diku, me kërkesën dhe insistimin tonë është mirë që përveç BE-së, janë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nëse nuk ka hendek në mes të BE-së dhe nuk ka hendek të BE-së dhe SHBA-ve, ne nuk duhet të frikësohemi dhe unë mendoj se kjo rezultat i asaj që ne duhet t'i besojmë dhe besimi lind mbi bazën e asaj që janë provuar këto raporte.

Çështja tjetër që ka të bëjë, janë temat. Unë pajtohem plotësisht që të kemi një platformë për temat dhe vijat e trasha, platformë të detajizuara. Besoj secili delegacion në botë ia lejon vetes një minimum dhe një maksimum. Por minimumi dhe maksimumi nuk ka nevojë t'i thuhet askujt. Në këtë vend është Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe secili, ne themi për ata që janë juristë, disa po duket dolën nga salla, faktet notore nuk provohen. Nuk ka nevojë t'i tregohet kujt në këtë sallë që marrëveshja duhet të ratifikohet në Kuvend. Kushdo që nuk ratifikon marrëveshje në Kuvend, e shkel Kushtetutën dhe kjo është punë e kryer.

Çështja e dytë, që unë e shoh një dallueshmëri edhe sa i përket afatit kohor. Unë jam ithtarë që dialogu me Serbinë mos të jetë i pafundshëm. Ne duhet të negociojmë me BE-në dhe SHBA-në që të vejmë një afat kohor, a mund të jetë 3 muaj, 6 muaj. Unë e di që vetëm ne nuk mund të vëmë këtë, por ky Kuvend ka nevojë që ta kërkojë një afat kohor dhe afati kohor është një presion pozitiv. Unë nuk dua të ndërlihem në raportet tona pozitive –opozitive, por duhet t'i shohim në prizmin. Unë e kuptoj ndryshimin e rolit dikush që e ka luajtur na opozita dhe në opozitë, por ai rol nuk guxon të luaj diametralisht. E di logjikën që e ka edhe LDK-ja, edhe AAK-ja. Edhe unë e di që nuk janë kundër dialogut. Natyrisht që në prizmin e opozitës mund t'i shohin gjërat pak më ndryshe. E kuptoj konceptualisht "Vetëvendosjen", jo për t'i bërë lajka, këta kanë ardhur me këtë strategji, me këtë mision dhe e kuptoj deri diku, por ku është dallimi i tyre me neve, që mendoj në qëllim nuk dallon. Ato çka po thonë këta, është kusht, ne po mendojmë që tema të bisedimeve, dhe qëllimi është i njëjtë. Edhe këta po mendojnë për t'i

zgjidhur ato çështje, edhe ne, por ne nuk po shohim rrugë që mund t'i zgjidhim pa dialoguar. Nëse dikush na e gjen këtë çelës që mund ta fitojmë njohjen, mund t'i gjejmë personat e pagjetur, t'i marrim kadastrat dhe kështu me radhë pa dialogim, ne do t'i apludojmë në Kuvendin e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës me siguri do ta ftoj atë që të jetë edhe njeri shumë i respektuar.

Unë e kuptoj edhe raportin e një presioni pozitiv pozitiv - opozitë. Pse po e them presion pozitiv? Unë e ftoj opozitën dhe shoqërinë civile të na bëjë një presion pozitiv ndaj Qeverisë për vijat e trasha, por bashkërisht jo në garë kush ke po e mund, por në garën sa ma mirë po e prezantojmë Kosovën dhe po e prezantojmë para bashkësisë ndërkombëtare. Nëse në këtë drejtim na ndihmon opozita dhe besoj i ndihmojmë këtë rast Kosovës. Garat tjera janë ... konkurse, nga ana tjetër a po e mundim ne opozitën apo pozita neve në Kuvend, është ..., por në këtë rast presioni pozitiv mbi ne, ne do t'i themi shumë hapur bashkësisë ndërkombëtare, Kuvendi na e ka dhënë këtë, e kemi një opozitë që kërkon këtë dhe ne nuk jemi në gjendje që të bëjmë veprime të tilla. Kjo është një ndihmesë dhe unë besoj që këtu duhet të jemi të qartë secili me njeri - tjetrin.

“Vetëvendosja” e ka çështjen e zgjidhjes së problemeve nacionale dhe po kam dëshirë pak të bëj debat. Problemet nacionale nuk zgjidhen pa i zgjidhur kontestet me ata çka i ke dhe për mua, ky është mendimi im personal, më telashe s'i i ka raportet Kaçaniku me Tetovën, Gjilani me Preshevën apo Peja me Rozhajën, se sa Prizreni me Kukësin. '99-ta i ka dhënë një përgjigje Prizrenit edhe Kukësit, po i ka lënë do përgjigje tjera dhe pa i zgjidhë disa probleme, do ta quaj në raport me Serbinë, kemi problem që t'i zgjidhim në tërësi raportet apo zgjidhjen e problemeve nacionale. Nuk kemi nevojë që të themi Serbia çka ka qenë. Më shumë a ma pak, secili prej nesh kur e përmend emrin Serbi, nuk ka ndjenjë të mirë, kështu së paku, dikush e ka ndjenjën më të keqe, dikush ka përjetuar më shumë dhe aty e matim me kilogram apo me çka do, me gram, por e them që në këtë drejtim po ashtu nuk duhet të kemi fobi.

Unë kam dëshirë dhe besoj secili qytetarë, sa herë që BE-ja dhe SHBA-të kërkojnë diçka nga Kosova, Kosova duhet të jetë me reflektim pozitiv, por natyrisht me vija që nuk e dëmtojnë interesin kombëtar dhe unë besoj që është vërtetuar që edhe BE-ja, edhe SHBA-ja nuk kërkojnë nga Kosova që të dëmtojë interesin kombëtar.

Është e vërtetë që ne po u themi shpesh herë njerëzve çka nuk duam. Besoj, e kemi si pjesë të fjalorit në tërë Ballkanin. Edhe unë shpesh herë them, këtë s'e kemi drejtë. A ka mundësi që këtij populli, këtyre qytetarëve të vendit, por edhe partnerëve tanë ndërkombëtar t'ju themi çka duam? Nuk duam të preket tërësia territoriale, nuk duam këtë, nuk duam këtë dhe është shumë e drejtë, por kemi nevojë që t'i themi e duam këtë, e duam këtë dhe unë besoj, në mes atyre çka nuk duam, që ishin katër vijat e kuqe, kemi nevojë që t'i themi që duam integritet në Union Evropian, duam 5 shtete anëtare të BE-së të na njohin dhe kemi nevojë gjithsesi për një anëtarësim në OKB. Tek e fundit, edhe qëndrueshmëria jonë, jo vetëm si shtet, por edhe ekonomike dhe tjetër nuk varet mbi logjikën e izolimeve, por mbi logjikën e bashkëpunimeve edhe brenda, edhe jashtë Kosovës.

U dhanë mendime të krahasueshme shpeshherë a duhet të jetë dialogu si me Serbi, si me Shqipërinë. Unë besoj që kur bëjmë një politikë njëherë të madhe, themi kështu, kështu sikur me të gjithë, nuk janë të barabarta. Unë besoj se këtu duhet të jemi shumë të qartë. Dialogu me Serbinë është tjetër, dialogu që bëhet me Shqipërinë, me Maqedoninë, me Malin e Zi është tjetër dhe këtu nuk kemi nevojë asnjëri - tjetrit t'i themi që është më mirë apo më keq. Por, natyrisht

duhet t'i zhvillojmë këto. E përmendi Albini, po e përmendi me emër, unë vetëm po jap informatë që ne kemi filluar transmisionin energjetik nga Kosova me Shqipërinë dhe është në përpunim e sipër ajo punë, nuk është punë që nuk bëhet. Por, çka kemi për obligim ne politikanët? T'i heqim pengesat politike, pastaj të tjerët janë ata që zhvillojnë energjetikën, dikush transportin, dikush kulturën, dikush tjerat, por ne politikanët duhet t'i heqim pengesat politike dhe pengesat politike besoj nuk janë në raport me Shqipërinë shumë. U përmendën edhe çështjet që kanë të bëjnë me një koordinim më të mirë dhe unë pajtohem këtu. Ka nevojë të jetë një koordinim më i mirë politik dhe ka nevojë të ketë grupe punuese edhe nga opozita, edhe nga pozita dhe nga shoqëria civile dhe këtu secili mund a luaj rolin e vet ashtu sikur çfarë edhe e meriton.

Krejt në fund, do të thosha që pjesa e dialogut me Serbinë është pjesë që mund ta bëjmë një garë deri diku, po e them vija edhe me njëri - tjetrin, por më shumë është garë që duhet ta fitojmë të gjithë bashkë, në raport me bindjen tonë, me konstruktivitetin tonë, me qëndrueshmërinë tonë përballë Serbisë, përmbi të gjitha me bindjen për vazhdimësinë e mbështetjes që duhet ta kemi në BE dhe në SHBA. Dhe, po e përfundoj pak me një shaka. E kam parë që shumë po merreni me fjalime të kryeministrit dhe po më duket ka një institut që merret me fjalimet e tij. Ju kisha lutur të na i jepni edhe neve ato kopje të punës, se edhe ne në Qeveri nganjëherë nuk e dëgjojmë çka po thotë ai. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Albin Kurti, replikë. Deputeti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Meqenëse po pajtohem, atëherë mos shkoni në negociata. Qëllimi i juaj është në mënyrë cinike, ironike të relativizoni polarizimin e thellë që ekziston këtu. Ju po mundoheni të krijoni disa ura në imagjinatën e deputetëve që të duket që të gjithë jemi në të njëjtën anë, po nuk jemi. Ne mendojmë që rruga e Kosovës për në Bashkim Evropian drejt Brukselit kalon nëpër Tiranë, me Shqipërinë, por ju në negociatat që po hyni, po doni ta orientoni Kosovën në shtegun që e çon drejt Brukselit nëpër mjet Beogradit dhe kjo është për shkak se shumë vende të Bashkimit Evropian pikërisht e kanë izoluar kryeministrin Thaçi nëpërmjet akuzave, nëpërmjet padive të ndryshme, nëpërmjet raporteve dhe kështu vetëm një deriçkë ia kanë lënë këtij për në skenën ndërkombëtare evropiane, e kjo është deriçka nëpërmjet Boris Tadiqit, prandaj edhe pati deklaruar që takimi me Boris Tadiqin është i shëndetshëm, nuk e di çfarë shëndetësie ka aty. Pra, atë deriçkë ia kanë lënë dhe në atë deriçkë po kalon. Le të shkojë, por jo me Kosovën, le të shkojë vet, pa neve. Organizoni referendum në Kosovë, urdhëroni pyetni popullin - a jeni për negociata me Serbinë dhe ju tregon populli! Ju e dini që s'kalon ai referendum, prandaj dëshironi që katër-pesë vetë të merreni vesh për një çështje që ka të bëjë edhe me brezat e ardhshëm. Thoni dialogu shqiptaro-serb për t'i ndrequr marrëdhëniet dhe për t'i pushuar armiqësitë e vjetra. Unë mendoj që kryeministri Thaçi nuk ka të drejtë të flas në emër të shqiptarëve. Nëse është çështja shqiptaro-serbe, prapë duhet të thirret Tirana. Ju që na e keni sjell këtë flamur, himnin pa tekst, flamurin me lara...

KRYETARI: Faleminderit, e harxhove kohën. Urdhëro, Hajredin Kuçi! Replikë, një minutë!

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Unë zotin Kurti e dëgjova me vëmendje dhe unë them kështu. Është e vërtetë që keni dilema dhe është e vërtetë që keni pasur dilema edhe më 2007 dhe unë ju kam dëgjuar me veshët e mi kur keni thënë që Kosova nuk do të jetë shtet, s'do të ketë ambasada, s'do të ketë këtë... Dhe unë nuk po them që nuk ke të drejtë të kesh dilema, por as ti nuk mund t'ia mohosh askujt të drejtën të ketë optimizëm pak më shumë në jetë. Nga ana tjetër, në emër të popullit, në demokraci flet ai që fiton shumicën e votave dhe kështu është bërë një proces

zgjedhor. Unë mendoj që kur të vjen koha edhe për referendum, votohen, kush t'i marrë votat më së shumti, unë do t'i shkoj prapa katër vite, kjo është demokracia. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Një minutë, Albin!

ALBIN KURTI: Është shumë e tmerrshme qysh po dëshironi të krijoni mentalitetin e teorisë së lojës, çka fitojmë, çka humbim. Nuk kemi fituar as në Vjenë, asnjë negociatë me konferenca shtypi, me bisedime, po këtu ka ardhur për shkak të gjakut të dëshmorëve, për shkak të atyre që nuk janë më. Ju nëpër negociata veç e keni zvogëluar atë, nuk e keni rritur. Neve pavarësia na ka takuar, po ju i keni dhënë 5 plus 1 komuna dhe 45 zona të veçanta. Nuk është teori e lojës kjo dhe mua nuk më qeshet, sepse mendoj që kjo është një punë shumë serioze, e mendoj që ju s'jeni serioz!

KRYETARI: Veç ju lutem, pak i zbutni gjakrat. Vazhdojmë! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Meqë e marr fjalën për herë të parë, e ndjej për detyrë që nga kjo foltore e nderuar të shpreh mirënjohjen time të thellë për qytetarët e Kosovës të cilët më dhanë besimin të jem pjesë e këtij Kuvendi. E vërteta e madhe e ne shqiptarëve është që pavarësisht se të ndarë, kemi udhëtuar së bashku gjatë gjithë historisë në momentet më të vështira, por edhe ato më të gëzuarat dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen, sepse ne jemi një.

Kosova edhe një herë tjetër po shkon drejt negociatave me Serbinë në rrethana krejtësisht të pafavorshme për të, si palë jo të barabarta dhe pas një procesi negociator, i cili u kurorëzua me pavarësi të kushtëzuar, ku Kosova pagoi një çmim të lartë duke bërë koncesione të shumta e të dhimbshme. Kosova sot ka ardhur në një pikë, ku pikërisht pakoja e Ahtisarit, e cila në vetvete është një dokument që ofron të drejta dhe privilegie për minoritetin serb si asnjë vend tjetër në botë, krejtësisht në kurriz dhe disfavor të shumicës që jeton këtu, të na duket si një gjendje pozitive që duhet ta ruajmë fort të mos na ikë edhe kjo, krahasuar me lëshimet e tjera që na presin. Kosova sot gjendet në një situatë ku rrezikon të rrëshqasë nga duart ajo që e ka ruajtur me sakrifica të mëdha nëpër dekada, e ky rrezik vjen nëpërmjet negociatave të reja që në fakt nuk janë edhe aq të reja, pasi kërkesa për to ka lindur menjëherë pas shpalljes së pavarësisë me presionin e vazhdueshëm të Serbisë në OKB dhe kjo kërkesë ka gjetur mbështetje tani edhe në Bruksel dhe është ky që merr përsipër procesin, i cili dihet se kur do të fillojë, por nuk dihet se kur do të mbarojë. Nuk dihet saktë as për çfarë formati është fjala, janë negociata, bisedime apo dialog.

Parimisht, unë nuk kam asgjë kundër negociatave, bisedimeve apo dialogut. Në fakt, janë këto mjete diplomatike që shërbejnë për të zgjidhur kriza e konflikte dhe historia ka dëshmuar efektin pozitiv të tyre. Edhe në rast se nuk i zgjidhin dot krizat, së paku mbajnë gjallë një lloj komunikimi mes palëve. Është gati aksiomatike se prosperiteti dhe fuqia e një shteti kurdoherë varet e kushtëzohet në fqinjët e tij. Në këtë kontekst nuk kemi pse të jemi as kundër bisedimeve me Serbinë në një të ardhme, mirëpo procesi aktual i cili po gatuhet, është mbështjellë nga një hipokrizi e madhe. Nëse dje i kërkohej shqiptarëve të Kosovës që të pranin pakon e Ahtisarit si çmim për pavarësinë, sot u kërkohej atyre të shkojnë në negociata të reja në emër të zgjidhjes përfundimtare të konfliktit shqiptaro - serb. Në pamje të parë, ky duket një argument sa joshës e vizionar, po aq edhe i pakundërshtueshëm, mirëpo në rrethanat aktuale, nuk është gjë tjetër, veç se një argument i paqëndrueshëm, dhe ja pse:

Së pari, konflikti shqiptaro-serb nuk mund të zgjidhet me vullnet të njëanshëm. Deri tani vetëm shqiptarët kanë dëshmuar vullnet pozitiv si për t'u afruar minoriteteve të drejta dhe privilegje, ashtu edhe për të ndarë hesapet me shtetin serb, ndërsa Serbia si para shpallje së pavarësisë, ashtu edhe pas saj, madje me intensitet të shtuar bën obstrukcione në të gjitha mënyrat e mundshme për ta zhbërë këtë pavarësi. Pra, ajo ka dëshmuar plotësisht vullnetin e kundërt nga ai që është i nevojshëm për të hyrë në bisedime. Së dyti, sepse ky konflikt është ekskluzivisht politik dhe territorial dhe nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave të ashtuquajtura për çështje teknike. Duhet ta bëjmë fare të qartë se asnjë, ama asnjë nga këto çështje nuk është teknike, të gjitha kanë bazë të fortë politike që buron nga koncepti i shtetit serb, i cili e konsideron Kosovën pjesë të tij. Së treti, sepse konflikti shqiptar-serb nuk mund të zgjidhet me negociata të cilat dihet se në thelb kanë filozofinë win-win, ose fito-fito, pra të dyja palët në fund duhet të fitojnë diçka. Pasi Kosova ka dhënë maksimumin e saj, madje ka shkuar përtej këtij maksimumi dhe çdo koncesion tjetër do të ishte cenim i territorialitetit dhe sovranitetit.

Së katërti, konflikti shqiptaro-serb nuk mund të zgjidhet pa respektuar standardet e njëjta me ato të serbëve të Kosovës edhe për shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre në Luginën e Preshevës.

Së pesti, nuk mund të zgjidhet ky konflikt shekullor me një proces i cili po fillon ekskluzivisht për interesa të Serbisë, e as nuk mund të zgjidhet nëpërmjet një procesi që po tentohet të zhvillohet vjedhurazi, pa debat dhe pa fije transparence për publikun, njëjtë siç ndodhi me planin Ahtisari. Krijimi i dyshimeve të njerëzit është prenotim i tensionit për të ardhmen.

Dhe, së fundi, ky konflikt nuk mund të zgjidhet nëpërmjet të pranimit të negociatave të pakushtëzuara, siç po bën sot Qeveria e Kosovës, pra të futesh në negociata pa asnjë kusht, është marrëzi.

Po ju jap vetëm një ide. Le ta kushtëzojë Qeveria e Kosovës Brukselin me pjesëmarrjen e saj në bisedime të cilat janë në interes të Serbisë, siç po e thonë të gjithë edhe këtu, me zhbërjen e strukturave paralele në veri dhe të shohim se çfarë do të ndodhë. Sido që të jetë, unë jam e bindur se nuk ka asnjë deputet këtu dhe asnjë qytetar i Kosovës që nuk e kupton se Serbia nuk do të pranonte kurrësi të merrte pjesë në këto negociata, sepse qëllimi i saj është krejtësisht i kundërt, pra është që të përforcojë strukturat paralele në veri, të vë në jetë planin gjashtë pikësh të Ban ki Munit, të cilin e dimë fare mirë se çfarë është dhe të shndërrojë veriun e Kosovës në një shtet brenda shtetit dhe të jeni të sigurt se kjo nuk është ambicia e fundit e Serbisë në Kosovë. E dimë të gjithë se cila është ambicia e fundit, pra ndarja e kësaj pjese të Kosovës.

Unë do të thosha se mospjesëmarrja në negociata, kundërshtimi, nuk do ta bënte Kosovën destruktive, palë destruktive apo të mbyllur, siç kanë shprehur frikën disa, por përkundrazi, do ta bënte palë serioze e cila kërkon të mbrojë me çdo kusht interesat themelore të shtetit. Çdo sjellje tjetër do të ishte donkishoteske dhe një dështim i garantuar të cilin historia nuk do t'ua falte atyre që kanë marrë përsipër të bëjnë rolin e kalorësit të zgjidhjes së konfliktit shqiptaro-serb. Prandaj, Lëvizja "Vetëvendosje" bën thirrje që të kundërshtohen këto negociata të cilat bëhen vetëm për beneficione të Serbisë dhe që i sjellin dëm Kosovës në shumë dimensione. Nuk ka asnjë arsye që Kuvendi i Kosovës, vetë Kosova, Qeveria e Kosovës t'ia shtrojë tepihun e kuq Serbisë për në BE. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë ka kërkuar pak më herët Sabriu.

SABRI HAMITI: Emër s'është përmendur, por është përmendur qëndrimi. Kemi pasur një komentim të qëndrimit të partisë politike dhe është e domosdoshme që të shfrytëzohet, të sqarohen çështjet.

Është problem kaq i madh për Kosovën kjo që po na pret, që bile është qesharake të shpjegohet si pozicionim pozitë-opozitë, aq më tepër në kuptimin e njëfarë tipi artikulimi të programeve politike. Ky është problem përtej një brezi, është problem përtej përpjesëtimeve politike që momentalisht janë në këtë Parlament. Unë kështu e shoh këtë çështje, edhe dikur, edhe sot.

Këtu ka pretendime shumë. Unë veç po them që duhet të bëhemi pak më realë, sepse Kosova e tillë çfarë është sot, as s'ka kredi, as s'ka fuqi për ta zgjidhur problemin historik, problemin shqiptaro-serb. Ky është pretendim i madh. Qejf ndoshta kemi për ta zgjidhur, por as s'kemi kredi, as fuqi. Po flas për Kosovën. Problemi shqiptaro-serb është përtej Kosove.

E dyta, është mirë që të sillemi në mënyrë kushtetuese, që i bie: Qeveria e kryen punën e vet për çka është mandatar, Kuvendi e kryen punën e vet ta kontrollojë Qeverinë, të japë alternativa dhe të korrigjojë në finale dhe të rekomandojë e të kërkojë llogari dhe, pika e fundit, që e përmend "Vetëvendosja" me gojën e Albin Kurtit, ka të drejtë – nëse ky Kuvend s'është i zoti t'i marrë detyrimet kushtetuese, ta ruajë substancën e qëndrueshmërisë për aspektet fundamentale politike të Kosovës sot e nesër, atëherë shkohet në referendum dhe kërkohet një votë edhe më substanciale – që është vota popullore. Kaq, faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në diskutimin për negociatat me Serbinë unë sot do të ndërlidhem nëpërmes tri komunave shqiptare që vazhdojnë të jenë nën pushtimin e shtetit të Serbisë: Medvegjës, Bujanovcit dhe Preshevës, për ata shqiptarë që sot vazhdojnë të vuajnë nën terrorin e shtetit serb, me të cilin u dashka të negociojmë. Ata po përjetojnë terror atje, ndërsa këtu edhe debatohet me lehtësi tek ... i negociatave. Lehtësia e debatit për negociatat ka për bazë edhe faktin se kur po flitet për Serbinë në raport me ne, disi po lihet një përshtypje që Millosheviqi i cili shkoi dhe nuk është më, bashkë me të shkoi edhe e keqja.

Shteti i Serbisë në tërë historikun e tij ndaj shqiptarëve nuk e pati as edhe një ditë të vetme miqësore, as edhe një ditë të vetme pushim në pengimin e lirisë sonë. E shkuara jonë me ta ishte e hidhur dhe nuk bën të mos përmendet. Janë 700 fshatra që u lanë të zbrazëta prej nga u dëbuan shqiptarët nga Serbia më 1878, të cilët janë lënë në harresë.

Është përgjysmimi i shqiptarëve më 1912 nga terrori i paparë ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Rrëqethëse janë përshkrimet e politikanit serb, Dimitrije Tucoviq, kur e përshkruan ai terrorin e shtetit serb me rastin e pushtimit të Kosovës nga Serbia, pra terrorin ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, në vitin 1912-1913.

Pastaj, dëbimi sistematik nën terror i popullatës së mbetur, marrja e pronave, kolonizimi i përgjakshëm i Kosovës. Sot në Turqi jetojnë shqiptarët në varfëri, pronat e të cilëve janë marrë dikur në Kosovë nga shteti serb dhe i janë dhënë kolonëve të ardhur nga Serbia.

Më pas terrori nën pushtimin jugosllav, dëbimet tjera për Turqi, burgosjet, torturat e shumta, të gjitha këto të përkujtojnë se asnjë pushtet që ishte në Serbi, nuk dallonte nga tjetri kur bëhej fjalë për shqiptarët. Po ky i sotmi, vallë, çfarë na qenka? Diç më i mirë, që ndoshta do të mund të kuptoheshim me ta, që do të mund të thoshte dikush. Shikoni, shkoni dhe shihni shqiptarët në Medvegjë, Bujanovc dhe Preshevë se si jetojnë, shiheni të ashtuquajturën xhandarmëri se si bredh e armatosur rrugëve dhe bën terror, shkoni dhe përjetoni mëngjeset në ato familje që terrorizohen në bastisjet për gjoja kërkim të armëve. Pyetni shqiptarët që ikin prej andej çdo ditë e më tepër se çka po lënë prapa. Njëjtë si në kohën e pushtimit serb në Kosovë, e atë e dimë dhe e kemi përjetuar po thuaj të gjithë. Negociatorët tanë mund ta kenë harruar këtë, apo ndoshta edhe dikush nga ta nuk e ka përjetuar fare, se mund të mos ketë qenë këtu kur ka ndodhur. Pra, atje bëhet jetë e padurueshme. Po kjo jetë e padurueshme bëhej edhe gjatë negociatave të kaluara, kur negociatorët ishin në Vjenë dhe negocionin me Serbinë. Premtuan që do të jenë avokatë, si thoshin ata, të Luginës, por atje as gojën nuk e hapën për Luginën. Atëherë ndërmjet gotave me verë jepeshin komunat, komunat ku sot me mbishkrime me çirilicë nuk figuron Republika e Kosovës dhe ku si shqiptar po kalove, mund të të zënë pritë dhe të të vrasin, ashtu siç ndodhi dje, në prezencë të babait të tij u vra djaloshi 14 vjeçar shqiptar, Leutrim Musliu, në fshatin Pasjan të komunës së Parteshit.

Në Vjenë u bënë lëshime, e Serbia nuk na njohu. Edhe ne sot implementojmë ato lëshime dhe ata kërkojnë prapë lëshime të reja, duke mos na njohur. Kjo do të shkojë në pafund, derisa të humbë e tërë përmbajtja e pakët e shtetit. Sado gjeneroze që do të tregohet Qeveria e Kosovës në negociata, serbët në veri e kudo tjetër kurrë nuk do të besojnë që privilegjet që i fituan janë si rezultat i gjenezitetit të Qeverisë së Kosovës, por i këmbëngulësisë dhe i dhunës së vetë atyre. Në negociata u harruan shqiptarët nën pushtimin e Serbisë, u harrua kontributi i tyre edhe për këtë gjysmë liri që kemi në luftën dhe në ndërtimin e shoqërisë deri më sot. Sot në tri komunat e banuara me shqiptarë, e që vazhdojnë të jenë nën pushtimin serb, ka terror ndaj shqiptarëve, ka dëbim sistematik, ka zbrazje nga shqiptarët. Grupi që u arrestua dy vite më parë, u dënua me 101 vite burg. I tërë procesi ishte një spektakël terrori, i shoqëruar me kërcënimin që do të vazhdonin me arrestimet, ndërkohë që bastisjet nuk kishin të ndalur, e tërë kjo me qëllim të frikësimit të popullatës që të lëshojnë vatrat e tyre. Në vend që të ndodhë demilitarizimi atje, kjo zonë është militarizuar skajshmërisht, e kësaj duhet t'i shtojmë edhe bazën ushtarake që po ndërtohet në afërsi të Bujanovcit. Në institucione shqiptarët janë të diskriminuar. Në gjykatë në Preshevë shqiptarët janë të përfaqësuar vetëm me 1/3, ndërsa në Bujanovc e Medvegjë mos të flasim, është gjendje tejet edhe më e rëndë. Në këto tri komuna, vetëm 34% të policëve janë shqiptarë, edhe ashtu në këtë përqindje kjo polici nuk ka fare kompetenca, pasi janë nën kontrollin e të ashtuquajturës xhandarmëri. Shteti i Serbisë ua mohon shqiptarëve përdorimin e simboleve kombëtare, pastaj mosnjohja e diplomave të Universitetit të Prishtinës ka bërë që të gjithë të diplomuarit të mbeten në Kosovë, pasi atje nuk mund të gjejnë ndonjë perspektivë. Popullata e këtyre tri komunave po varfërohet çdo ditë pasi këto tri komuna janë të diskriminuara edhe në investimet nga shteti, ato janë të lëna plotësisht pas dore nga të gjithë.

Në bazë të platformës politike të vitit 2006, të miratuar nga këshilltarët komunalë të tri komunave, shqiptarët atje kërkojnë reciprocitet të të drejtave, e nëse ndryshojnë kufijtë, atëherë bashkim me Kosovën, kërkesë kjo që është në përputhje edhe me referendumin e mbajtur në vitin 1992. Serbia nuk ka dhënë as edhe një shenjë përmirësimi në raport me shqiptarët. Ajo sillet si çdo herë, e edhe tani kur negociatat për të cilat ka nevojë, i kërkon sipas mënyrës së saj të vjetër, çka është e imja,

është e imja, kurse çka është e jotja, është e diskutueshme. Me Serbinë nuk duhet negociuar para se ajo të ndryshojë qëndrimin politik antishqiptar. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Unë ju falënderoj për debatin që është zhvilluar sot në këtë sallë, edhe pse mendoj që kemi pak të ngarkuar me paragjykime. Unë e kuptoj që raportet në mes Kosovës dhe Serbisë në asnjë fazë nuk kanë qenë të mira, ato edhe tani nuk janë të mira, nuk do të jenë të mira, si duket, edhe për shumë kohë, por kjo nuk do të duhet të merrej si vazhdim i negociatave, pasi unë jam i bindur që negociatat në mes Kosovës dhe Serbisë kanë përfunduar në Vjenë, është nxjerrë një dokument ndërkombëtar që i ka hapur rrugë shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe më 17 shkurt 2008, po në këtë sallë, ndoshta jo në këtë përbërje të deputetëve, por një pjesë e mirë e tyre kanë qenë, është shpallur Kosova shtet i pavarur, sovran e demokratik.

Pas kësaj, e sidomos edhe pas opinionit pozitiv të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për arsyeshmërinë e shpalljes së shtetit të pavarur sovran nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës, e sidomos pas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme, e cila në një formë ose tjetër jep kornizat se për çka duhet të bisedohet ose të dialogohet në mes përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë, realisht tonet e diskutimit nuk do të merrnin, nuk do të duhej të merrnin formën e studiuesve të historisë, se konsiderojmë që ne si përfaqësues të popullit këtu nuk jemi ardhur ta studiojmë historinë. Si përfaqësues të popullit këtu kemi ardhur në rend të parë të qeverisim vendin dhe të ndryshojmë kualitetin e qeverisjes dhe të kualitetit të jetës së qytetarëve. Ky është obligimi jonë parësor, edhe si Kuvend, edhe si Qeveri, edhe në përgjithësi si institucione.

Unë nuk i paragjykoj bisedimet që do të zhvillohen në mes të Kosovës dhe Serbisë, edhe pse unë nuk jam i bindur se këto bisedime po zhvillohen në mes Kosovës dhe Serbisë, por po më duket në një masë të madhe janë duke u zhvilluar në mes Brukselit dhe Beogradit. Megjithatë, ne si vend i ri, si institucione të reja nuk kemi të drejtë dhe as mundësi t'ia bëjmë politikën Brukselit se çka ai, në cilën kohë do t'i ofrojë Serbisë ose do t'ia shkurtojë Serbisë rrugën e integritit në Bashkimin Evropian. Ndoshta debati i sotshëm nuk është në masën e duhur i përgatitur, por megjithatë konsideroj që dy tekstet e rezolutave dhe pjesa e dytë e diskutimit të kryeministrit, sidomos ato vijat e kuqe për çka delegacioni i Kosovës nuk do të duhej të bisedonte, janë një bazë e mirë për t'u nxjerrë një dokument i rëndësishëm, dokument i cili kornizon sigurisht më shumë se çka Kosova nuk do të duhej të bisedonte në këto biseda e jo aq shumë çka do të duhej të bisedonte. Unë nuk pajtohem as me ata që thanë se për çështjen e dokumentacioneve të ndryshme ne nuk duhet të bisedojmë, por duhet të kushtëzojmë. Unë mendoj se këtyre bisedimeve nuk duhet t'i japim konotacion politik, se nuk janë politike. Kosova tanimë është shtet i pavarur dhe sovran. Vetëm ne nëse dyshojmë se Kosova nuk është shtet i pavarur dhe sovran, ne atëherë mund vërtetë t'i krijojmë ato paragjykimet që i kemi krijuar, prandaj ne duhet të kërkojmë sigurisht nga Brukseli një qartësim më të mirë të politikave që Brukseli ka ndaj Kosovës, ndaj shtetit më të ri në Evropë dhe ky qartësim deri më tani nuk është në nivelin e duhur. Ne duhet të kërkojmë nga Brukseli që politikat e Bashkimit Evropian, të gjitha vendet e Bashkimit Evropian të jenë të unifikuara ose të jetë e unifikuar dhe jo të kemi 22 vende të Bashkimit Evropian që kanë njohur

Kosovën dhe 5 vende që vazhdojnë mos ta njohin Kosovën. Do të thotë, realisht ne jemi pak mbrapa, por situata ne kishim në institucionin në detyrë, përndryshe Brukselit është dashur t'i bëhet e qartë, Brukseli në rend të parë ka probleme me vetveten dhe duhet ta unifikojë politikën e vet ndaj çështjes së Kosovës dhe duhet ta unifikojë politikën e vet ndaj çështjes edhe të Serbisë. Dhe, në këtë rrafsh, ne nuk e shohim se Brukseli e ka unifikuar politikën e vet në këtë raport dhe e ka shumë vështirë Brukseli të jetë një limitues ose lehtësues i këtyre bisedimeve pa një politikë të unifikuar.

Mua më duket që edhe një pikë e rezolutës që e ka afruar Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është domethënëse dhe mendoj se duhet t'i qëndrojmë të gjithë pranë kësaj. Agjenda e dialogut duhet të përfshijë vetëm çështjet teknike të interesit të përbashkët dhe unë mendoj që qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e Serbisë kanë interesa të përbashkët dhe këto çështje janë për t'u lehtësuar jeta e tyre, edhe e qytetarëve të Kosovës lindore, edhe të asaj pjese veriore të Kosovës. Pastaj, vazhdojmë, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, mendoj se edhe kjo është një çështje. Për çështjen e sovranitetin ne nuk mund të bisedojmë as me Serbinë dhe as me asnjë tjetër, për integritetin territorial të saj dhe rregullimin e brendshëm të Kosovës. Mendoj se ndoshta kjo është pika më e rëndësishme ose pjesa më e rëndësishme e kësaj pike, që në këto bisedime nuk mund të jetë temë e bisedimeve as teknike, as politike se, në fund të fundit, nëse futet kjo si temë e bisedimeve, atëherë do të jetë politike. Pra, rregullimi i brendshëm i Kosovës është i rregulluar me Kushtetutën që është në fuqi dhe për këto çështje mendoj dhe çështjet të tjera ne duhet t'ia bëjmë të qartë edhe vetvetes, duhet t'ia bëjmë të qartë edhe Brukselit, se besoj Beogradi e ka të qartë për çka ne nuk do të negociojmë, as s'bisedojmë, as s'dialogojmë, por për çështjet nëse Serbia është e gatshme, fundi i fundit, unë s'jam prej atyre që me çdo kusht për të biseduar me Serbinë, e kërkoj njohjen e saj. Ajo është çështje e Serbisë dhe ajo le ta vazhdojë të mos e njohë Kosovën, por për neve Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe kjo nuk ka kthim prapa. Mendoj që edhe dokumentet ndërkombëtar e kanë sanksionuar këtë, kësaj s'kemi çka i frikësohemi, prandaj ne si Kuvend, unë nuk kam qenë ithtar që me bisedimet teknike, të ashtuquajtura teknike, të merret Kuvendi i Kosovës, gjithnjë duke qenë i bindur se çështja politike në Kuvendin e Kosovës është mbyllur më 17 shkurt 2008, por pasi ishte shumica e mendimit se edhe këto çështje, pasi që gjithçka që bisedojmë me Serbinë është çështje politike, atëherë është mirë që po bisedojmë. Por, ky Kuvend duhet ta nxjerrë një dokument, jo aq shumë për çka duhet të bisedohet, por një dokument i cili vijëzon qartë çështjet të cilat delegacioni i Kosovës në këto bisedime nuk guxon dhe s'ka të drejtën të bisedojë, se atë mandat nuk ia ka dhënë qytetari i Kosovës dhe, në fund të fundit, atë mandat nuk po ia jep as ky Kuvend i Kosovës, as përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës në këtë Kuvend. Dhe mendoj që kështu jemi mirë me vetveten, komunitetit ndërkombëtar i themi - jemi të gatshëm të bisedojmë, por problemi kryesor i mbetur në Kosovë, në pjesën veriore të Kosovës nuk është faji ynë, nuk është faji i institucioneve të Kosovës, nuk është faji i politikës së Kosovës, por është papërgjegjësi që 12 vjet me radhë komuniteti ndërkombëtar nuk e ka kryer detyrën e vet për të cilën ka ardhur edhe me Rezolutën 1244, e mos të flasim pastaj me dokumentin gjithëpërfshirës të presidentit të Ahtisarit dhe, në fund të fundit, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dokument kështu siç është, është një dokument që është arritur në koordinim të plotë me komunitetin ndërkombëtar. Dhe, pasi është kështu, ne do ta mbrojmë këtë Kushtetutë që e kemi, këtë hapësirë territoriale që e kemi, këtë ndarje territoriale që e kemi tani dhe për neve çdo gjë tjetër është e papranueshme dhe si Kuvend nuk mund ta pranojmë. Mendoj që kështu ne e kryejmë një obligim, Qeverisë apo delegacionit që formohet, që mund të jetë edhe nga pozita edhe nga opozita, i tregojmë qartë çka mund të bisedojë dhe çka nuk duhet të bisedojë. Mendoj që ky është obligimi ynë si institucion përfaqësues, si institucion legjislativ, si institucion, në fund të fundit, mbikëqyrës dhe kontrollues. Ne pastaj duhet të kërkojmë me dokumentin që do

ta nxjerrim, për çdo fazë të bisedimeve ky delegacion ose ky trup që do të bisedojë, që ndoshta edhe unë jam i mendimit që nuk është dashur ta ketë këtë nivel që e ka, po tani veç është thënë ajo, edhe pse dikush ka dëshiruar ta ketë këtë përbërje edhe këtë sigurisht në një formë ose tjetër të gjithë e dimë, duhet t'i raportojë këtij Kuvendi dhe pastaj ta marrë miratimin në këtë Kuvend. Unë mendoj që debati ishte i rëndësishëm, konsideroj që në shumë pika ishim të përbashkët por, në fund të fundit, ne edhe në këtë fazën që jemi, duhet të jemi në koordinim edhe me faktorin ndërkombëtar se, në fund të fundit, edhe ata na kanë ndihmuar për të ardhur këtu ku jemi, por gjithnjë duke bërë të qartë se çka është e pranueshme dhe çka nuk është e pranueshme për Kosovën, për institucionet e saj dhe për qytetarët e Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYESUSI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Sistemi i drejtësisë në Kosovë dhe ai gjyqësor brenda tij, është sinonim i laramanisë së ligjeve të përbëra nga ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit, e cila qëndron përmbi Kushtetutën e Kosovës, nga rregulloret e UNMIK-ut që rrjedhin nga Rezoluta 1244 dhe nga ligjet e Serbisë me të cilat sundohet në veri.

Qeveria dhe institucionet e vendit në vend që të krijojnë dhe unifikojnë një sistem të drejtësisë, i cili reflekton vullnetin e shumicës së qytetarëve të saj dhe që është i bazuar në parime të barazisë para ligjit për të gjithë, pa përjashtim, me këto negociata ato vetëm sa do t'i japin shtytje qarjes së sistemit të drejtësisë duke shkuar drejt legjitimitetit të një sistemi paralel të krijuar dhe i kontrolluar nga Serbia.

Që pas shpalljes së pavarësisë, edhe ajo pak prezencë e autoriteteve të drejtësisë në veri të vendit u dëbua dhunshëm nga strukturat paralele të Serbisë në shkurt të vitit 2008 dhe që nga ajo kohë Serbia çdo ditë e më shumë e ka shtrirë dhe konsoliduar pushtetin e saj në veri, duke rritur numrin e policëve si brenda Policisë së Kosovës, ashtu edhe përmes prezencës së njërive të MUP-it serb, po ashtu edhe përmes emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve serbë në gjykatat paralele në veri të vendit, struktura këto të cilat kanë bashkëpunim me EULEX-in dhe me mbetjen e administratës së UNMIK-ut aty.

Institucionet e vendit deri më tani nuk kanë pasur vullnet e as interes ta shtrijnë autoritetin e pushtetit të institucioneve të tyre dhe të ligjeve të veta në enklavat serbe, sepse ato janë ndaluar nga EULEX-i, duke i inkurajuar kështu strukturat e Serbisë që të shkelin integritetin e juridiksionit të Kosovës, si dhe duke trimëruar strukturat paralele që të luftojnë çfarëdo pranie të institucioneve të vendit në komunat e banuara me serbë, veçanërisht në veri të vendit.

Strukturat paralele janë institucionet e pushtetit të Serbisë të cilat funksionojë brenda territorit të Kosovës në formën e strukturave politike të sigurisë, të shërbimeve publike dhe si strukturë administrative të cilat, duke u mbajtur gjallë nga Serbia, e mbajnë Serbinë gjallë në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Plani i Ahtisarit ishte kompromis pas negociatave dhe tani po shihet se ai ishte kompromis drejt negociatave të reja që janë vazhdim i realizimit të gjashtë pikësh të Ban ki Munit, që në fakt janë gjashtë pika të Serbisë përmes të cilave synohet ndarja e brendshme e Kosovës. Nëse këto negociata do të ndodhin, ato do të sjellin pasojë krijimin e dy sistemeve politike, një të Kosovës

dhe atë të Serbisë në çerekun e territorit tonë. Nuk duhet të harrojmë krimet dhe masakrat e kryera gjatë luftës nga forcat serbe, po ashtu nuk duhet të harrojmë se vetëm me 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000 nga strukturat kriminale serbe 11 shqiptarë janë vrarë, me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar dhe lënduar, ndërsa 1.564 familje me 11.364 anëtarë janë dëbuar dhe për më tepër 16 kriminelë serbë kanë ikur nga burgu i Mitrovicës, edhe sot e kësaj dite ata janë të lirë bashkë me qindra e qindra kriminelë tjerë.

Ende i kemi të freskëta në kujtesën tonë deklaratat e Hashim Thaçit se Qeveria do t'u japë fund strukturave paralele serbe. Sot më shumë se kurrë po duket se këto deklarata janë të vërteta, sepse përmes këtyre negociatave ai do t'i legalizojë këto struktura.

Dua t'ia bëj me dije, po ashtu, Hashim Thaçit dhe Qeverisë së tij vetëm disa nga veprimet ligjore që është i obliguar t'i marrë për të mbrojtur ligjin dhe rendin në veri të vendit: ngritja e akuzave dhe arrestimi i strukturave ilegale serbe të sigurisë, shuarja e gjykatave serbe paralele dhe kthimi në funksion i këtyre gjykatave sipas sistemit gjyqësor të Kosovës, arrestimi i të gjithë atyre që janë në krye të krimeve etnike në veri, ndërprerja e financimit të strukturave paralele të Serbisë, përjashtimi nga policia e Kosovës dhe marrja e masave ligjore ndaj të gjithë atyre policëve që janë pjesëtarë të MUP-it serb. Këto hapa i duhen shtetit të Kosovës dhe jo negociatat me Serbinë, mirëpo mosndërmarrja e këtyre veprimeve nga ana e Qeverisë dhe Hashim Thaçit nuk më befason aspak sepse ai është bash ai që bashkë me shumë shokë të tij që janë këtu në Kuvend, përveç se hoqën dorë nga lufta e UÇK-ës, ata përmes kompromiseve të vazhdueshme hoqën dorë edhe nga jetësimi i amanetit të dëshmorëve dhe nga vullneti i popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zëvendëskryeministrja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë përshëndes debatin e sotëm i cili, në fakt, dha mundësinë që të shfaqen pikëpamje prej më të ndryshmeve lidhur me temën në fjalë, pra dialogun midis dy shteteve të pavarura, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për çështje praktike. Natyrisht, po Kosova si shtet i ri të kishte nevojë të dialogojë me Maqedoninë apo Malin e Zi, s'po them Shqipërinë, se nuk besoj se duhet të dialogojë me Shqipërinë, i kemi punët mirë, atëherë ndoshta nuk do të duhej të diskutohej këtu. Vetë fakti që është fjala për Serbinë, shqetësimet janë të bazuara edhe insistimet janë të bazuara dhe sidomos janë legjitime lidhmëria e dialogut me përkrahjen e Parlamentit, me mbështetjen e një rezolute që është një kornizë e parimeve për atë se çka mund të flitet dhe çka nuk mund të flitet, për atë se prej çfarë pozicioni po shkojmë në bisedime, pse janë të rëndësishme, çfarë është roli i ndërkombëtarëve dhe cilat janë objektivat.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar madje nga Parlamenti, jo tash, në shtator ka kërkuar që të iniciohet kjo rezolutë. Kjo tregon se ne do të vendosim për këtë dialog të gjithë së bashku, gjithë institucionet, i gjithë spektri politik po edhe shoqëria civile. Pse kështu? Sepse ne kemi kaluar një histori shumë të rëndë, shpesh në të kaluarën kemi pasur situata jo të mira dhe legjitimiteti i brendshëm, uniteti i brendshëm është një prej atyre forcave që neve na ka bërë të suksesshëm dhe ka për të na bërë të suksesshëm edhe tash.

Dikush në fjalim e tha – dy herë kanë dështuar bisedimet. Unë them se jo. Ne dy herë kemi dalë suksesshëm në bisedime. Edhe në Rambuje kemi dalë suksesshëm, sepse ne pranuan marrëveshjen e Rambujesë dhe forcuam aleancën me aleatët tanë në krye me SHBA. Serbia u bombardua, ne u çliruam. Në vijim, po ashtu së bashku me aleatët SHBA dhe Evropën pranuan planin e Ahtisarit me shumë kompromise, por të gjithë e pranuan, madje edhe ky Parlament e ka miratuar dhe ne e dimë çka kemi miratuar. Përsëri, me gjithë ato kompromise, ne dolëm fitues. Ne e fituam pavarësinë, Serbia dështoi. Çka është pavarësia e sotme? Jo vetëm që është një arritje historike për shkak se e kemi deklaruar pavarësinë, kemi Kushtetutën e pavarësisë, kemi 75 njohje kualitative, kemi konfirmimin e Gjykatës Ndërkombëtare për drejtësi se Deklarata e pavarësisë ishte legale dhe tani pozicioni ynë është krejt i qartë dhe ky dialog, prandaj quhet dialog dhe jo negociata. Pra, është fjala për dialogun midis dy shteteve të barabarta, të pavarura, pavarësisht çka mendon dhe mund të mendojë pala tjetër, se kam dëgjuar deklarata të ndryshme prej tyre. Mirëpo, ajo çka mund të mendojë Serbia, është çështje e tyre. Është me rëndësi çfarë është platforma jonë, dhe mund të ju them se platforma jonë dhe arsyeja pse unë me kënaqësi e kam pranuar këtë detyrë nga kryeministri Hashim Thaçi, ka qenë sepse platforma është e qartë dhe vijat e kuqe janë të qarta. Po shkojmë për të biseduar për çështjet praktike dhe këto çështje praktike nuk janë të panjohura. Të gjithë ata që kanë punuar nëpër institucione dhe të gjithë ata që e kanë përcjellë politikën mirë, e dinë se cilat janë çështjet praktike që janë grumbulluar tash dhjetë vjet. Madje, madje nuk pati nevojë as kryeministri për t'i paraqitur çështjet praktike, sepse në debate veç ato dolën, që tregon se ekzistojnë realisht dhe për të cilat duhet biseduar dhe gjetur zgjidhje. Mirëpo, vijat e kuqe janë të qarta. Pavarësia, sovraniteti, integriteti territorial, unitariteti i Kosovës – janë vlerat e Kushtetutës së Kosovës dhe s'ka kush i cenon ato.

Pastaj, u përmend, pse po shkojmë në nivel kaq të lartë, pse në nivel politik. Asnjërit nuk iu kujtua për të thënë, a thua vallë po shkojmë në nivel politik për t'i penguar tendencat politike të Serbisë për t'i qitur në tavolinë. Këtë nuk e tha asnjëri, sepse ju më së pari më njihni mua. Unë jam 20 vjet në politikë, 20 vjet kam luftuar për pavarësinë e Kosovës. Po, a mendoni se mund të shkojë në Bruksel për diçka tjetër përveçse për ta përforcuar pavarësinë, por edhe për ta forcuar aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian, për t'ia forcuar perspektivën Kosovës atje dhe sigurisht pse jo – për të biseduar me një shtet fqinj, sepse normale është pas konflikteve, kur ndodhin luftërat, pas luftërave fillojnë edhe bisedimet.

Më lejoni të përmend dy raste eklatante. Franca dhe Gjermania kanë qenë shtete armike, të gjithë e dimë. Sot janë shtete fqinje dhe aleate. Kroacia dhe Sllovenia kanë qenë shtete mike, 11 vjet kanë negociuar një pjesë të kufirit. Prandaj, edhe Kosova si shtet i ri, ka obligim për t'u marrë me këto çështje, por është me rëndësi që ne si shtet i ri por me njerëz të fuqishëm dhe me Qeveri të fuqishme do të jemi në gjendje t'i përballojmë sfidat. Unë isha në SHBA, së bashku me ministrin e Jashtëm, zotin Enver Hoxha. Takova zyrtarët më të lartë, përfshirë edhe zëvendëssekretarin e Shtetit Steinberg. Më lejoni të transmetoj qëndrimin amerikan për këtë dialog. Qëndrimi amerikan është që Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe kjo është çështje e mbyllur. SHBA mbështesin një dialog për çështjet praktike, por të njëjtin e mbështetin edhe vendet aleate evropiane. Ne e dimë se 5 shtete nuk na kanë njohur, por shumica e shteteve të Bashkimit Evropian e kanë njohur Kosovën dhe nëse e lexoni Deklaratën e muajit shkurt të Grupit drejtues ndërkombëtar për Kosovën, të përbërë nga 27 shtete evropiane, përfshirë edhe SHBA, në pikën 6 thuhet kështu: “Grupi ndërkombëtar drejtues për Kosovën mbështet dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovranë për çështje praktike”.

Prandaj, unë në fund mund të ju them se, siç e tha edhe Hydajeti, s'duhet të frikohemi për të biseduar, për të dialoguar. Unë them se po e marr me përgjegjësi këtë punë, i di vijat e kuqe, do të bisedojmë për çështje teknike dhe Parlamenti është ai që do të miratojë të gjitha ato arritje, në qoftë se arrihet marrëveshje të caktuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: I nderuar kryesues i Kuvendit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,

Është e rëndësishme që sot po debatohet në Kuvendin e Kosovës, në organin më të lartë vendimmarrës lidhur me bisedimet Kosovë – Serbi. Gjithashtu, është e rëndësishme që nga diskutimet të vendosen kornizat se çfarë do të bisedohet, çfarë nuk do të bisedohet, por edhe çfarë do të përfitojë Kosova nga këto bisedime, edhe pse çfarë duhet të bisedohet dhe çfarë nuk duhet të bisedohet, veç u thanë, dhe cilat janë përfitimet për Kosovën, edhe këto u thanë.

Në shumë raste problemet e ndryshme kanë arritur dhe arrijnë t'i afrohen zgjidhjes apo edhe të zgjidhen vetëm përmes bisedimeve. E dimë se në botë janë zhvilluar dhe ende zhvillohen shumë luftëra e mbase do të zhvillohen edhe në të ardhmen dhe, po ashtu, e dimë se pas përfundimit të luftërave janë zhvilluar dhe do të zhvillohen bisedime, dialogime, negociata e tjera për zgjidhjen e problemeve të ndryshme për të cilat janë bërë luftërat, por që nuk janë zgjidhur vetëm me luftë.

Si duket, në shumicën e rasteve këto procese janë të pashmangshme. Edhe Kosova pashmangshëm ka kaluar nëpër këto procese të negociatave, dialogimit dhe bisedimeve si gjatë kohës së luftës për të vazhduar edhe pas përfundimit të luftës. Gjatë kohës së luftës në Kosovë me shumë skepticizëm dhe mosbesim është shikuar iniciativa e bashkësisë ndërkombëtare për shkuarjen në Rambuje të Delegacionit të Kosovës për bisedime me Serbinë. Shumë dilema ka pasur se a duhet të pranohet të shkohet në këto bisedime apo jo. A duhet të bisedohet se pas këtyre bisedimeve do të përfitojë Kosova apo jo? Të gjitha këto dilema u larguan pas ngjarjeve të cilat rrodhën pas përfundimit të këtyre bisedimeve, sepse rezultati ishte në favor të Kosovës dhe sot jemi këtu ku jemi. Me një fjalë, negociatat, dialogimet dhe bisedimet në asnjë rast nuk mund të paragjykojnë apriori si të dëmshme dhe të padobishme, pa u ditur qëllimi, çështjet dhe agjenda e këtij procesi, sepse vetëm pasi t'i kemi të njohura qëllimet, çështjet dhe agjendën e procesit, mund të themi se procesi mund të jetë i këfillë apo i atillë.

Mendoj se zgjidhja e problemeve jo të pakta dhe jo të parëndësishme që kanë mbetur pa u zgjidhur në mes Kosovës dhe Serbisë, pas përfundimit të luftës duhet dhe mund të zgjidhen nëpërmjet procesit të bisedimeve. Prandaj, mendoj se nuk duhet që apriori të refuzohen bisedimet, por mendoj se është e domosdoshme që kornizat e bisedimeve duhet t'i caktojmë ne përmes një dokumenti, ku duhet të përcaktohen qartë çështjet për të cilat do të bisedohet dhe agjendën e qartë të bisedimeve, por edhe për përfitimet që do t'i ketë Kosova nga ky proces, si liberalizimin e vizave, siç u tha, marrëveshjen e stabilizim-asocimit e tjera.

Dhe, së fundi, ky dokument duhet të dalë nga të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës në organin më të lartë legjislativ të vendit, në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mendoj se në mesin e çështjeve për të cilat mund dhe duhet të bisedohet janë edhe zbardhja e fatit të zhdukurve gjatë luftës, kthimi i dokumentacionit të gjendjes civile dhe të atij kadastral, çështjet e telekomunikacionit, të fondit të pensioneve e tjera, të gjitha këto çështje të cilat i ngritën edhe

disa prej deputetëve. Kurse çështjet për të cilat nuk duhet të pranohet asnjëherë të bisedohet janë çështjet të cilat e prekin sovranitetin, integritetin territorial dhe interesin nacional të vendit.

Dhe, në fund, krejt fare, desha ta them mendimin tim lidhur me çështjen e kohës së përshtatshme apo të papërshtatshme për bisedime. Unë mendoj se për ata që e dinë se çka duan nga një proces, nuk ka kohë të papërshtatshme për të arritur atë që duhen, kurse për ata që nuk e dinë se çka duan, nuk ka asnjëherë kohë të përshtatshme për një proces çfarëdo qoftë ai. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit! Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Tashmë ashtu siç u tha, Kosova po hyn pa vullnetin e qytetarëve të saj në një proces të ri negociator me Serbinë. Hyrja e Kosovës në kuadër të kësaj odiseade të re, siç po thuhet, të bisedimeve teknike, por që në të vërtetë janë negociata fundamentalist politike, bart një sërë anomalish për të ardhmen politike, juridike dhe funksionale të Kosovës. Këto negociata i konsiderojmë të dëmshme politikisht për shkak të disfunksionalitetit që ato prodhojnë, të rrezikshme juridikisht për shkak të efekteve që ato do të kenë sa i përket rendit juridik, duke promovuar status special për entitetet e veçanta administrative sipas linjave etnike, kryesisht për serbët e veriut, si dhe të papranueshme moralisht për shkak të mënyrës se si zhvillohen dhe për disa nga temat për të cilat negociohen.

Të nderuar deputetë,

Zërat plot deklamacion të zyrtarëve qeveritar që janë shtuar kohëve të fundit në lidhje me këto negociata thonë se ato janë realizim i agjendës shtetërore dhe si të tilla synojnë që më në fund ta zgjidhin konfliktin shqiptaro-serb, si dhe të përfundojnë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve, por në të vërtetë këto negociata i kanë premisat e tyre pikërisht diku tjetër, në dështimin politik, administrativ dhe institucional të strukturave qeverisëse të Kosovës, veçanërisht në periudhën e pas pavarësisë. Kështu, dorëzimi i Qeverisë së Kosovës përballë strukturave paralele të Serbisë, si dhe paaftësia e saj për të shtrirë kompetencat e veta dhe për të vendosur kontroll të duhur dhe sovranitet mbi tërë territorin e Kosovës e shpërfaqën menjëherë opsionin e negociatave si instrument për t'u ballafaquar me këto probleme, si pasojë e këtyre zhvillimeve pasuan edhe dy nga projektet më të njohura degjenerative për të ardhmen politike të Kosovës, si gjashtë pikëshi i Ban Ki Munit dhe protokolli i njohur i bashkëpunimit policor ndërmjet EULEX-it dhe Serbisë, projekte këto që do të jenë pjesë qenësore e këtyre negociatave. Në këtë kontekst, me anë të kësaj odiseade të re negociatore nuk synohet zhbërja e konditave të këtij realiteti që e ka cunuar deri më tani funksionimin politik të Kosovës, por pikërisht legalizimi si dhe normativizimi juridik i kushteve institucionale që i mirëmban këto struktura vetëm se tani nën maskën politike të këtyre dy projekteve të sipërpërmendura.

Prandaj, me anë të këtyre negociatave përfundimisht Kosova legalizohet si një entitet i zymtë juridik dhe politik dhe në vend që konflikti shqiptaro-serb të zgjidhet ashtu siç pandeh në mënyrë iluzore Qeveria e Kosovës, si i tillë ai zhvendoset mbi premisa politike krejtësisht tjera.

Thuhet se këto negociata janë të imponuara nga Brukseli, por esencialisht sikur Qeveria e Kosovës të ishte treguar efikase në zgjidhjen e këtyre problemeve substanciale gjatë këtij procesi,

nuk do të shtrohej madje fare nevoja për këto negociata, por për shkak të impotencës së saj në zgjidhjen e këtyre problemeve të brendshme ajo do të detyrohet të përfshihet edhe një herë në negociata me Serbinë me qëllim legalizimin e strukturave të saj brenda territorit të Kosovës. Pra, kjo është faktura politike e këtij vendi që padrejtësisht do ta paguajnë edhe një kohë të gjatë vetëm për shkak të dështimit total të kësaj Qeverie.

Në anën tjetër, përfshirja e Kosovës brenda këtij procesi të ri negociator, pa asnjë kusht paraprak, përpos kostos së sipër cekur politike, po ashtu mbartë edhe pasoja të dëmshme në sferën etike dhe morale. Është interesant të vihet në pah se sikur më 2005 gjatë procesit negociator në Vjenë, ashtu edhe tani çështja e kufomave shqiptare, fati i kufomave shqiptare është çështje mbi të cilën do të bisedohet, megjithëse kjo çështje ka mbetur e pazgjidhur që nga atëherë, edhe pse ishte e diskutuar për të strategjikisht, duke e zvarritur këtë çështje si dhe duke i mbajtur trupat e të vrarëve dhe të pa gjeturve brenda territorit të saj, Serbia sot e kësaj dite vazhdon të manipulojë politikisht me këtë çështje, duke e shndërruar atë në një problem të thjeshtë teknik, si dhe duke shpërfillur në mënyrë flagrante njërin nga principet themelore morale të vetë civilizimit perëndimor, parimin e respektimit dhe të dorëzimit të trupit të vdekur. Në këtë mënyrë, me një servilitet të paparë dhe naivitet të pa kuptimtë kjo Qeveri dhe këto institucione, me gatishmërinë e tyre të pa shoqe për të hyrë në negociata pa u plotësuar paraprakisht asnjë standard moral dhe etik, asnjë standard moral, padrejtësisht e detyrojnë viktimën që ta shfajësojë agresorin, pra me ambicien për të realizuar të ashtuquajturin pajtim historik, paradoksalisht për herë të parë në histori promovohet një model i pa njohur ..., ku viktimja detyrohet të zhbëjë veprimin e dhunuesit.

Zyrtarët e kësaj Qeverie për shkak të shantazheve politike që mund të kenë, si dhe shthurjes së tyre morale, nën emrin e tyre personal, ata edhe mund të shkojnë në këto negociata, edhe të flasim për gjithfarë lloj pajtimi, por ata duhet ta dinë se kurrë nuk kanë të drejtë morale të kërkojnë këtë pajtim dhe të falin edhe në emër të vuajtjes së viktimave që nuk janë më. Po ashtu, ata nuk kanë të drejtë as ta amnistojnë kënaqësinë perverse që kriminelët e kanë përjetuar gjatë aktit të tyre të krimit përballë vuajtjeve të tmerrshme të viktimave, kriminelë këta që ende vazhdojnë të enden të lirë dhe të pandëshkuar nga drejtësia, prandaj këto negociata i vlerësojmë të dëmshme moralisht.

Përfundimisht, në bazë të këtyre premisave i bëjmë thirrje këtij Kuvendi, si organi më i lartë vendimmarrës politik, që në mënyrë kategorike t'i refuzojë këto negociata. U arsyetua se duhet të shkohet në këto negociata sepse kështu paska bërë edhe Franca dhe Gjermania, por u harrua një fakt se Franca dhe Gjermania s'kanë pasur marrëdhënie të mira me njëra - tjetrën pa u pranuar reciprokisht, pa u bërë denasifikimi i Gjermanisë, si dhe Franca, si dhe pa hequr dorë Gjermania nga krahina e Erzasit dhe Lorenit, gjë që s'ndodhë në këtë rast. Po ashtu, vlen të ceket se ajo vjedhje masive e votave që paska ndodhur në këtë proces, në procesin e fundit zgjedhor, qenka bërë vetëm me qëllim që të legjitimohet ky proces negociator. Ju faleminderit!

KRYETARI: Përpikuni të jeni në kuadër të temës! Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: I nderuar kryetar,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë dhe kolege,

Ndodhemi para një akti të kryer dhe ky debat na ngjanë në një debat pas të vjelave. Në lidhje me takimin ose bisedimet, siç thuhet, në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ose pa pëlqimin e Kuvendit,

kjo s'ka rëndësi, bisedimet tanimë kanë nisur, takimi është caktuar dhe është caktuar edhe udhëheqësja e grupit për bisedime në nivel shumë të lartë politik, zonja Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Kosovës, ani pse thuhet se bisedimet janë teknike, por kjo përzgjedhje dëshmon të kundërtën. Thuhet se do të bisedohet në mes të dy vendeve të barabarta, kështu kemi dëshirë të themi ne, por cili është realiteti? Nëse bisedimet do të ishin të singerta dhe në mes të barabartëve, sot do të kishim para vetes agjendën e bisedimeve. Nëse bisedimet do të ishin për çdo gjë dhe për të mirën e qytetarëve të Kosovës, paraprakisht do të duhej të ndodhte:

- 1) Kërkim falja nga ana e Serbisë për luftën dhe krimet e kryera.
- 2) Serbia duhet ta pranonte Kosovën si shtet të pavarur, dhe
- 3) Duhet të ndodhte pranimi i pesë shteteve që ende hezitojnë ta pranojnë Kosovën shtet të pavarur dhe janë nën ndikimin e politikës së Serbisë.

Me Serbinë nuk kemi tema jo politike, as kur flasim për targat e veturave, as për arshivën e vjedhur dhe gjërat tjera të vjedhura, as për pikat e djegura doganore në kufi. Këto tema do të duhej të ishin tema në mes të Serbisë dhe Bashkimit Evropian ose Amerikës dhe kanë të bëjnë me cenimin territorial të vendit tonë dhe tentimin permanent që Serbia dëshiron të vështirësojë jetën e qytetarëve të Kosovës, edhe pse ndodhemi nën mbikëqyrjen ndërkombëtare para dhe pas pavarësisë. Pse ky nxitim tani, kur patëm 13 vjet para nesh të bisedojmë dhe askush nuk u ngut, edhe pse për ne kjo ishte çështje jetike, bisedimet pra. Kjo po ndodh tani kur pala tjetër nuk e ka dhënë provimin, por si një skile e vjetër ka futur në punë metodën e sprovuar dhe të vërtetuar tanimë në Bosnje. Për mua kjo është një diplomaci, të them ashtu, pa ofendime pra, nuk ma merrni për të keq, por infantile, kisha thënë, për arsye se karshi Serbisë thjeshtë po sillemi si fëmija që ulet t'i bëjë detyrat e parashtruara, duke shikuar anash mos i ndihmon dikush dhe jo duke u përqendruar në detyrën që e ka para veti. Kështu nuk guxojmë të sillemi. Ne e dimë se me kënd kemi të bëjmë, pikërisht me shtetin serb që shkaktoi aparteidin, gjenocidin, segregacionin, helmimin masovik të fëmijëve me helme neuro-toksike të luftës, Serbinë që shkaktoi terrorin, luftën, masakrat e dhunimet e papara të grave dhe të vajzave shqiptare, shteti që i mori peng edhe ata që i vrau e masakroi, por edhe të gjallët që u zhdukën, Serbia që shkaktoi tokën e djegur dhe shpërnguljen biblike të shqiptarëve. Gjatë këtyre 13 vjetëve ajo bëri çmos për të rënduar jetën e qytetarëve të Kosovës, veçmas të qytetarëve të Mitrovicës dhe të bashkëkombësve të vetë dhe për këtë arsye nuk iu tërhoq veshi asnjëherë nga ndërkombëtarët dhe ata që na nxisin në bisedime.

Ndërkaq, Kosova e dha provimin duke e pranuar kompromisin shumë të dhimbshëm - pakon e Ahtisarit, kompromisin që barti lot dhe dhembje, kompromisin maksimal përtej të cilit nuk mund të durohet, por që për fat rezultoi me pavarësinë. Ne e dimë çmimin e kësaj pavarësie, por tre vjet pas unë jam e lumtur që Kosova dëshmoi se mund të zbatojë kushtetutshmërinë dhe sigurinë e qytetarëve të vet të barabartë, të drejtë të cilën nuk mund t'u garantojnë shumë shtete demokratike, madje me demokraci të dëshmuar dhe të pasura edhe të Bashkimit Evropian. Temat për bisedë teknike janë tema për të cilat nuk ka kuptim të bisedohet, për shembull, Cfta, telekomunikimi e tjera e tjera, tema që mund të them, duhet të realizohen paraprakisht, sepse të tilla edhe janë.

Më lejoni të pyes, e nderuara zëvendëskryeministre, ju që do t'i udhëheqni bisedimet teknike, çka kuptoni ju me bisedat teknike për të zhdukurit, bisedat e tilla shterpe janë zhvilluar gjatë shumë viteve. Si mundet kjo çështje të vihet në këtë nivel, teknik pra, ato vrasje dhe u morën të gjallë nga

njësitë institucionale të Serbisë, militare dhe paramilitare, tani një dekadë nuk dihet fati i tyre. Zbardhja e fatit të të zhdukurve a është çështje teknike, apo krim i shumëfishtë që ndodhi para syve të të gjithëve, apo është çështje humanitare? Pse ndërmjetësuesit e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara nuk bënë më shumë trysni për gjetjen e fatit të të zhdukurve para bisedimeve? Kjo duhej të ndodhte shumë më herët dhe para se të hynim në bisedime. Kjo nuk është e drejtë, nuk është as humanitare, këtë mund ta bënin ata. Të përkëdhelurës së Evropës duhet t'i thuhet fajësia në fytyrë, jo vetëm për shkak tonin, të shqiptarëve, por edhe për shkak të popullit të vet. Kjo për arsye që të mos sillemi sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe të vazhdojmë luftën me metoda tjera dhe të na rëndojnë jetën. Kjo nuk është e drejtë as pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo nuk na mundëson bashkëpunim të fqinjësisë së mirë në mes nesh, pajtimi ndodh ndryshe. Unë këtë e kam thënë, duhet gjetur forcë që të falim, nëse falja kërkohet nga ne, jo se ata e meritojnë, por pse urrejtja brenda nesh pengon ecjen përpara, mundësinë për ta ndërtuar shtetin tonë. Falja duhet bërë edhe nëse kemi shumë plagë dhe dhimbje, por kurrë nuk mund të ndodhë harresa dhe të harrohet e kaluara. Por, Serbia 13 vjet vazhdon luftën kundër nesh, tani në formë tjetër. Gjithnjë kemi thënë se biseda është mënyra më e mirë për t'u marrë vesh, por nëse ke me kë të flasësh. Për këtë besoj kemi qenë dhe jemi të gatshëm në çdo kohë, por ne nuk kemi pasur dhe nuk kemi bashkëbisedues. Serbia ende për këtë nuk e ka dhënë provimin, le ta jep pra, e ka rastin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albana Gashi, le të përgatitet Xhavit Haliti.

ALBANA GASHI: Kryetar i Kuvendit,
Kolegë deputetë,

Çdo lëvizje politike në Kosovë historikisht filloi nga pjesa më e përvuajtur e popullit, si dhe nga pjesa më vitale e vendit tonë, që është rinia e që u rrit nën regjime, luftëra të përcjella me diskriminim, shtypje, përjashtime të familjarëve nga puna e deri në gjenocid të ushtruar nga Serbia.

Të gjitha ngjarjet politike që ndodhën sidomos dy dekadat e fundit në shumicën e bashkëmoshtarëve të mi janë ngjizur dhe bërë pjesë e pandashme e asaj se çfarë jemi tani, por edhe e asaj se kah synojmë të shkojmë si komb.

Situata në të cilën gjendet sot Kosova është rezultat i lëshimeve pe para Serbisë gjatë negociatave të Vjenës, ndërsa fillimi i bisedimeve me Serbinë në kushte të pabarabarta do të krijojë një realitet të deformuar nga disa procese të vendosura nga njerëz të korruptuar politikë. Negociatat me Serbinë rrezikojnë të krijojnë një Kosovë me shumë hapësira të pakontrolluara nga shteti. Një Kosovë e tillë do të ishte pa të ardhme për rininë, si dhe u pamundëson edhe më tej gjeneratave të ardhshme realizimin e një jetese më të mirë, por edhe realizimin e idealeve tona për bashkim kombëtar.

Shitja e këtyre negociatave si rrugë drejt perspektivës evropiane për Kosovën është fyerje e nivelit intelektual të çdo qytetari, të çdo studenti dhe çdo të riu, sepse perspektivë evropiane nga këto negociata po ka vetëm Serbia dhe strukturat e saj paralele që veprojnë dhe terrorizojnë lirshëm popullatën e pambrojtur në veri të Kosovës.

Këto negociata, sikundër edhe ato në të kaluarën, çdo herë sjellin sinjale që ne kemi në klasë politike dhe politikanë që janë përkujdesur për të ardhmen e tyre dhe për të ardhmen e fëmijëve të tyre në kurriz të fatit dhe të ardhmes së mijëra të rinjve të vendit tonë, të cilët edhe sot vuajnë

pasojat sikur i tërë populli peshën e kompromiseve të dëmshme. Andaj, lëvizja “Vetëvendosje” është kundër negociatave me Serbinë nga vetë fakti se për sa janë të pa dëshirueshme, aq janë edhe të dëmshme për popullin dhe për vetë shtetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Zoti kryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë,

Debati i sotëm mendoj se do të shërbejë, së pari, për sqarimin e opinionit të gjithë Kosovës për natyrën, karakterin dhe objektivin e fillimit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë dhe, së dyti, për mbarëvajtjen e këtij dialogu.

Veçoj këto dy drejtime, sepse duke filluar nga shtatori i vitit të kaluar fillimi i bisedimeve në mes Kosovës dhe Serbisë ka qenë çështja më e lakuar nga opinioni, mediat, analistët dhe politikanët e Kosovës e më gjerë. Gjithashtu, ajo ka qenë edhe në fokus të vëmendjes së diplomacisë botërore, të aleatëve dhe të kundërshtarëve të shtetit të Kosovës. Ky dimension trajtimi, ku natyrshëm përplasen mendime e vlerësime të ndryshme, jo rrallë edhe të kundërta, për këto bisedime kanë krijuar njëfarë pështjellimi në opinion, në politikën kosovare, madje edhe në mes nesh. Thuhet dhe “argumentohet” se në këto bisedime nuk duhet marrë pjesë, sepse Kosova nuk hyn si palë e barabartë në to, përderisa nuk është amendamentuar Kushtetuta e Republikës së Serbisë, ku Kosova është krahinë autonome në kuadër të shtetit serb. Thuhet se jo pa qëllim flitet për dialogun Prishtinë - Beograd sikur të ishin dy komuna dhe jo bisedimet Kosovë-Serbi. Thuhet se Kosova pas procesit zgjedhor të stërzgatur po hyn në këto bisedime e pa përgatitur dhe rrjedhimisht e destinuar të humbas, por e bën këtë nën imponimin e ndërkombëtarëve, paragjykohet fitorja e serbëve në këto bisedime, madje parashikohet edhe një ndryshim i mundshëm i kufijve të Kosovës.

Mund të vazhdojmë me opinione të shfaqura, por sot s’jemi mbledhur për këtë. Sot nga ky Kuvend kërkohet dhe pritët mendimi, kontributi dhe angazhimi i përgjithshëm i përfaqësuesve të popullit për mbarëvajtjen e bisedimeve Kosovë-Serbi në fazën e fillimit të tyre që synon zgjedhjen e çështjeve teknike në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

E dimë të gjithë që fillimi i këtyre bisedimeve është i pashmangshëm, por edhe i nevojshëm për ne. Besoj se të gjithë e kemi të qartë dobishmërinë e tyre sepse fillimi i këtij dialogu do të relaksojë raportet e ngrira ndërmjet Serbisë dhe shtetit të Kosovës. Serbia vërtet deklarohet në vazhdimësi për mosnjohjen e Kosovës dhe mos amendamentimin e Kushtetutës që, me sa duket, e ruan në kundërshtim flagrant me realitetin për hir të nxitjes apo qetësisë të nacionalistëve ekstremistë serbë, por si do qoftë, rruga sado e gjatë qoftë, nis me një hap dhe ne po e hedhim këtë hap për prosperitetin e qytetarëve tonë, për fqinjësinë e mirë, për stabilitetin në rajon, për të ardhmen tonë të përbashkët evropiane.

Dialogu që pritët të nisë, nuk është një akt që zhvillohet brenda një dite, një jave apo një muaj dhe në fund të afatit përkatës firmosë dhe vulosë dokumente të zbatueshme detyrimisht. Dialogu që do të zhvillohet edhe me ndihmën e Bashkimit Evropian dhe SHBA-së është proces, do të dihet data e fillimit, por jo e ndërprerjes apo e përfundimit, do të dihet agjenda e diskutimeve, por nuk mund të parashihet dakordësia e palëve në dialog për çështje të diskutuara.

Dhe, së fundi, ky fillim dialogu është qartësisht i limituar në objektin që do të trajtojë, janë çështje teknike që do të diskutohen në nivel ekspertësh, por që synojnë e do t'u shërbejnë interesave të qytetarëve shqiptarë e serbë në Kosovë dhe në Serbi.

Pas përfundimit të tij, i hapet natyrshëm rrugë një faze tjetër dialogu, ku vështirë të përjashtohet diskutimi i çështjeve politike, siç është përcaktimi i vijës së kufirit, shenjave kufitare, raporteve ndërkombëtare, politike, diplomatike e tjerë.

Para se ta mbyll diskutimin tim, dua të shpreh dëshirën për të gjithë ne, të jemi ndihmëtarë konstruktivë të mbarëvajtjes së këtij dialogu dhe partitë, sidomos ato të përfaqësuara në Kuvend të mos përdorin ecurinë e këtyre bisedimeve që mund të ecin herë mirë, e herë jo mirë, për interesa thjeshtë partiake.

Jemi në një moment ku pluralizmi politik duhet t'ia lëshojë vendin patriotizmit realist e jetik për ekzistencën e shtetit të Kosovës dhe të ardhmes së afërt evro-atlantike të tij.

Është folur dhe flitet për problematikën e dialogut. Nuk mund të them se ç'ka agjenda janë në këto bisedime, ç'mund të diskutohet dhe çfarë s'mund të diskutohet, por një gjë e di dhe për këtë do të deklarohej par jush. Jam kundër çdo tentative diskutimi gjatë këtij dialogu për veriun e Kosovës. Jam kundër çdo përpjekje, qoftë edhe indirekte, që synon të vë në diskutim statusin e Kosovës. Kosova është shtet dhe nuk lejon askënd të cenojë sovranitetin e vet shtetëror e territorial.

Dëshiroj që për këtë dialog ta thotë fjalën e vet dhe të kontribuojë gjithë spektri politik dhe shoqëria civile, duke parakuptuar që ky angazhim paraprak të na bëjë të gjithëve aktorë dhe autorë të çdo rezultati të pritshëm të dialogut Kosovë-Serbi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Këtu janë të lajmëruar edhe 5 deputetë, 4 janë të Partisë Demokratike, edhe Visari ka folur. A doni të flisni? Nëse doni, po ua jep fjalën. Mirë, vazhdojmë atëherë. Visar, ke kërkuar diçka, ti fjalën e ke harxhuar, veç a ke diçka kështu të veçantë? Në diskutim e ke thënë fjalën ti një herë... Me rregullore, një herë deputeti e merr fjalën. Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës,

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Pasi që jemi në shënimin e ditëve të epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, fillimisht shfrytëzoj rastin t'ju uroj të gjithë shqiptarëve këto ditë të mëdha, të cilat po shënohen në Kosovën e lirë dhe sovranë.

Të flas para Jakup Krasniqit, para Ramë Bujës, para Azem Sylës, para Fatmir Limës, para Hashim Thaçit e mos t'i përmend emrat e tjerë dhe t'ju mbaj fars e ligjërata për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për të bëmat dhe mëkatet që bëri Serbia në Kosovë është e njëjta sikur t'i drejtohem zotit dhe ta mësoj se si bëhet njeriu. Këtë nuk do t'ia lejoj vetes asnjëherë, sepse krijuesi ynë e di më së miri se si bëhet kjo.

Të nderuar kolegë deputetë,

E tha kryeparlamentari dhe e mbështes shumë se sot në këtë seancë, në këtë debat, në këtë Kuvend duhet të hartohet dhe përpilohet një dokument, ku duhet të specifikohen me të vërtetë temat për të

cilat nuk duhet të dialogohet me Serbinë në asnjë mënyrë. Prandaj, nuk dua t'i përmend, sepse u përmendën nga parafolësit tanë.

Kosova duhet të jetë shembull i fqinjësisë së mirë dhe kontribuuese në stabilitetin e rajonit dhe të vetë Evropës dhe kjo më së miri, të nderuar deputetë, bëhet përmes dialogut.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të gjithë ata që mendojnë se nuk duhet të dialogohet, mund të themi se ora iu ka ngelur në shekullin që e kemi lënë pas, sepse duhet të dialogohet, duhet të dialogohet me fqinjët tanë e edhe me Serbinë, si fqinje e parë e shtetit të Kosovës.

Kosova nuk duhet t'ia ketë frikën dialogut me asnjë shtet e as me Serbinë. Kosova ka shtetësinë e saj, ka sovranitetin dhe integritetin territorial të pacenueshëm që i garantohet me Kushtetutë dhe ligj.

Të nderuar deputetë,

Kosova dhe populli i saj nuk ka nevojë për shantazhe, për intriga, për paragjykime, siç ishte ai i mëhershmi për zonjën Edita Tahiri, se ndoshta është në hava. Kosova ka nevojë për ide dhe projekte. Populli i Kosovës nuk është mohues, është vlerësues i progresit dhe i perspektivës së vendit. Populli i Kosovës nuk është përjashtues, por është ofrues në bashkëpunim për ndërtimin dhe forcimin e shtetit, prandaj është mirë që sot u mbajt ky debat, që u zhvillua kjo seancë, sepse mendoj që populli i Kosovës e kuptoi ose e ka kuptuar, edhe pse mua po më vjen shumë keq nga ish deputetët e legjislaturës së kaluar që i kanë zënë kjo seancë kaq të pa përgatitur për dialogun me Serbinë, kur u tha disa herë që këto kanë filluar që nga shtatori i vitit të kaluar, prandaj kjo më çudit kur thonë se jemi të pa përgatitur ose jemi të ngutshëm.

Populli i Kosovës me votën e lirë dhe demokratike dëshmoi që janë pikërisht këta udhëheqës të kësaj qeverie ata që duhet të prijnë në këto procese, prandaj edhe një herë ftoj të gjithë deputetët të jenë konstruktivë, të jenë të ndërgjegjshëm dhe të dinë se përfaqësojnë popullin dhe jo të thirren në emër të popullit, duke nxitur urrejtje dhe të merren me paragjykime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Halil Krasniqi e ka fjalën.

HALIL KRASNIQI: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër, paska dalë,

I respektuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Logjika rationale më thotë, kjo temë nuk do të duhej të na ndante kaq keq dhe nuk do të duhej të na përplaste kaq shumë. Përkundrazi, kjo temë do të duhej të na bashkonte e afronte, edhe përkundër çfarëdo dallimi programor të subjekteve politike që përfaqësojmë. Jo nga dashuria për temën, sa nga ndjesia për gabime, lëshime të mundshme në formë dhe përmbajtje për dhe gjatë bisedimeve.

Por, një shenjë e mirë u duk sot dhe një përpjekje e mirë pragmatike dhe e dobishme është draft - rezoluta e "Vetëvendosje".

Të respektuar deputetë,

Plasimi i teorive konspirative, definimet hipotetike të epilogut, paragjykimi deri në bindje për motivet e bisedimeve, metodat e sofistikuara në përpjekje për krijimin e opinionit dhe fjalori i përdorur në përshkrimin e lidershit që do të moderojë dhe monitorojë bisedimet, thirrja në faktorin kohë, duke justifikuar apriori si jo të favorshëm për Kosovën, së bashku me injektimin e opinionit nebuloz që tipizon gjendjen e opinionëve të shoqërisë sonë sa herë të flitet para takimeve me Serbinë dhe sa herë të përmenden identitetet përfaqësuese për të cilat gjithnjë shoqërohen me dyshime se a mund të jenë në nivele të detyrave të besuara. ...të ndryshme të opinionit në perceptimin e teorive politike, cektësia e njohurive në zhvillimet e marrëdhënieve ndërkombëtare, deficitet në kapacitete për vlerësime kompetente janë faktorë jashtëzakonisht të favorshëm për të ngritur dilema, për të ndërtuar teori negative dhe për të formuar definime mohuese për këto bisedime.

Situata politike në të cilën gjë endemi si shoqëri e organizuar dhe procesi politik i Kosovës, mosfunksionimi i normave demokratike në nivelin e duhur, marrëdhëniet e acaruar në mes subjekteve politike dhe tendenca drejt ashpërsimit të tyre të mëtejme janë karakteristikat më të dukshme që mund të përshkruhen si faktorë ndihmës për t'i imponuar një varg mesazhesh, një varg porosish, një varg përgjërimesh për subjektet politike në këtë Parlament që vijnë nga drithërimat e ofshamat e qytetarëve të sflitur por të devotshëm, kureshtarë dhe vullnetmirë, deri te opinionet e emancipuara dhe me ndërgjegje të plotë se nuk do të guxohej të tolerohen këto përplasje me motive jo vetëm aspak konstruktive, por edhe konstruktive qofshin, nuk do të duhej të lejohen këto konflikte dhe me këtë komoditet, në këtë kohë kur kërkohet unitet i gjitha forcave politike parlamentare dhe jo parlamentare, nga shoqëria civile dhe mirëkuptim e tolerancë nga të gjithë qytetarët deri në konsolidimin e institucioneve të shtetit dhe deri në njohjen e plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Dhe, deri sa të arrihet anëtarësimi në OKB, të ndihmohen institucionet e drejtësisë, të inkurajohen ato nga të gjithë dhe në çdo mënyrë për të denoncuar çdo abuzim të ... publik edhe me kompetencat zyrtare në dëm të qytetarëve, për të ndërtuar një shtet ligjor të së drejtës. Rrjedhimisht, kjo logjikë prodhon ndikime pozitive drejtpërdrejt dhe në procese politike.

Po bisedimeve, është edhe mendimi im, por gjatë gjithë kohës së bisedimeve një kërkesë duhet të jetë e theksuar dhe respektuar nga përfaqësuesit tanë, transparenca e atyre bisedimeve. Po bisedimeve, por pas çdo takimi raportim në Kuvend, prezantim i kërkesave të kohës, prezantim i dinjitetshëm i tyre, argumentim i kërkesave të përmbledhura me një qëllim – arritje e domosdoshme e atyre kërkesave. Stop Serbisë në ndërhyrjet e mëtutjeshme në funksionimin e institucioneve të shtetit të Kosovës, kërkesa pa ekuivoke dhe të pa tolerueshme, mos cenim i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës. Nëse Serbia ka nevojë për përmbushjen e kushteve për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe nëse ne nuk përfitojmë me këtë synim edhe tonin në këtë proces, nuk na falet nga votuesit tanë. Nuk duhet të lëshojmë rastin që të përfitojmë edhe një synim tjetër që është gjithashtu imediat, përkrahje nga institucionet relevante ndërkombëtare për forcimin e plotë të integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës dhe duke insistuar për njohje reciproke mes Serbisë pasi t'i përmbushë të gjitha obligimet ndaj Kosovës dhe popullit të saj, të kushtëzuara edhe gjatë këtyre bisedimeve, pa dyshim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi edhe një diskutues. Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar i Parlamentit,
I nderuar kryeministër,
I respektuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Bisedimet me Serbinë janë obligim i Kosovës që del nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e mbajtur më datë 9 shtator 2010. Ky është obligim i Kosovës, u tha edhe më herët pas fitores në GJND dhe mendoj se pa asnjë frikë me besim të plotë në njerëzit tanë të zgjedhur, Kosova do të duhej ta kryejë këtë obligim ndërkombëtar në një afat sa më të shkurtër kohor. Është mirë që koha e luftërave ka përfunduar në Ballkan dhe tani ka ardhur koha e dialogut për të zgjidhur brengat e qytetarëve që nga të pa gjeturit, dëmet e luftës, dhe u harrua këtu, shfrytëzimi i hapësirës ajrore të Kosovës dhe shumë probleme tjera.

Më duhet të komentoj disa deputetë të opozitës, që kryeministrin Thaçi e kanë kryefjalë në fjalimet e tyre, duke ditur sigurisht që lideri i PDK-së është lideri më i votuar në vend dhe ai diti ta udhëheq vendin drejt lirisë dhe pavarësisë, është diplomat i vërtetë dhe ishte i vërtetë edhe në Rambuje dhe në negociatat në vijim, andaj nuk kemi nevojë këtu të krijojmë panik e frikë në opinion se gjoja dikush po dashka ta shesë Kosovën këtu e dikush këtu po e dashka Kosovën më shumë. Të njëjtit që sot i kundërvihen dialogut me Serbinë, më parë kundërshtuan negociatat në Vjenë, ndërsa sot janë pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës që dolën nga negociatat e Vjenës dhe pakoja e Ahtisarit. Ju kujtohet se si e reklamoni pakon e Ahtisarit nëpër sheshe të Kosovës, ndërsa sot janë në mes të pakos së Ahtisarit. Mendoj se Kosova do të përfitojë nga dialogu me Serbinë, me çka do t'i hapë rrugën vetes për integrim në Unionin Evropian. Edhe Serbia mund ta marrë rrugën për integrim në EU, por paraprakisht do të jetë e detyruar ta pranojë Kosovën në kufijtë kushtetues të saj. Ne edhe nuk mund të ndalim integrimin e Serbisë në EU. Kam besim të plotë në delegacionin e Kosovës dhe kërkoj që ai të informojë në vazhdimësi Parlamentin e Kosovës për ecurinë e dialogut, por edhe ne si Parlament duhet të japim mbështetje me të gjitha kapacitetet për fillim të dialogut, duke mos lejuar asnjëherë të kalojë vijat e kuqe që këtu u ngritën nga kryeministri dhe deputetë të tjerë.

U cek edhe një problem më herë këtu, problemi i Mitrovicës, që nuk është problem që ka lindur me Qeverinë aktuale e as me të mëhershmet, është problem i planifikuar nga qarqet e caktuara në Beograd dhe është për kritikë KFOR-i dhe EULEX-i, si autoritetet më të larta të sigurisë në vend. Por, problemi i Mitrovicës po merr zgjidhje me Qeverinë Thaçi. Është fakt se Qeveria e udhëhequr nga Hashim Thaçi ka filluar për herë të parë të integrojë atë pjesë të Kosovës, për herë të parë është bërë rindërtimi i shtëpive në atë pjesë dhe janë bërë investime në infrastrukturë si në fshatra të pjesës veriore, Vidomiriq, Vinarc e Çabër dhe fshatra tjera të pjesës veriore.

Po e potencoj vetëm një fakt. Menjëherë pas luftës së vitit 1999, në Vidomiriq ishin kthyer vetëm katër familje shqiptare, sot janë mbi 26 sosh të banuara në fshatin Vidomiriq dhe Qeveria u ka ndërtuar një rrugë prej 3 kilometra e gjysmë.

I kuptoj disa që janë skeptikë dhe i frikësohen dialogut me Serbinë, me lehtësim ndërkombëtar, ndërsa gojën e kanë plot patriotizëm, Shqipëri e bashkim kombëtar. Nuk duhet harruar se në 12 vitet e fundit në Kosovë janë zhvilluar 3 luftëra dhe kanë mundur t'i bashkohen bile njërës prej tyre.

Apostrofimi sot këtu i komandantit legjendar Adem Jashari dhe i dëshmorëve tjerë në fjalim politik dhe vendosja e betimit të ushtarit të UÇK-së para Teatrit Kombëtar kur po mbahej academia për kryelegjendarin e Kosovës, është tendencë për të fituar në emër të dëshmorëve edhe 13 vjet pas rënies së tyre. Kujt po ia tregonin atë betim. Mbasi vetë e treguan, atëherë do e pyesja – pse lideri i “Vetëvendosjes” nuk e dha atë betim të ushtarit të UÇK-së? Në ditët përkujtimore

për të rënë nuk bëhet politikë, por nderohen të rënë, duhet lënë inatet politike nga se dëshmorët janë të Kosovës. Do të duhej që edhe përfaqësuesit e atyre subjekteve politike që munguan dhe në akademinë, të degjojnë këshillat e familjes Jashari...

KRYETARI: Të lutem deputet, ktheu në temë!

BEKIM HAXHIU: ... për të lënë anash ... personale. Faleminderit! Pasi që është diskutimi im i parë, edhe një herë konsideroj që në këto bisedime Kosova nuk do të humbë, por do të kryej një obligim ndërkombëtar, do t'ia hap vetes rrugën për integrim në Unionin Evropian. Tash do të përgëzoj deputetët e "Vetëvendosjes" për guximin e treguar me rastin e betimit para flamurit kuq e zi, vërtetë kanë bërë një akt trimërie të paparë deri më tani, 12 vjet pas përfundimit të luftës, 3 vjet pas shpalljes së pavarësisë, morën guximin të betohen para flamurit kuq e zi. Ne disa që kemi qenë pjesëtarë të UÇK-së, atë obligim e kemi kryer më herët, prandaj nuk mendoj se ka qenë koha... Mendoj se duke respektuar këtë flamur që e kemi për ballë, do të ndërtojmë shtetin e Kosovës dhe të bashkohemi të integruar në Evropë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Liburn, Replikë!

LIBURN ALIU: Së pari, kisha dashur të lidhem te çështja e pakos. Më vjen shumë rënd kur dikush këtu krenohet me pakon, them, është rëndë të krenohesh me pakon, me kompromisin i cili Kosovën e ndanë përbrenda, i cili i shkel vlerat e luftës, po më e rënda mbi të gjitha është kur kjo bëhet nga ata që dikur kanë bërë një betim. Mund të jetë e pritshme që vullneti i popullit të shkelet nga dikush tjetër, por nga ata që njëherë bëjnë betim dhe e shkelin po të njëjtin betim, kjo është më e rënda. Është shumë e rëndë kur flamuri të cilin ne e kemi përpara, krekosesh me atë flamur i cili nuk ka të bëjë aspak me veprimtarinë dhe betimin dhe të shkuarën. Këtu në mesin e aktivistëve të lëvizjes "Vetëvendosje" që janë këtu në Kuvend si deputetë, vërtet ka shumë që nuk kanë qenë luftëtarë, por kjo nuk do të thotë asgjë fare. Ata e duan vendin e vet. Ne mund të mos kemi qenë asnjëri, po së paku ne nuk kemi shkuar në negociata, nuk e pranojmë pakon e Ahtisarit, nuk e pranojmë shumicën e dyfishtë këtu në Kuvend, por do ta ndryshojmë një gjë të tillë, një gjë të tillë do ta ndryshojmë me organizim qytetarë. Ne po i kthehemi edhe diskutimeve pak më të hershme, nuk mendojmë siç mendoni ju, sepse dallimin tani e kemi jashtëzakonisht të thellë, jashtëzakonisht të madh. Ne nuk mendojmë që ju në Rambuje keni shkuar dhe e keni fituar lirinë atje. Ne mendojmë që liria ka ardhur prej përpjekjeve të popullit dhe në Rambuje është humbur. Ne mendojmë që liria edhe këtu ku kemi ardhur ne, ka ardhur me përpjekje popullore, me organizim popullor dhe ju e keni ndal në negociatat ...

(Ndërprerje nga regjia, deputeti vazhdon të flasë pa mikrofon)

KRYETARI: Liburn, prit, prit! Mos e keqpërdor... Jo, keqpërdorim është, se e ke kryer fjalën, ke pasur 2 minuta replikë. Shiko, megjithatë krejt këto gabime të kanë pru ty këtu, këtë ta kesh parasysh. Vazhdojmë seancën! Zoti kryeministër, e ke fjalën, e fundit, pasi seanca është me kërkesën e juaj.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit shumë, i nderuar kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ne sot këtu jemi mbledhur për të diskutuar dhe debatuar, natyrisht edhe për të nxjerrë konkluzione të përbashkëta për të ecur përpara bashkërisht.

Natyrisht se puna më e lehtë është për të etiketuar, akuzuar apo edhe për të prezantuar gjëra që fare nuk përputhen me realitetin.

Ne të gjithë i dimë të bërat e Serbisë në Kosovë dhe nuk ka demagogji më të madhe se sa t'i tregojmë njëri-tjetrit se çka ka bërë Serbia në Kosovë. Ky nuk është seminar që i takon historisë, por është një Kuvend që debaton për të ardhmen e vendi tonë.

Këtu u diskutua edhe më herët, do të thotë, se çka nëse largohet nga ky dialog dhe jo negociatave... Ju përsëris, Serbia u largua edhe në Rambuje nga negociatat, atëherë. Por, Kosova së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n arriti falë sakrificave tona fillimisht të fitojë lirinë. Serbia u largua nga negociatat, ndodhën bombardimet.

Serbia u largua nga negociatat edhe në Vjenë. Kosova u bë vend i pavarur dhe sovran. Serbia edhe mund të largohet nga ky dialog, por Kosova do të bëhet pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian. Por, pavarësisht nga ajo, ne duhet të fokusohemi në agjendën tonë të brendshme rreth përgatitjeve tona të cilat duhet të intensifikohen. Nuk dëshiroj tash të diskutojmë rreth mobilizimit që e kemi pasur në periudhën e luftës, gjatë kohës së Konferencës në Rambuje, por sa i përket organizimit dhe përgatitjes së Kosovës për në Vjenë, atëherë Partia Demokratike e Kosovës ishte në opozitë dhe ne kemi marrë përgjegjësitë tona si parti opozitare në mbështetje të institucioneve, në mënyrë që të punojmë të gjithë për vendin dhe interesat e të gjithë qytetarëve pa dallime partiake dhe kemi dhënë kontributin tonë çdo kund edhe pse janë diskutuar çështje teknike në shumicën e rasteve prej presidentit, kryeministrit, ministrat, kryetari i Kuvendit, deputetë, komisione të ndryshme, bashkërisht kemi punuar në ato dy vite dhe ka qenë suksesi i përbashkët.

U përmendën këtu edhe komandanti legjendar, edhe presidenti, komandanti legjendar Adem Jashari edhe presidenti Rugova. Unë, realisht përmend edhe komandantin legjendar, edhe presidentin Rugova, por përmend kur bëhet fjalë për shtetin, jo as për fushatë, as për poenë politike kur të na duhen, as për spote politike.

Se a duhet të ndodhë tani dialogu apo jo, e ritheksoj edhe një herë, përgatitjet për dialog kanë filluar vitin e kaluar, ndërsa dialogu do të fillojë në të ardhmen e afërt. Afati kohor, ne do të dëshironim të gjithë, që kjo çështje të përmbyllet shumë shpejt, por nuk jemi ne si Prishtinë që u vejmë kushte as Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as Bashkimit Evropian, as NATO-s. E përmendi njëri nga deputetët opozitar, i respektuar, kjo është agjendë ndërkombëtare apo detyrim i Kosovës, i Serbisë për paqen dhe stabilitetin në rajon, një detyrim ndërkombëtar dhe ky është realitet.

Niveli i përfaqësimit shumë i lartë, u theksua, jemi të befasuar. Realisht, ne shpeshherë kemi befasuar, por gjithmonë duke u konsultuar dhe kjo është përgjigja ime, për të mirë.

Unë ju ftoj të gjithëve pa dallime partiake dhe etnike, të gjithë që jemi në këtë Kuvend, që të nxjerrim konkluzionet e përbashkëta për një trup të përbashkët të punës, të Qeverisë së Kosovës, të opozitës, grupeve punuese të përbashkëta, në mënyrë që të kemi sukses të përbashkët. Tani është e konfirmuar se edhe shoqëria civile do të kyçet në këto grupe punuese të përbashkëta, siç ka qenë edhe më herët, prandaj kjo nuk është vetëm përgjegjësi ekskluzive e Qeverisë së Kosovës, por e të gjithëve.

U përmend këtu edhe Tirana se po e largojmë Kosovën prej Tiranë, po e çojmë tjetër kah. Në fakt, për ta afrua Prishtinën me Tiranën ne kemi filluar autostradën, disa kanë refuzuar edhe ndërtimin e kësaj autostrate, ndërsa flasin për bashkim kombëtar, por si do që të jetë, ajo është çështje tjetër politike dhe e fushatave, por është përmyllur fushata, më 2014 përsëri ka.

Tirana e ka përshëndetur dialogun, bile fuqishëm edhe Qeveria, kryeministri Berisha, edhe presidenti Topi, edhe Kuvendi i Shqipërisë dhe të gjitha forcat politike në Shqipëri. Pra, Tirana është unike në mbështetje të Prishtinës për dialogun me Serbinë, në mbështetje të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian. Prandaj, unë dëshiroj të theksoj edhe një herë se secili nga ne duhet të ketë reflektimin më të respektuar, mund të them, të përgjegjshëm shtetëror, në mënyrë që të fillojmë për ndërtimin e trupës së përbashkët, të grupeve punuese të përbashkëta, të punojmë bashkërisht për konsolidimin dhe forcimin e shtetit dhe integrimin e saj në NATO, Bashkim Evropian, ndërsa sa u përket orientimeve të ndryshme të Kosovës në raport me botën, zotimi im ka qenë gjithmonë në të kaluarën dhe sot, do të jetë përgjithmonë bashkëpunimi i ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian dhe në këtë drejtim për aq sa unë do të jem në politikë, si kryeministër, nuk do të ketë luhataje për asnjë centimetër. Kjo është rruga e perspektivës së Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! I kemi disa të lajmëruar për diskutim, por po ju tregoj nenin 40, pika nën shkronjën g), pas diskutimeve, propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor ka të drejtë ta marrë fjalën. Kryetari i Kuvendit mbyll diskutimet dhe e kërkon deklarin e deputetëve për projektligjin ose mocionin përmbajtjesor. Do të thotë, diskutimet janë mbyllur. Ne kemi përmyllur një debat, konsideroj mjaft të rëndësishëm edhe pse aty-këtu nganjëherë kishte dalje nga tema, por megjithatë ajo nuk e ka zbehur rëndësinë e këtij debati. Mund të them tash, pas diskutimit të dytë të kryeministrit, do të thotë i kemi tri dokumente që i janë ofruar kësaj seance, është rezoluta e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, është rezoluta e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe... urdhëro! Ju lutem, mos ndërhyini, unë e kam fjalën. Kemi këto tri dokumente, është procesverbali, në fakt stenogrami i kësaj seance, unë propozoj që shefat e grupeve parlamentare t’i harmonizojnë këto dhe të enjten t’i propozohet për votim seancës. Urdhëro, Sabri!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Edhe më herët, po sidomos kohën e fundit, ke bërë përpjekje të forta që të respektohen dokumentet, e sidomos kjo rregullore të cilën e kemi në fuqi.

Sipas rregullores në fuqi, ne nuk kemi asfarë dokumenti të vlefshëm që të votojmë ose të mos votojmë sot. Sepse, në nenin 52 të Rregullores së Kuvendit, thuhet që “nëse mocioni përmbajtjesor është rezolutë, i dërgohet Zyrës për Propozime e Parashtrës, jo më vonë se tetë ditë pune para debatimit në mbledhje, përveç kur është një çështje urgjente”. Kjo çështje dhe kjo mbledhje nuk e kanë emrin urgjente. Ne kemi biseduar gjatë edhe në Kryesi dhe është thënë që është një mbledhje e radhës, të cilën edhe me tekstin e formuluar, Qeveria e ka kërkuar.

Pra, as dokumenti që ka ardhur në emër të “Vetëvendosjes”, as dokumenti që është propozuar nga Partia Demokratike, nuk janë në bazë të rregullores tekste për të cilat ne duhet të vendosim sot, në bazë të rregullores, gjithmonë.

Kështu që, meqë diskutimet kanë marrë fund për sot, unë propozoj, tash po flas normalisht, gjithmonë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, që të thuhet se Kuvendi ka biseduar për

dialogun që e propozon Qeveria për interesa të përbashkëta të qytetarëve të dy vendeve që do të bëhen në kuadër të Kushtetutës së Republikës, kjo s'është pra rezolutë, por njëfarë përfundimi, sepse kjo mbledhje duhet të marrë një përfundim, që agjenda dhe strategjia, platforma, përbërja dhe temat që Qeveria e Kosovës do t'i bisedojë duhet të dalin në Kuvend dhe të pranohen paraprakisht në Kuvend dhe natyrisht që rezultatet e bisedimeve të tilla do të verifikohen në Kuvend.

Unë mendoj që një tip përfundimi i kësaj mund të dalë kështu, në mënyrë që ata që propozojnë rezoluta, për këtë ta kenë kohën e plotë që të hartojnë rezoluta dhe në bazë të rregullores të vijnë në kohën e caktuar dhe të bisedohen në një mbledhje të Parlamentit në kohën e caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Ne në mbledhjen e Kryesisë jemi marrë vesh që nga debati të dalë një rezolutë dhe, ju lutem, ne megjithatë, këto nuk janë rezoluta, janë projekt-dokumente që janë ofruar. Unë thashë, mbi bazën e këtyre dy rezolutave dhe të fjalës së dytë të kryeministrit, që në formë tjetër e dha një lloj si program të bisedimeve, të hartohet gjatë këtyre ditëve, deri në të enjten, një dokument, ku do të marrin pjesë shefat e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të enjten seancës t'ia sjellin një dokument përfundimtar dhe seanca ta votojë atë. Unë konsideroj se për këtë çështje debati është përfunduar sot. A jeni dakord?

(Reagime)

Shefat e grupeve...! Ju lutem, s'kemi dokument që mund të realizojmë. Unë mendoj se të enjten është seancë e rregullt, mund të votohet dokumenti për të cilin ne biseduam sot. A jeni dakord?

Kush është "për", e ngrit dorën!

Regjia, i numëroni votat!

Kemi hyrë në proces të votimit, ju lutem...

(Sugjerime, propozime)

Jo! Nuk bën të flitet, jemi në procedurë të votimit dhe u krye ajo punë më.

Konstatohet se 60 vota janë "për".

Kush është "kundër"?

Regjia, i numëron votat!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Abstenim?

Nuk ka!

Me 60 vota "për", 45 "kundër", grupet parlamentare përgatisin një rezolutë për të enjten.

Shikoni, nuk është çështje e Kuvendit a do të shkojë delegacioni nesër a nuk do të shkojë. Delegacioni le të mendojë a të shkojë nesër, a të shkojë pas të enjtes.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve